# SHEMAIL

## PARAQITJA, JETESA, MORALI
## I PROFETIT MUHAMED

**PAQJA QOFTË MBI TË!**

**DR. FARUK VURAL**

## PARATHËNIE

Njeriu në jetën e tij përpiqet të realizojë disa synime të caktuara. Dhe padyshim që synimi më i madh është të jetë pjesë e shërbimit në rrugën e Profetit, paqja qoftë mbi të!. Për një njeri, të jesh pjesë e një objektivi të tillë, është një lumturi. Lumturi që pasqyron shpëtimin në të dy botët. Deri tani ka pasur shumë shërbime të vyera dhe të shtrenjta nga ana e atyre që e duan Profetin dhe dashurinë ndaj Tij e kanë pasqyruar në vepra. Në të vërtetë, çdo provë e kaluar nuk është asgjë tjetër përveçse pjesë e qëllimit dhe qëndrimit në rrugën e Tij. Dikush me shkrime, dikush me gjuhë, dikush me pasurinë dhe shpirtin e tij, morën rrugët për të përhapur në të katër anët e botës emrin e Tij të lartësuar. Morën rrugët dhe qëllimi kryesor ishte t'i dhuronin botës mirësinë e veçantë të Tij.

Zotëria i gjithësisë, udhëheqësi i gjithë profetëve, Profeti Muhamed, paqja qoftë mbi të!, është argumenti më i madh i Zotit (xh.sh) midis gjithë atyre argumenteve dhe provave që madje e kemi të pamundur t'i numërojmë. Me personalitetin dhe profetësinë e Tij, Ai është njeriu më i veçantë i të gjitha kohërave. Një njeri i përsosur tek i cili mblidhen dhe pasqyrohen më së miri emrat dhe atributet e Zotit. Njerëzimi sodit vazhdimisht në pasqyrën e Tij vezulluese dëshirën dhe pëlqimin e Zotit. Ai është si një pishtar, kandil i vendosur nga Zoti në qiellin e njerëzimit.

Nëse një ditë dielli nuk do të lindte, atëherë jeta jonë do të mbaronte, por në qoftë se bota jonë ndjesore dhe shpirtërore nuk do të ishte e ndriçuar nga rrezet e profetësisë, atëherë do ishim të destinuar të zhyteshim në kënetën e humbjes. Me ndihmën e Tij kemi kapërcyer rrugë e kodra të paarritshme. Kur kemi kaluar momente të vështira, kemi kërkuar ndihmë nga Zoti i Madhëruar me ndërmjetësimin e Tij. Ai nuk na la në baltë. Shpresojmë nga Zoti të mos na privojë nga ndihma dhe *shefaati* i Tij në botën tjetër.

Libri që keni në duar mund t'ju duket i vogël për nga vëllimi, por është i madh nga përmbajtja dhe është si një pikë në oqeanin e madh të shërbimit. Qëllimi është njohja dhe kuptimi i Tij. Për këtë arsye, në pjesën e parë, është dhënë Shemaili i Profetit paqja qoftë mbi të!, veçoritë fizike, emrat dhe vula. Në pjesën e dytë, nën një kapitull me titull ***Mënyra e Jetesës së Profetit Tonë***, janë cekur shumë tema nga jeta e Tij e përditshme. Në pjesën e tretë, është analizuar morali i lartë i Profetit, i vlerësuar edhe në Kuran. Në pjesën e katërt, janë dhënë preferencat e Profetit në ushqyerje, në ngrënie dhe pirje dhe në pjesën e fundit, janë analizuar veshjet dhe sendet e përdorura nga Ai.

Vlen të theksojmë që kemi shfrytëzuar shumë libra hadithesh. Kemi shfrytëzuar gjithashtu dhe programe të kompjuterit si *'El Mektebetul Elfijje li'sunnetin Nebevijje - 1,5'* dhe *"El Mektebetush Shamile- 1,0"*.

Me lutjen dhe shpresën që të kemi shefaatin e Profetit tonë dhe të zbatojmë fjalën profetike: *"Njeriu është me atë që do"*...

**Dr. Faruk VURAL**

# HYRJE

Hadithi është shkenca e cila studion fjalët, veprat dhe sjelljet e Profetit Muhamed paqja qoftë mbi të!. Me fjalët e Profetit kuptojmë fjalët e vyera përveç Kuranit. Me veprat e Tij kuptojmë veprat e kreut të profetëve, pjesën më të madhe të të cilave jemi të ngarkuar t'i zbatojmë. Pavarësisht se nuk jemi të detyruar të praktikojmë veprat e lidhura me personalitetin dhe traditën e Profetit tonë, mund t' i bindemi me një qëllim të pastër. Nuk ka asnjë dyshim se kthimi i traditës në një adhurim dhe arritja e pikave të synuara me anë të sjelljeve të Tij të bekuara, është një burim mirësie dhe begatie.

Edhe pse në fushën e *fikh*ut nuk studiohen këto vepra të llojit të dytë, në fushën e hadithit janë bërë shumë kërkime. Sipas studiuesve të hadithit, sjelljet e Profetit përfshihen në brendinë e hadithit, por sipas studiuesve të *fikh*ut jo. *Fakih*ët thonë: "Nëse sjellja e Profetit hyn në veprat e kryera me dijeni, atëherë ajo përfshihet automatikisht në veprat e Profetit. Ndërsa ato që përmenden në librat e sijerit, si viti i lindjes së profetit, paraqitja e jashtme, koha dhe vendet e tij, ato nuk përbëjnë ndonjë bazë për jurisprudencën dhe mbesin jashtë qëllimit të fakihëve dhe nuk merren parasysh për ndonjë vendim." Sipas studiuesve të hadithit, çdo gjë që i përket dhe ka të bëjë me Profetin tonë, paqja qoftë mbi të!, është hadith dhe hyn në fushën e studiuesit të hadithit.[1]

Përsa i përket sunetit, ai është çdo fjalë, vepër dhe miratim i Profetit tonë, sipas dijetarëve të *fikh*ut është sinonim i hadithit. Ajo që duam të theksojmë pas një përkufizimi të përgjithshëm të hadithit dhe sunetit, janë degët e shkencave të lidhura me Profetin dhe vendi i Shemailit mes tyre.

Duke u bazuar tek tema e degëve te shkencës që analizojnë Profetin tonë:

1. Hadithi
2. Sijeri
3. Megazi
4. Shemail
5. Delail

Këto degë, pavarësisht se mbështeten në hadith, me kalimin e kohës kanë pasuruar përmbajtjet dhe janë kthyer në një letërsi të veçantë.[2]

Nga këto, tema kryesore e hadithit është personaliteti i Profetit, hadithet, transmetimi i haditheve (*rivajet*), transmetuesit (*ravi*) dhe përpilimi i haditheve në libra.

*Sijer* është shumësi i fjalës *siret*, analizon jetën 63 vjeçare të Profetit, është një shkencë të cilën mund ta quajmë biografia e Profetit tonë.

*Megazi* vjen nga fjala *gaz,* e cila ka kuptimin 'të shkosh të luftosh me armikun', shpjegon luftërat në të cilat ka marrë pjesë Profeti.

Ndërsa disiplina që analizon aspektin njerëzor të Profetit tonë, quhet Shemail.

Ajo degë e shkencës e cila merret me aspektin profetik të shpalljes, quhet *Delail* ose *Hasais*.

Ndërkohë, duhet të theksojmë që gjithë këto degë janë shkenca më vete të cilat shpjegojnë drejtpërdrejtë Profetin. Përveç këtyre, ka dhe shkenca të tjera si Tefsiri, Tasavufi, Fikhu, Kelami, Historia e Medhhebeve, Historia islame, Mjekësia e Profetit, Fjalori dhe Kultura e përgjithshme që i japin hapësirë fjalëve, veprave dhe sjelljeve të Profetit.

Meqë ka lidhje të drejtpërdrejtë me librin tonë, do ishte me vend të jepnim ca detaje në lidhje me Shemailin.

**SHEMAIL**

Fjala '*shemail*' është shumësi i fjalës '*shimal*'. Në kuptimin etimologjik do të thotë analiza e historisë se jetës së një personi, më vonë, duke u përmbledhur, është përdorur si një term që shpjegon aspektin njerëzor, mënyrën e jetesës dhe jetën personale të Profetit.

Për të shpjeguar aspektin njerëzor të Profetit, përdoren gjithashtu dhe fjalët *sifat, menakib, fezail*. Por nga aspekti i shpjegimit të aspektit njerëzor të Profetit, fjalën Shemail për herë të parë e ka përdorur Tirmidhiu (v.892), i cili ka përcaktuar përmbajtjen dhe e ka sistemuar.

Ndër burimet më të rëndësishme të letërsisë së Shemailit është vepra e Tirmidhiut "*Kitabu Shemail*". Librat e tjerë shemail ndodhen të shpërndarë në mënyrë të çrregullt në degët e shkencave të tjera.

Libri i Tirmidhiut përbëhet nga 55 kapituj dhe një epilog. Në vepër flitet për formën e trupit të Profetit, sjelljet e tij, jeta e adhurimit, morali, mënyra e jetesës, disa aspekte të tjera dhe fundi i jetës të cilat mund të përmblidhen në kapitujt kryesorë. Mbi Shemailin e Tirmidhiut janë bërë mëse 61 punime, ndërmjet tyre shumë komente, analiza, përkthime dhe shënime.

Përveç Tirmidhiut kemi edhe vepra të tjera të Shemailit të Belhit (911), Bagdatit (1014), El Mustagfiri (1041) dhe Bagavi (1122). Vepra *"Esh Shifa bi ta'rifi Hukukil Mustafa"* e Kadi Ijazit (1149), pavarësisht se mund të përfshihet në degën e *Delail*it, zë një vend të rëndësishëm në degën e Shemailit. Edhe dijetarët e shquar si Ibn Kethiri dhe Kastalani kanë vepra të çmuara në këtë fushë.[3]

Shemaili ka zënë një vend të rëndësishëm në fushën e hadithit dhe në degë të tjera si: në historitë e qyteteve, në librat e moralit, në vepra letrare dhe në kërkime të veçanta.

## SHEMAILI I PROFETIT TONË

Për të shkruar për zotërinë e gjithësisë, Profetin tonë paqja qoftë mbi të!, siç e thotë dhe Ai vetë, fillimisht duhet që ta duash. Sa duhet të jetë dashuria jonë për të dhe se sa të lidhur duhet të jemi me të, Ai na e tregon në një hadith të transmetuar nga Enesi (r.a.): *"Nuk do të besojë asnjeri prej jush përderisa nuk më do më shumë se nënën, babanë, fëmijën dhe të gjithë njerëzit e tjerë."*[4] Deshëm ta fillonim me fjalët e një njeriu të dashur për ne. Disa rreshta nga libri *"Dritë e pashuar"* i të nderuarit Fethullah Gylen e shpjegojnë këtë në mënyrën më të bukur:

### AI ËSHTË NJERIU I DIMENSIONEVE TË VEÇANTA[5]

Ashtu si njeriu i sotëm i mjerë që ka humbur gjithato kritere vlerash, ashtu edhe qëndrimi, vështrimi dhe mendimi i tij për profetët dhe veçanërisht për mbretin e profetëve, Muhamedin paqja qoftë mbi të! ndodhen në ditët tona në një gjendje krejtësisht të përmbysur. Ndërkaq, është kategorikisht e padrejtë ta vlerësojmë atë me kritere njerëzore sikur të ishte një njeri i zakonshëm.

Madje, kjo nuk është as e mundur. Sepse ai është një njeri i dërguar për ta rishikuar konfiguracionin e tokës dhe për t'i hapur njerëzimit horizonte të reja, duke u pajisur, për këtë qëllim, me një shpirt të posaçëm dhe me aftësi të posaçme, kështu që vlerësimi i tij i kapërcen kriteret tona. Duke u nisur nga kjo, kushdo që do të përpiqet për të treguar për të, le të tregojë sa të dojë; por ashtu siç duhet dhe plotësisht nuk mundet të tregojë! Njëri prej atyre që e kanë kuptuar më mirë atë, është Hasan b. Sabiti që thotë:

*Me fjalët e mia Muhamedin nuk e lavdërova;*

*Fjalëve të mia me të lavdi u përftova..*[6]

Sipas kësaj thënieje, ajo çka u rrezaton bukuri fjalëve, është përmendja e bukur e tij midis atyre fjalëve, sepse shprehjet tona nuk kanë asgjë që mund t'i përftojnë atij! Në mënyrë po kaq lakonike janë shprehur mendimtarët e mëdhenj të këtij shekulli edhe për Kuranin.[6]

Të gjitha këto, në një masë, janë rezultat i përjetimit të të njëjtave ndjenja e mendime. Kush arriti të shprehet, frymëzimin nga i njëjti burim e ka marrë dhe të njëjtat gjëra i ka

shprehur me të njëjtën formë. Dikush ka zgjeruar dhe qartësuar shprehjen e shkurtër të dikujt, kurse dikush tjetër është shquar për një frymë poetike më të avancuar, megjithatë, të gjithë janë vërtitur rreth po të njëjtit bosht.

Në të njëjtën formë edhe ne jetojmë të veçantën e të qenit umet, bashkësi e Tij, dhe e deklarojmë me zë të lartë harenë tonë gjë që është, në të gjitha aspektet, "e mira, dhuntia e mundësisë për të falënderuar". Sado që ta falënderojmë dhe lavdërojmë Zotin tonë që na ka bërë kryelartë me të mirën më të madhe dhe na ka bërë umet të Profetit Muhamed paqja qoftë mi të!, është pak. Kjo është një mirësi hyjnore. Mirësinë Ai ia jep kujt të dojë dhe në masën që të dojë. Vetëm se është i gjerë sa nuk mund të matet me asnjë kriter dhe masë nga tonat. Po, ajo që na është dhuruar neve në krahasim me të tjerët, është një oqean mirësish që s'i gjendet bregu...

Ai është njeriu i dimensioneve krejt të veçanta. Ajo çka na takon neve të bëjmë, është zelli për ta akorduar veten në vijën dhe frekuencën e tij. Kur sigurohet kjo, në mes fillojnë biseda të hapura e të shifruara. Urdhrat i jep vetë i Dërguari i Allahut. Drejtimin e merr ai në dorë. Kurse cilësia e xhematit, bashkësisë dhe shoqërisë që do të drejtojë, do të administrojë Ai, është e lartë, në atë nivel sa t'i bëjë engjëjt të dëshiruar dhe të përjashtuar prej çfarëdo shpjegimi e përshkrimi.

Ndoshta disave këto thëniet tona mund të mos u duken objektive. Punë e madhe! Sidomos teksa çdo ditë katër - pesë të rinj fytyrëdritë të kenë marrë shpirtërisht nga i Dërguari i Allahut ca përgëzime! Dhe sidomos pasi disa prej tyre të thonë se kanë hyrë në lidhje me Të fare pa pengesë, drejtpërsëdrejti, madje në botën konkrete!

Ai është vazhdimisht midis nesh me konstitucionin e Tij shpirtëror dhe, sipas disave, me trajtën e Tij materiale të transformuar në dritë. Imam Sujutiu thotë se mbi shtatëdhjetë herë është parë me të Dërguarin e Allahut. Po, ai nuk ka vdekur në atë kuptim siç e themi ne, ai vetëm dimension ka ndryshuar. Do të ishte gabim të mendohej vdekja e tij si vdekja e një njeriu të zakonshëm. Sepse Kur'ani thotë se edhe dëshmorët nuk kanë vdekur, kur dihet se pozita e tyre është dy shkallë më e ulët se pozita e profetëve. E nëse është kështu, si është e mundur të themi për të "vdiq" në kuptimin që i japim ne kësaj fjale? Ne mund të themi vetëm që ai ka kaluar në një dimension tjetër. Është për këtë arsye që e kanë parë njerëzit, ata që zotërojnë aftësinë për të kapur ato dimensione. Këta njerëz e shohin atë personalisht atje...

Ata që shpëtojnë prej errësirës së trupit dhe të të qenit lëndë dhe që arrijnë nivelin jetësor të shpirtit, munden ta jetojnë në të njëjtin çast të shkuarën dhe të ardhmen. Ja, pra, njerëzit e këtij dimensioni që edhe rrinë, në këtë çast, pranë e pranë me ju, edhe ndodhen gju më gju me të Dërguarin e Allahut, katërmbëdhjetë shekuj më parë, në Epokën e Lumtur. Personat prej kastës së njerëzve të Zotit, të cilët thirren "ebdall", mund të gjenden në të njëjtin çast në disa vende. E pse të mos ndodhet ai, Mbreti i Profetëve, edhe në botën e pastajme, edhe në botën tonë, edhe në praninë tonë, edhe në praninë e profetëve? Ndodhet e do të ndodhet!

Kam për qëllim që të gjitha ç'po them, t'i bëj themel të atyre që do të them këtej e tutje. Kur shohim kah profetët dhe Profeti ynë, merr rëndësi të madhe këndi dhe qëllimi i vështrimit. T'i lëmë mënjanë profetët e mëdhenj; nëse parandjerja dhe njohja e shenjtorëve,

e të urtëve dhe e mirëbërësve të mëdhenj kërkon një puritet shpirtëror të posaçëm dhe kthjelltësi ndjesore, si mund të njihen e të kuptohen profetët në klimën mjegullore të natyrës lëndësore? Atëherë, duke u përpjekur për t'i kuptuar ata, do të duhet të tregohemi tepër të kujdesshëm e të pozicionohemi me të gjithë delikatesën dhe etiketën e mundshme. Ky kujdes duhet të shumëfishohet sidomos në përpjekjet për të njohur personalitetin e Profetit Muhamed paqja qoftë mbi të!. Por ç'e do që, prapëseprapë, çdo njeri do të ndjejë e do të kuptojë për aq sa ia lejon fuqia e shikimit të syrit të zemrës së vet dhe, ndërkaq, askush nuk do të mundet ta konceptojë atë tërësisht me plot kuptimin e fjalës.

Po, Busajriu thotë kështu:

*Njerëzit e përgjumur që jetojnë në ëndrra e qetësi,*

*Si munden ta kuptojnë të vërtetën e Tij?..*

## ATRIBUTET E PROFETIT TONË NGA PIKËPAMJA E KRIJIMIT

Nëse shohim atributet e bukura të Zotërisë së gjithësisë nga aspekti i krijimit, Ai zotëron atributet më të bukura. Përsa i përket bukurive, tek Ai janë mbledhur të gjitha mirësitë. Madje Imam Kurtubiu thotë: "Disa nga cilësitë e bukura të Profetit tonë ishin të dukshme, mund të shiheshin. Po të mund të shiheshin të gjitha, atëherë sahabet nuk do kishin pasur fuqi ta përballonin atë bukuri."

Janë transmetuar hadithe të shumta rreth kësaj teme nga sahabet e nderuar. Nga këta mund të përmendim disa prej tyre si: Hz. Aliu (r.a.), Bera ibn Adhib (r.a.), Hz. Aishja (r.a.), Ebu Xhuhajfe (r.a.), Xhabir bin Semura (r.a.), Umu Ma'bed (r.a.), Ibn Abas (r.a.), Muarri bin Muajkib (r.a.), Ebu Tufejl (r.a.), Ada ibn Halid (r.a.), Hurejm bin Fatek (r.a.), Hakim ibn Hizam (r.a.). Edhe sahabe të tjerë kanë shpjeguar atributet e larta të Profetit tonë. Ne po japim një hadith të transmetuar nga Hz. Aliu (r.a.):

Kur e pyesnin Hz. Aliun për t'i përshkruar cilësitë dhe veçoritë e më të bukurit të të bukurve, Profetit Muhamed paqja qoftë mbi të!, ai thoshte:

"Profeti ynë nuk ishte as i gjatë, e as i shkurtër. Kishte trup mesatar, që anonte tek të gjatët. Flokët nuk i kishte as të drejtë, e as kaçurrela. Kishte flokë me onde. Fytyra e ndritur nuk ishte as e shëndoshë, as e gjatë, e as dobët. Ishte e rrumbullakët. Lëkura delikate duke filluar nga ngjyra rozë ishte e bardhë e ndritur. Kishte sy të zinj dhe qerpikë të gjatë. Kocka të mëdha dhe shpatulla të gjera. Qimet në trupin e Tij të bekuar fillonin nga pjesa e kraharorit dhe theksoheshin në pjesën poshtë tij. Duart dhe këmbët ishin të mbushura në masën e duhur. Ecte sikur të zbriste nga tatëpjeta me përulësi dhe i sigurt në vendosjen e këmbës në tokë. Kur fliste apo kur donte të shihte diçka, kthehej me gjithë trupin e tij nga ajo anë. Mes dy shpatullave kishte vulën e profetësisë, sepse Ai ishte Profeti i fundit ose vula e vargut profetik. Ai kishte zemrën më të gjerë ndër njerëz. Ai ishte më fjalëdrejti, më

gojëmbli, më i duruari, më i ndershmi, më i respektuari, më i sjellshmi, më bujari dhe përsëri Ai ishte më i këndshmi. Çdokush që e sheh për herë të parë, ndjen një lloj ngrohtësie ndaj Tij, hyn në atmosferën e Tij për ta njohur më afër dhe kur arrin ta njohë, dashurohet me Të, lidhet fort pas Tij. Njëri i cili deshi ta përshkruante Profetin, duke pranuar fillimisht paaftësinë e tij për diçka të tillë, shprehej: "Nuk kam parë një si Ai, as para Tij, e as pas Tij, dhe nuk besoj se do të shoh më."

Të gjitha përshëndetjet dhe mirësitë, të gjitha respektet qofshin për Të dhe për gjithë familjen dhe shokët e Tij, o Zot!"[7]

Bera ibn Adhib (r.a.) thotë: "Nuk kam parë njeri më të bukur se Resulullahu brenda një veshjeje të kuqe."[8]

Luani i Devsit, Ebu Hurejre (r.a.) tregon: "Nuk kam parë më të bukur se i Dërguari i Allahut. Dukej sikur në fytyrën e Tij lindte dielli. Kur buzëqeshte, shkëlqimi i dhëmbëve ndriçonte dhe muret."

Kur një sahabe erdhi tek Beraja dhe i tha që: "Fytyra e profetit tonë shndriste si një shpatë", Bera ia ktheu: "Jo, fytyra e Profetit tonë të vetëm ishte si një diell, si një hënë. Ai kishte një fytyrë të rrumbullakët."[9]

Umu Ma'bed (r.a.) është një nga gratë anëtare të Huzasë. Edhe ajo në një përshkrim të gjatë mbi Profetin, na thotë: "Kur e shikoje nga larg, ishte njeriu më i bukur, kur e shikoje nga afër, ishte më i ëmbli."

Ndërsa Ebu Hâle, transmeton kështu: "Fytyra e ndritur e Profetit shndriste sikur shndrit hëna e plotë."

"Lëkura e Profetit mbante një lloj arome të mirë."[10] Bulëzat e djersës i rridhnin poshtë fytyrës si margaritarë. Kishte një lëkurë shumë të butë. Hz. Enesi (r.a.) thotë: "Ngjyra e lëkurës së Profetit ishte si e trëndafilit. Djersët i kishte si copa margaritarësh.[11] As mëndafshi e as atllasi nuk ishte më i butë se lëkura e Tij. As misku nuk mban erë më të mirë se era e trupit të Tij."[12]

Bera ibn Adhib e përshkruan kështu Profetin: "Qimet në trupin e Resulit të nderuar, Profetit tonë, si ato në kokë, ashtu dhe në mjekër, ishin me onde.

Profeti i nderur kishte trup mesatar.

Kishte një shpinë të gjerë mes shpatullave. Po ashtu dhe një kraharor të gjerë.

Profeti i nderuar kishte flokë të dendur të cilët shtriheshin deri poshtë shpatullave dhe arrinin deri në pjesën e poshtme të veshëve.

Në të vërtetë, ka transmetime të ndryshme rreth flokëve të Profetit të dashur. Sipas një transmetimi, thuhet se flokët i arrinin deri në mes të veshëve, sipas një transmetimi tjetër ia mbulonin veshët, një tjetër transmetim thotë se i arrinin deri mbi supe, ndërsa në një transmetim tjetër thuhet se i mbërrinin deri në shpatulla. Nga këto transmetime kuptohet që Profeti herë i ka zgjatur flokët e herë i ka shkurtuar deri në mes të veshëve.

Imam Nevevi thotë se *"hul'le"* është një veshje që përbëhet nga dy pjesë. Këto pjesë quhen *idhar* dhe *rida*. Ndërsa Ebu Ubejde thotë se është një lloj veshjeje nga e njëjta copë dhe e përbërë nga dy pjesë. Ndërkohë që Imam Shafiu ka lejuar veshjen me ngjyrë të kuqe,

Ebu Hanifja e ka vlerësuar si të papëlqyeshme. Ajo që nënkuptohet nga hadithi me veshje të kuqe, është një veshje me pulla të kuqe. Nuk do të thotë të jetë e tërë veshja në të kuqe.

Bera ibn Adhib kur tregon për Profetin, thotë: "Nuk kam parë njeri më të bukur se Profeti ynë. Nëse do të më pyesnin se çfarë nënkupton me shikim, them se nuk kam parë më të bukur se Profetin. Profeti i Allahut ishte më i bukur se të gjitha gjërat e bukura që di dhe që kam parë."

## EMRAT E PROFETIT

Me emrat e Profetit kuptojmë ato emra që janë përdorur për Të. Ebu Bekir ibn Arabi thotë: "Zoti i Madhëruar ka 1000 emra. Dhe Profeti i nderuar ka 1000 emra." Emri më i përdorur i Profetit është Muhamed. Ka pasur dijetarë që kanë gjetur deri në 500 emra të Profetit. Rreth kësaj teme ka shkruar edhe Sujuti në librin e tij *"el Behixhetu's Senijje"*.

Hazreti Xhubejr b. Mut'im transmeton një hadith rreth kësaj teme: Profeti ka thënë: *"Unë kam emrat e mi: Jam Muhamedi, Ahmedi, el Mahi (shkatërruesi) me të cilin Zoti do të shkatërrojë mosbesimin. Unë jam Hashir (mbledhës, njerëzit do tubohen pas meje). Jam Akib (i fundit), nuk do ketë profet tjetër pas meje."*[13] Në hadith Profeti thotë se ka emrat e tij, por përmend vetëm pesë syresh.

Në një hadith tjetër transmetohet: *"Unë jam Muhamedi, Ahmedi, Nebiju'r Rahme, jam Nebiju't Tevbe, jam Mukaffi, Hashir, jam Nebiju'l Melahim."*[14]

Emrin Muhamed ia ka ngjitur gjyshi i Tij, Abdulmutalib. Kur e kanë pyetur përse i ka vënë atë emër, është përgjigjur: "Kisha dëshirë që banorët e qiellit dhe ata të tokës ta nderojnë, falënderojnë dhe respektojnë."

Emri Muhamed përmendet katër herë në Kuran[15], ndërsa emri Ahmed përmendet vetëm një herë në suren Saf, kur tregohet historia e Isait (a.s.).

Muhamed rrjedh nga fjala *hamd*-lëvdim. Emri Muhamed tregon shkallën sipërore. Pra do të thotë i lavdëruar shumë. Ashtu siç përdoret në kuptimin e të lavdëruarit shumë, mund të përdoret dhe në kuptimin e mbledhësit të cilësive të dëshiruara e të pëlqyera.

Ndërsa emri Ahmed vjen në kuptimin e atij që falënderon më shumë mes falënderuesve. Arsyeja e mbajtjes së këtij emri shpjegohet kështu: Zoti i madhëruar do t'i dhurojë Profetit tonë nga *Makami Mahmud* falënderime, lëvdata të tilla, saqë askujt më parë nuk i është bërë një dhuratë e tillë mirësie. Resulullahu me këto falënderime që i përkasin Atij, do ta lëvdojë dhe falënderojë Zotin.

Autori i veprës monumentale *"Shifa-i sherif"*, Kadi Ijad, shprehet kështu: Para se profeti të quhej Muhamed, quhej Ahmed. Sepse në librat tjerë hyjnorë (Teurat, Ungjill) njihet me emrin Ahmed. Ndërsa në Kuran ai paraqitet me emrin Muhamed. Ajo që dua të theksoj është se Ai e ka lavdëruar Zotin e Tij para se ta bënin këtë të tjerët. Ai do ta falënderojë Zotin e Tij dhe në ahiret Zoti do të pranojë shefaatin e Tij dhe Ai do ta falënderojë përsëri për këtë. Ai u lartësua me dhurata si surja e falënderimit (Fatiha), *Livau'l hamd* dhe *Makami Mahmud*. Atij iu urdhërua të falënderonte pas veprave të ndryshme. U quajt *ummeti Hammadun* dhe tek Ai janë mbledhur të gjitha kuptimet e fjalës falënderim.[16]

Emri El Mahi do të thotë shkatërrues, zhdukës, rrënues. Përdoret në kuptimin e atij që do të zhdukë mosbesimin (kufrin) dhe në zhdukjen e gjërave të këqija të atyre që i binden.

El Hashir do të thotë mbledhës, tubues në një vend të vetëm. Në ditën e kiametit, fillimisht do të ringjallet Profeti, pastaj njerëzit. Si Profeti i umetit më të madh, do të ketë një vend të mbrojtur në ahiret dhe do të tërheqë njerëzit pranë Tij si një dorë ndihmese.

El Akib do të thotë i fundit. Do të thotë se nuk do ketë profetë të tjerë pas Tij. Për të provuar profetësinë e Tij, si i fundit, ka argumente të qarta, si në Kuran, ashtu dhe në hadithe.

Megjithëse Profeti ka pasur edhe emra të tjerë, Ibn Haxheri e shpjegon kështu kufizimin vetëm me pesë emra: "Unë kam pesë emra të veçantë, të cilët nuk i ka pasur askush nga të mëdhenjtë apo të shquarit e fiseve të vjetra."

Përveç tyre mund të japim dhe këto emra: *Rauf, Rahim, Mubeshshir, Nedhir, Mubejjin, Dai ila'llah, Siraxhul Munir, Mudhekkir, Rahmet, Nimet, Hadi, Shehid, Emin, Muzzemil, Muddeththir, Muhtar, Mustafa, Shefi', Musheffa', Sadik, Masduk, Jasin, Fatih, Hatim, Tâhâ,* e të tjerë.

Muhamed Damegani në librin *"Sheukul Arus ue Unsu'n Nufus"* na transmeton nga Ka'bu'l Ahbari: Emrat e Profetit tonë janë *Abdulkerim* tek banorët e xhenetit, *Abdulmexhid* tek banorët e Arshit, *Abdulhamid* tek melekët e tjerë, *Abdulvahhab* tek profetët, *Abdulkahhar* tek djajtë, *Abdurrahim* tek xhindët, *Abdulhalik* tek malet, *Abdulkadir* te tokën, *Abdulmuhejmin* te detet, *Abdulkuddus* te peshqit, Abdulgijath te insektet, *Abdulbaki* te kafshët e egra, *Abdusselam* te kafshët mishngrënëse, Abdulmu'min te gjallesat me katër këmbë, *Abdulgaffar* te zogjtë, *Muz Muz* në Teurat, *Tab Tab* në Ungjill, *Akib* në suhufe, *Faruk* në Zebur, *Tâhâ* dhe *Jasin* për Zotin, *Muhamed* për besimtarët. Identifikohet si *Ebul Kasim* për arsye se do të bëjë ndarjen e xhenetit në pjesë për banorët e xhenetit."[17]

## VULA E VULËS SË PROFETËVE, PROFETIT TONË

Shpjegimi i Profetit tonë në librat e shenjtë si Profeti i fundit dhe njohja e Tij me një vulë si shenjë e profetësisë, është një e vërtetë që dihet nga besimtarët e librave të shenjtë. Por kjo është gjithashtu një mrekulli, sepse i përket vetëm Profetit tonë paqja qoftë mbi të!.

Said ibn Jezidi transmeton në një hadith: "Tezja më çoi tek i Dërguari i Allahut dhe iu drejtua: O i Dërguari i Allahut! Djali i motrës sime vuan nga një sëmundje e rëndë dhe ka dhimbje të forta.

Profeti ma fërkoi kokën me duart e bekuara. U lut për mua. Mori abdest dhe unë piva nga uji i abdesit të Tij. Pastaj filluam namazin. Vula në shpinën e Tij ishte e kuqe dhe dukej si një copë mishi."[18]

Kurtubiu thotë se vula ishte aq e madhe, sa mund të shihej nga të gjithë.[19]

Xhabir ibn Semure transmeton: "Pashë vulën mes dy shpatullave të të Dërguarit. Ishte një copë mishi e kuqe në madhësinë e vezës së pëllumbit."[20]

Përsëri në një hadith të Rumejses (r.a.) thotë: "Isha aq afër Profetit tonë të nderuar, saqë po të kisha dashur, mund t'ia puthja vulën profetike. Por nuk munda ta puth nga respekti

i madh. Në atë çast erdhi lajmi i vdekjes së Sa'd ibn Ubades. I Dërguari tha: "U drodh Arshi nga vdekja e Sa'dit."[21]

Ashtu siç e përmendëm dhe më parë, mes besimtarëve të feve të tjera, flitej shumë rreth vulës së profetësisë si shenjë e Profetit të fundit. Këtë e shohim edhe në transmetimet në lidhje me konvertimin në mysliman të Selman Farisiut:

Jeta prej skllavi e Selman Farisiut fillon në *Uadil Kura* duke iu shitur një çifuti. Pasi ndryshon dhjetë pronarë, përfundon në Medinë, te një çifut medinas. Sapo sheh Medinën, kupton se ky ishte vendi i përshkruar nga prifti Amurije, mbështetur në njohuritë e Teuratit dhe Ungjillit. Selman Farisiu tashmë e kishte gjetur vendin që kërkonte. Tani kishte ardhur koha të gjente atë njeri të shquar të cilin aq shumë kishte dëshiruar ta takonte. Ndërkohë që Selman Farisiu priste me padurim të takohej me Profetin, një ditë merr vesh se Profeti kishte emigruar drejt Medinës dhe ndodhej në hyrje të qytetit, në xhaminë e fshatit Kuba. Le ta dëgjojmë nga gojë e tij çastin më emocional të jetës së tij:

"Një ditë isha duke punuar tok me pronarin në pemishten e hurmave. Një çifut erdhi pranë nesh duke vrapuar dhe duke shprehur shqetësimin nga ardhja e të Dërguarit të Zotit në Medinë, tha:

- Zoti i shkatërroftë të bijtë e Kajles! - dhe na lajmëron për mbledhjen e myslimanëve rreth profetit në Kuba. Unë u emocionova shumë kur dëgjova ato fjalë. Gati sa nuk u rrëzova nga pema në të cilën po mblidhja hurma.

- Si the? Çfarë the? - e pyeta çifutin, por pronari u nxeh dhe më goditi me grusht.

- E ç'të duhet ty? Shiko punën tënde! - m'u përgjigj.

- Asgjë. Desha të kuptoja ato që tha, - ia ktheva.

Më në fund, atë mbrëmje, Selman Farisiu shkon tek shtëpia në Kuba në të cilën gjendeshin Profeti me myslimanët dhe kur e sheh të Dërguarin e Zotit, kupton që Ai ishte njeriu i shquar mbas të cilit kishte rendur gjithë jetën. Për të verifikuar cilësitë e Profetit të fundit, në bazë të njohurive të marra në *Sivrihisar* rreth të Dërguarit të Zotit, i afrohet Profetit dhe e qeras me hurmat që kishte marrë me vete dhe i drejtohet kështu:

- E di që je një njeri i mirë. Pranë teje ka njerëz të varfër. Këto hurma pranojini si sadaka. Në mes të gjithëve këtu, ju më dukeni më i përshtatshmi. Profeti i merr hurmat dhe ia shpërndan shokëve të tij duke mos ngrënë asnjë.

"Kjo është një nga cilësitë që kam mësuar rreth Profetit të fundit", mendon Selmani me vete. Largohet prej aty.

Kur Profeti shkon në Medinë, atëherë Selmani sërish përgatit ca hurma dhe shkon tek Ai.

- E pashë që nuk morët nga sadakaja. Ndërsa këto janë një dhuratë e vogël posaçërisht e përgatitur për ju, - i thotë dhe ia jep. I Dërguari i Zotit fton shokët e tij për të ngrënë bashkë me të. "Kjo është cilësia e dytë që më është kumtuar rreth profetit të fundit", mendon Selmani me vete.

Për të verifikuar cilësinë e tretë të Profetit të fundit, që ia kishte thënë prifti i *Sivrihisarit,* Selman Farisiu, ndjekësi i të Dërguarit të Zotit, një ditë, duke marrë shkak nga një varrim i

një sahabe, kur e sheh Profetin me shokët e Tij në varrezat në *Xhennetul Baki*, kërkon të shohë vulën në shpinën e Tij. Profeti, duke e kuptuar qëllimin e tij, e hap këmishën dhe Selman Farisiu sheh vulën profetike në madhësinë e një veze pëllumbi, mes dy shpatullave të të Dërguarit të Zotit dhe duke përqafuar Profetin, puth vulën i emocionuar.[22]

Përsëri në lidhje me vulën profetike ka një transmetim të Abdullah ibn Serxhisit (r.a.): Një ditë i shkova për vizitë të Dërguarit të Zotit. Ishte ulur mes shokëve të Tij. I shkova nga pas. Duke kuptuar qëllimin dhe dëshirën time, e lëshoi pak xhyben prapa. Pashë vulën e profetësisë sa një grusht. Rreth vulës kishte disa nishane që ishin si margaritarë. U ktheva dhe dola përballë Tij:

- Zoti të faltë, o i Dërguari i Zotit!

- Edhe ty! - m'u përgjigj. Shokët që ndodheshin aty m'u drejtuan:

- I Dërguari i Zotit kërkoi falje për ty.

- Po, kërkoi si për mua, ashtu dhe për ju, - ia ktheva.

Pastaj Profeti i nderuar lexoi këtë ajet kuranor:

*"Dije se nuk ka Zot tjetër të vërtetë përveç Allahut! Kërko falje për gjynahun tënd dhe për besimtarët e besimtaret."*(Muhammed, 19)[23]

Në një transmetim të Imam Bejhakiut, thuhet: "Kur Profeti ynë ndërroi jetë, shokët e tij kanë pasur kontradikta dhe kanë dyshuar për vdekjen e Tij për shkak se fytyra nuk i kishte ndryshuar. Esma binti Umejs vendos dorën në shpinën e bekuar të të Dërguarit të Zotit. Kur nuk e gjen vulën profetike, kupton që Ai kishte vdekur. Sepse vula profetike ishte ngritur lart."[24]

## PJESA E PARË

## VESHJA E PROFETIT TONË

VESHJA E PROFETIT TONË

Profeti, paqja qoftë mbi të! nuk është veshur asnjëherë vetëm me një veshje. Zakonisht vishej me një veshje harmani[25](një lloj pelerinë), këmishë, dhe fund. Nuk përdorte çorape. Por çorapet e dërguara nga Nexhashiu i ka veshur. Nga transmetimi kuptohet se ato çorape ishin prej lëkure. Cepi i çallmës i varej herë poshtë kraharorit të bekuar, e herë mes shpatullave. Në shumicën e rasteve ka përdorur çallmë të zezë. Nën çallmë mbante gjithmonë një kësulë. Nuk ka përdorur asnjëherë kësulë të hollë apo qeleshe. Ai thoshte

gjithnjë se ajo që na ndan ose na ndryshon nga mushrikët, është vendosja e kësulës nën çallmë.[26]

Profetit tonë i pëlqente shumë veshja që quhej *'kamis'*.[27] Kamis është një këmishë që mbulon nga koka te këmbët. Duke mos qenë një veshje e ndarë në dy pjesë si *'idhar'* dhe *'rida'* dhe meqë i mbulonte gjithë trupin, Profetit i pëlqente shumë. Kamis, në vija të përgjithshme, është një copë prej pambuku. Mëngët e këmishës së profetit tonë zgjateshin deri te kyçi i dorës.[28]

Në veshje parapëlqente stofrat me vija.[29] Në arabisht kjo quhet '*hibere*'. Ky është një stof me ngjyrë të gjelbër, i njohur në Jemen. Zotëria i gjithësisë parapëlqente veshjet me ngjyrë të gjelbër për arsye se edhe veshja e banorëve të xhenetit do të jetë në po këtë ngjyrë. Ngaqë mëngët ishin të ngushta dhe nuk mund t'i përveshte gjatë marrjes së abdesit, ndonjëherë detyrohej dhe t'i hiqte. Në pjesën e sipërme të xhepit apo tek jaka, ka pasur edhe qëndisje prej mëndafshi të *harmanit Nushirevan*. Pas vdekjes së Tij, Hz. Aishja (r.a.) nxori një pulovër leshi të arnuar dhe një fund prej stof leshi dhe tha: "I Dërguari i Zotit ka vdekur me këto rroba."

I Dërguari ynë kur vishte diçka të re. i lutej Zotit me emrin e asaj veshjeje. Nëse kishte vënë një çallmë, lutej kështu: *"Lavdi Zotit që na e ka bërë çallmën veshje"*. Nëse kishte veshur një këmishë: *"Lavdi Zotit që na e bëri këmishën veshje"*. Nëse kishte veshur rida, *"Lavdi Zotit që na e bëri ridanë veshje."*[30]

Kur vishte diçka të re, lexonte këtë dua: *"O Zoti i Madhëruar, Ty të takojnë të gjitha falënderimet! Ashtu siç ma ke veshur këtë veshje, ashtu kërkoj prej Teje më të mirën e trupit për të cilin është përgatitur ajo. Dhe strehohem tek Ti o Zot nga e keqja e trupit për të cilin është bërë kjo veshje!"*[31]

Siç e dimë nga hadithet, Profeti ka pasur dhe veshje me ngjyrë të kuqe. Pjesa më e madhe e studiuesve të hadithit janë të mendimit se Profeti është veshur me të kuqe. Por Ibn Kajim ka thënë se Profeti paqja qoftë mbi të! nuk ka pasur veshje të kuqe dhe nuk lejonte as burrat që të kishin veshje të tilla. Me veshje të kuqe kuptohet një veshje e qepur me një copë me vija të kuqe, marrë nga Jemeni.[32] Pohohet se Profeti paqja qoftë mbi të! e ka veshur herë pas here. Por numri më i madh i studiuesve të hadithit thotë se nuk ka asnjë shenjë që tregon se veshja e kuqe e Profetit ka qenë me vija.

Zerkani e ka shpjeguar më gjerësisht këtë temë. Nga transmetime të ndryshme, kuptohet se Profeti ka mbajtur veshje me ngjyrë të zezë, të kuqe, të gjelbër, të verdhë, pra, të çdo ngjyre. Por ngjyra më e preferuar ishte e bardha.[33]

Ndonjëherë hidhte sipër një beze që ishte stof me vija. Këpucët e Tij ishin në formën e sandaleve. Poshtë kishte një bazament të sheshtë. Ishte një lloj këpuce që lidhej nga sipër. Shtrati ishte një mbulesë lëkurë e mbushur me gjethe hurme në vend të leshit. Minderi ishte i punuar me fije të marra nga fibrat bimore. Për këtë arsye, shumë herë i mbesnin në trupin e bekuar shenja nga ato fije.

## DELIKATESA E PROFETIT NË VESHJE

Profetit nuk i pëlqente luksi dhe demonstrimi. Por, nganjëherë, Ai vishte edhe veshje të bukura dhe të shtrenjta. Kur Abdullah ibn Abasi shkoi si përfaqësues në Harurije, ishte veshur me një nga stofrat më të çmuar të Jemenit. Harurije i ishte drejtuar atij:

- Ç'është kjo veshje, o ibn Abas?

- Nuk të pëlqen veshja ime? Unë e kam parë Profetin me veshjet më të bukura, - i përgjigjet Ibn Abasi.[34]

Disa udhëheqës shteti dhe zotërinj i kanë dërguar Profetit veshje shumë të çmuara si dhuratë. Profeti, paqja qoftë mbi të!, i ka pranuar dhe ndonjëherë edhe i ka veshur.

## NGJYRAT QË I PELQENIN DHE NUK I PËLQENIN PROFETIT

Mes ngjyrave pëlqente shumë ngjyrën e verdhë. Siç e dimë edhe nga hadithet, nganjëherë i ngjyroste të gjitha rrobat, përfshi dhe çallmën në të verdhë.[35] Pëlqente shumë dhe ngjyrën e bardhë. Rreth kësaj ngjyre ka thënë: "Ngjyra e bardhë është më e bukura mes ngjyrave."[36]

Nuk e pëlqente shumë veshjen me ngjyrë të kuqe të theksuar. Njëherë, kur Abdullah ibn Omeri (r.a.) shkoi te Profeti i veshur me të kuqe, Ai tha:

- Ç'është kjo veshje?

Abdullahu (r.a.) u largua dhe e dogji veshjen në zjarr. Kur Profeti dëgjoi për këtë, i tha:

- Nuk ishte e nevojshme ta digjte, mund t'ia jepte ndonjërës prej grave të familjes.[37]

Në Arabi ka dhe një ngjyrë të kuqe të quajtur '*megarra*'. Më parë me të ngjyrosnin stofrat. Kjo ngjyrë nuk i pëlqente aspak Profetit, paqja qoftë mbi të!. Një herë, Hz. Zejneb po ngjyroste me të një stof. Kur i Dërguari i Zotit shkoi në shtëpi dhe e pa, u largua prej aty. Zejneb (r.a.) e kuptoi dhe e lau copën për t'i hequr ngjyrën. Kur Profeti, paqja qoftë mbi të! u kthye në shtëpi dhe nuk e pa më atë ngjyrë, hyri brenda.[38]

Një ditë, kur erdhi një person i veshur me të kuqe, i Dërguari i Zotit nuk ia ktheu selamin. Përsëri një ditë kur shokët e Profetit kishin vënë qilima të kuq mbi shpinat e deveve, i Dërguari i Zotit i tha: "Nuk dua që kjo ngjyrë të vlerësohet nga ju." Sahabet vrapuan menjëherë dhe i hoqën qilimat.[39]

## PËRDORIMI I AROMËS SË MIRË NGA PROFETI

Përdorimi i aromave të mira është një element pastërtie për njerëzit që jetojnë në shoqëri. Profeti ynë është pajisur me veçori që nuk gjenden tek asnjë nga profetët e tjerë. Kjo nuk është vetëm pastërti e urdhëruar nga legjislacioni islam, por është natyrale dhe duhet të jetë e tillë kur jetohet në shoqëri. Profeti ynë u mëson besimtarëve me sjelljet dhe veprat e tij se si duhet të jetojë një mysliman në shoqëri. Ai thotë: *"Feja qëndron mbi pastërtinë"*.[40]

Imam Kastalani thotë: "Profeti ynë edhe po të mos përdorte ndonjë aromë të mirë, mbajtja e erës së mirë ishte një nga veçoritë e profetësisë së Tij." Madje shërbëtori i të Dërguarit të Zotit, Enesi (r.a.), transmeton: "Nuk kam ndjerë erë më të mirë, se era e

Profetit tonë."[41] Në një transmetim të Bejhakiut, Darimiut, Ebu Nuajm Xhabiri bin Abdillah, thuhet: "Kur Zotëria i Gjithësisë kalonte pranë një mjedisi, atëherë ai mjedis mbante aromë shumë të mirë. Madje edhe ata që s'e kishin parë Profetin duke kaluar aty, mund të pohonin se kishte kaluar vetëm nga nuhatja e aromës së Tij."

Në një transmetim të Taberanit, gruaja e Utbe ibn Ferkadit, Umu Asim, thotë: "Ne gratë e martuara me Utben përdornim shumë erëra të mira. Madje përdornim aq shumë, sa dukej sikur kishim hyrë në garë me njëra-tjetrën. Ndërsa burri ynë nuk përdorte asnjë lloj ere. Por mbante erë aq të mirë, saqë as ne që përdornim gjithë ato erëra, nuk i afroheshim erës së tij. Një ditë e pyeta burrin tim. Dhe ai ma shpjegoi:

"Një ditë kam qenë shumë i sëmurë. Profeti ynë më fërkoi barkun dhe shpinën me pështymën e Tij të bekuar duke mbuluar vendet e turpshme. Me ndihmën e Zotit u shërova. Dhe kjo erë e mirë më mbeti përgjithnjë."[42]

Përsëri Taberani transmeton nga Ebu Hurejre: "Njëri nga sahabet erdhi tek Profeti dhe i tha: O i Dërguari i Zotit! Dua të martoj vajzën. Më ndihmo në përgatitjen e pajës së saj. Profeti iu përgjigj:

Tani nuk kam asgjë, nesër merr një shishe me grykë të gjerë dhe një copë dru dhe hajde. Të nesërmen, ky person erdhi te Profeti. Në dorë mbante një shishe me grykë të gjerë dhe një copë dru. Profeti ynë e fërkoi parakrahun e Tij të bekuar me copën e drurit dhe djersën e nxjerrë e futi në shishe. Pastaj i tha:

- Thuaji vajzës ta përdorë për erë të mirë. Që atëherë, kur ajo grua lyhej me atë aromë, i gjithë populli i Medinës e ndiente. Madje shtëpinë e saj e quanin '*Bejtul Metibin*'.[43]

Enesi transmeton: "Një ditë Profeti na nderoi me ardhjen e tij. Ndërkohë ai nisi të djersijë. Nëna ime mblodhi ato pika djerse të bekuara brenda një shisheje. Kur Profeti e pa se ç'po bënte, e pyeti:

- Çfarë po bën Umu Sulejm?

- Do ta përdor si aromë, o i Dërguari i Zotit, - iu gjegj ime më. Pas kësaj Profeti i tha:

- Po, nuk ka erë më të mirë se ajo.[44]

Profeti Muhamed paqja qoftë mbi të! e pëlqente shumë erën e mirë. Përdorte një erë të veçantë të quajtur '*sukke*'.[45] Ishte një erë e nxjerrë nga misku. Ai e përdorte gjithmonë. Ndonjëherë e vendoste në temjan dhe e përdorte për tymosje. Sumame ibn Abdilah transmeton se sipas Enesit (r.a.), Ai nuk i sprapste erërat e mira që i dhuroheshin. Enesi thotë: "Profeti ynë nuk e kthente erën e mirë që i dhurohej."[46] Kemi dhe një hadith tjetër nga Ibn Omeri: *"Ka tri gjëra, të cilat nëse të ofrohen, nuk refuzohen: Jastëk, aromë e mirë dhe qumësht."*[47] Me jastëk nënkuptohet jastëku që i jepet dikujt për t'u mbështetur apo dikujt që do të flejë. Nga Xhelaledin Sujuti na transmetohen këto fjalë:

Sunet është konsideruar mosrefuzimi i shtatë gjërave: Këpucë, erë e mirë, ëmbëlsirë, perlë, jastëk, mjete për pastrim, një shishe me erë të mirë, një lloj bari me erë të mirë."[48]

Ebu Hurejre transmeton në një hadith se Profeti ynë ka thënë: "Aroma që përdorin burrat duhet të jetë e tillë që të përhapet, por mos t'i shihet ngjyra. Ndërsa tek gratë nuk duhet të përhapet aromë, përveç të afërmve, dhe ngjyra duhet të shihet."[49] Sepse gruaja

duhet të përdorë erë të mirë vetëm afër atyre njerëzve ndaj të cilëve e ka të lejuar ose afër grave të tjera. Ajo që do të theksojë këtu Profeti është mospërdorimi i tyre jashtë shtëpisë.

Disa nga imamët *selefi salihin* radhisin disa nga vendet në të cilat burrat mund të përdorin erë të mirë si p.sh.: në tubime, ditën e xhuma, ditën e Bajramit, kur hyjnë në *ihram*, në mbledhje, kur lexojnë Kuran, kur japin mësim, kur kryejnë adhurimet. Ndërsa gratë mund të përdorin erë të mirë për burrat dhe për familjen e tyre.

Le të japim dhe një transmetim të fundit rreth kësaj teme. Osman bin Nehdi transmeton këto fjalë të Profetit tonë: *"Nëse ndonjërit prej jush i dhurohet një bimë me erë të mirë, le të mos e sprapsë. Sepse ajo ka dalë nga xheneti."* Sigurisht që elementi që përdoret në hadith nuk është në kuptimin e të njëjtës erë. Erërat e mira dhe të lejuara të cilat i përdorim dhe i nuhasim në jetën tonë të përditshme janë një model i erërave të vërteta të xhenetit.

Profeti ishte shumë i kujdesshëm përsa i përket pastërtisë. Edhe Zoti i Madhëruar nuk e vendosi në pozitë të vështirë të Dërguarin e tij para njerëzve të tjerë. Një ditë, nëna jonë Aishe (r.a.), iu drejtua Profetit:

- O i Dërguari i Zotit! Ne nuk shohim asgjë pasi ju kryeni nevojat tuaja personale.

- O Aishe! A nuk e di ti? Toka thith nevojën e profetëve. Prandaj nuk shihet asgjë, - i përgjigjet Profeti.[50]

Hz. Ali (r.a.) ishte i pranishëm pas vdekjes së Profetit në larjen dhe mbështjelljen me qefin. Ai thotë: "Unë isha një nga larësit e të Dërguarit të Zotit. Pashë shenjat që kishte lënë vdekja mbi trupin e tij të bekuar. Nuk pashë asnjë ndryshim. I thashë: "O i Dërguari i Zotit! Jeni i këndshëm si i gjallë, ashtu dhe i vdekur! Ishin përhapur aq erëra të mira, saqë asnjëherë më parë nuk kisha ndjerë një të tillë."[51]

## FLOKËT E BEKUAR TË PROFETIT

Profetit tonë të zgjedhur paqja qoftë mbi të!, nuk i pëlqente zbukurimi dhe dalja mes njerëzve i zbukuruar. Madje dhe kur krihte flokët e bekuar, këshillonte që të zgjidhej vendi.[52]

Zotëria i gjithësisë ka qenë gjithnjë në kundërshtim me mushrikët dhe i ka urdhëruar myslimanët që të mos u ngjasojnë atyre për nga pamja e jashtme, flokët apo mjekra. Në transmetimet në lidhje me flokët e profetit, gjatësisë apo formës së tyre, shihet mirë shembulli i ferkimit me mushrikët. *"Silluni në mënyrën e kundërt me mushrikët. Shkurtojini mustaqet dhe zgjatini mjekrat."*[53] Ibn Abasi transmeton një hadith në lidhje me këtë temë: "Më përpara Profeti i linte flokët mbi ballë. Kurse mushrikët i lëshonin duke i ndarë djathtas dhe majtas. Pavarësisht se nuk ishte urdhëruar për këtë, atij i pëlqente të vepronte si të krishterët dhe hebrenjtë (*ehli kitab*). Ndërsa më vonë ka pasur raste kur flokët i ka krehur dhe ndarë në mes."[54]

Ndryshimet ndërmjet haditheve për këtë temë tregojnë se Profeti i ka krehur dhe prerë flokët në forma të ndryshme sipas kohës dhe nevojave që ka pasur.

Në një hadith të Hz. Enesit (r.a.) thuhet: "Flokët e bekuara të Profetit tonë, rrezatim i bukurisë, zgjateshin deri tek bulat e veshit."[55]

Ndërsa një transmetim i Hz. Aishes (r.a.) është: "Unë dhe i Dërguari i Zotit merrnim gusul nga një enë. Flokët e tij të bekuar, pavarësisht se nuk vinin deri në supe, i shtriheshin deri tek bulat e veshëve. I zgjateshin deri tek gusha."[56]

Ndërsa motra e Hz. Aliut, Umu Hani, transmeton se kur Profeti erdhi në Mekë, në flokët e tij kishte katër rrica.

## KREHJA E FLOKËVE TË PROFETIT

Profeti ynë, më i përsosuri ndër njerëz, tregonte kujdes në mbajtjen e flokëve. Madje në lidhje me mirëmbajtjen e flokëve në një hadith thotë: "Kujt i ka dhënë Zoti flokë dhe kush ka flokë, le të kujdeset për ta sikur kujdeset dhe qeras mysafirin."[57]

Besimtari përpiqet t'i përngjasojë Profetit në çdo aspekt. Prandaj është shumë e rëndësishme për të mënyra sesi Profeti ka krehur flokët dhe mjekrën. Nëna e besimtarëve, Aishja (r.a.) thotë: "Unë i krihja flokët e bekuar të Profetit edhe gjatë kohës së menstruacioneve."[58] Njeriu mund t'ia krehë flokët e ndonjë familjari qoftë me abdes apo pa abdest. Madje Profeti ynë i ka lyer flokët edhe me vaj ulliri. Aq shumë i lyente, saqë rrobat e Profetit dukeshin si rrobat e ndonjë punëtori që punonte me vaj.[59]

## THINJAT NË KOKËN DHE MJEKRËN E BEKUAR TË PROFETIT

Katade (r.a.) një ditë e pyet shërbëtorin e të Dërguarit të Zotit, se a kishte përdorur Profeti këna për flokët, apo për mjekrën. Hazreti Enes (r.a.) i përgjigjet:

- Jo. Profeti ynë nuk ka përdorur asnjëherë këna për flokët, apo për mjekrën. Sepse nuk kishte ndonjë thinjë që të lyhej me këna. Kishte vetëm disa fije floku të zbardhura dhe ca të tjera në fund të mjekrës.

Sipas një transmetimi te Buhariu, Profeti kishte pak thinja në mjekër dhe sipër mjekrës dhe pak në majë të kokës. Në një transmetim tjetër të Hz. Enesit (r.a.): "I numërova thinjat e bekuara në kokën e Profetit. Kishte vetëm 14 fije. Madje një herë Ebu Bekri (r.a.) i ka thënë Profetit:

- O i Dërguari i Zotit! Filluan të shfaqen shenjat e pleqërisë, keni filluar të thinjeni në kokë dhe në mjekër.

- Më ka thinjur surja *Hud*, surja *Vakia*, Surja *Velmurselat*, surja *Amme* dhe surja *idhesh shemsu kuvvirat (tekvir)*, - i është përgjigjur Profeti.

Përse vallë e kanë thinjur Profetin këto sure? Sepse në këto sure flitet rreth kiametit.

Ebu Rimse et Tejmi thotë: Shkova tek Profeti. Kisha marrë me vete edhe djalin. Djali më tha:

- Mua më është treguar i Dërguari i Zotit. Kur pashë atë dritë vezulluese, Profetin tonë, thashë:

- Ky njeri është i Dërguari i Zotit dhe Profet i drejtë.

Ajo bukuri e përsosur, madhështi dhe ngrohtësi, ishin argumente të qarta që Ai ishte i Dërguari i Zotit. Nuk kishte nevojë as për realizimin e ndonjë mrekullie. Ishte veshur në ngjyrë të gjelbër dhe veshja e tij përbëhej nga dy pjesë. Mjekra sapo i kishte filluar t'i zbardhej. Ato fije akoma nuk ishin zbardhur krejt, ishin si të kuqërreme.

PËRDORIMI I KËNASË NGA PROFETI

Kënaja përftohet nga grimcimi i gjetheve të thara të një bime të quajtur *lawsonid*. Ekziston një lidhje mes vendeve në të cilat përdoret kënaja dhe vendeve ku shfaqen myku. Këto vende të trupit janë: flokët, pjesa mes gishtërinjve, shputa e këmbës, pëllëmba e dorës dhe thonjtë. Kënaja është përdorur shumë kohë më parë në këto pjesë të trupit. Mbështetur në traditë dhe fe, përdorimi i saj njeh në një të kaluar të largët. Përveç shmangies së mykut, kënaja ndihmon dhe në zhdukjen e disa sëmundjeve bakteriale. Tani le të shohim sesi e ka përdorur Profeti ynë atë.

Ebu Rimse thotë: "Dola para Profetit bashkë me djalin tim. Ai më tha:

- Ky është djali yt?

- Po, o i Dërguari i Zotit, është djali im. Dëshmoj se ai është djali im.

- Ti nuk mund të qortohesh për shkak të një faji që ka bërë djali yt dhe djali yt nuk mund të qortohet për shkak të një faji tëndin, - u përgjigj Profeti.

Ebu Rimse transmeton se pas kësaj bisede kishte vënë re se Profeti kishte lyer me këna thinjat në kokë.[60]

Transmetime të tilla na tregojnë se Profeti e ka përdorur kënanë herë pas here për flokët dhe mjekrën. Sepse Ebu Hurejre pyetet:

- A e ka përdorur ndonjëherë kënanë i Dërguari i Zotit?

- Po, - përgjigjet ai.[61]

Fjala e një sahabe që është takuar shpesh me Profetin është shumë e rëndësishme. Ka shumë transmetime që dëshmojnë për përdorimin e kënasë nga Profeti paqja qoftë mbi të![62]

Profeti e ka miratuar sahaben që ka përdorur këna. Ndonjëherë nuk pëlqehej përdorimi i kënasë nga ana e grave. Nënës tonë, Aishes (r.a.), i erdhi një grua. E pyeti rreth përdorimit të kënasë nga një grua. Ajo iu përgjigj: "Nuk ka problem, por i dashuri im nuk e pëlqente shumë për shkak të erës jo të mirë."[63] Kjo mund të jetë një lloj tjetër kënaje. Sepse kemi dhe një hadith tjetër në lidhje me lyerjen e duarve të grave me këna. Hz. Aishja transmeton: "Një ditë, pranë Profetit erdhi Utbe binti Hind. Gruaja ia shtriu dorën Profetit duke i thënë:

"O i Dërguari i Zotit! Pranoje besën time!"

*"Ku ta kuptoj unë se çfarë je ti, burrë apo grua? Nuk do ta marr besën tënde pa* ndryshuar *duart, thonjtë (pa i lyer ma këna)"*, iu përgjigj Ai.[64] Në një transmetim tjetër thuhet: *"Po të kishe dorë gruaje, do t'i kishe ndryshe thonjtë, të lyer me këna."*[65]

PËRDORIMI I SYRMES

Syrme është një material që përmban zink. Këshillat e Profetit në lidhje me përdorimin e syrmes mbartin rëndësi të veçantë pasi njihen mirë dobitë e syrmes. Në një hadith të transmetuar nga Ibn Abasi, Profeti ka thënë: *"Përdoreni për sytë tuaj syrmen e quajtur ismid. Forcon shikimin dhe ushqen qerpikët."*[66] *Ismid* që përmendet në hadith është një lloj guri pothuajse në të kuqe që gjendet me shumicë në zonën e Hixhazit. Ndërsa në Isfahan ndodhet i vërteti. Madje Profeti e përdorte syrmen para se të flinte, lyente me të nga tre herë syrin e djathë dhe të majtë.[67]

## PJESA E DYTË

## MËNYRA E JETESËS E PROFETIT

### MËNYRA E JETESËS E PROFETIT

I Dërguari i Zotit, ishte më besimtari i besimtarëve. Frika që ndjente Ai, po ta themi më thjeshtë, largimi nga gjërat e dyshuara, nuk ekzistonte te ndonjë njeri tjetër në të njëjtin nivel. E gjithë sjellja dhe lëvizjet e tij kontrolloheshin nga ato principe. Aq shumë kishte frikë nga Zoti, saqë zemra dukej se do t'i pushonte së rrahuri. Ishte aq i brishtë e aq i ndjeshëm, saqë ishin të pakta çastet kur nuk derdhte lot dhe nuk frikësohej. Kur entuziazmohej, ishte si një oqean, dhe kur ishte i qetë, si një det.

Tani, me një shikim nga lart, duam të prekim thellësitë e Tij:

Pikësëpari, *zuhdi* (asketizmi): Është një gjendje në të cilën, Profeti nuk gëzohej edhe nëse kishte botën në dorë dhe nuk hidhërohej nëse i ikte nga duart. Kjo ndjenjë tek Profeti kishte arritur piedestalin më të lartë. Edhe nëse e gjithë bota do të ishte e Tij, nuk do të gëzohej më shumë sesa po të kishte gjetur një kokërr grurë. Përsëri, nëse ajo botë do t'i ikte nga duart, nuk do të hidhërohej më shumë sesa të kishte humbur një kokërr grurë. Në këtë mënyrë e kishte braktisur Ai botën me zemër. Por kjo braktisje asnjëherë nuk do të thoshte të hiqte dorë nga ajo. Sepse rrugët më të bukura dhe më logjike të fitimit na i ka treguar Muhamedi paqja qoftë mbi të!. Nuk mund të mendohet asnjëherë se Ai kishte hequr dorë nga bota dhe për këtë i ka këshilluar edhe njerëzit. Braktisja e botës duhet të bëhet vetëm me zemër.

I Dërguari i Zotit, që kur hodhi hapin në klimën e ndritur të profetësisë, deri në çastin kur e gjithë bota me madhështinë e saj u përul para këmbëve të tij, nuk e ndryshoi asnjëherë sjelljen. Madje, kur ndërroi jetë, nuk kishte atë pasuri që pati kur kishte lindur. Pasi kishte shpërndarë dhe dhënë gjithçka kishte pasur. Pa shikoni trashëgiminë e lënë, vetëm ca dhen dhe dhomat e vogla në të cilat banonin gratë e tij. Dhe ato ishin të popullit. Kur bashkëshortet e Profetit, nënat e besimtarëve vdiqën, dhomat u përshinë në xhami. Ashtu siç e di çdokush që ka shkuar atje, ato dhoma mund të përbënin vetëm një qoshe të ngushtë të xhamisë.

### MËNYRA E ECJES SË PROFETIT

Transmetimin e parë në lidhje me ecjen e Profetit e ka bërë Ebu Hurejre (r.a.). Ai shprehet kështu: "Nuk kam parë njeri më të bukur se Profetin tonë. Dukej sikur dielli

shkëlqente në fytyrën e tij. Ecja e tij ishte e shpejtë dhe nuk kam parë njeri tjetër të ecë kaq shpejt. Kjo shpejtësi nuk vinte nga e ecura shpejt, por dukej sikur toka palosej e mbështillej nën këmbët e tij. Ai asnjëherë nuk bënte asgjë që t'i sillte vështirësi."[68]

Hazreti Ali (r.a.) kur përshkruan ecjen e tij, shprehet: "Kur hidhte hapat, e ngrinte këmbën rëndë dhe e mbështeste rëndë në tokë. Dukej sikur ulej nga një tatëpjetë."[69]

## MËNYRA E ULJES SË PROFETIT

Çdo gjendje e Profetit ishte e natyrshme. Kajle binti Mahreme (r.a.) transmeton: "Një ditë kisha hyrë në xhaminë e Profetit. E pashë të ulur me gjunjë të ngritur, kofshët i kishte ngjeshur tek barku dhe duart i kishte lidhur tek kockat e këmbëve."[70] Ndërsa në një transmetim tjetër: "Njërën këmbë e kishte vendosur mbi tjetrën dhe ishte mbështetur mbrapa."[71]

Këto transmetime duhet të kenë lidhje me ndonjë gjendje specifike të Profetit. Sepse ne dimë që në disa hadithe të tjera, Profeti i ka ndaluar këto mënyra të uluri. Prandaj sahabet i kanë transmetuar këto hadithe ngaqë nuk kanë qenë të informuar më parë rreth kësaj mënyre të uluri.

Ndonjëherë, kur Profeti qëndronte i ulur, mbështetej mbi diçka. Nëse do të ulej nga ana e djathtë, vendosnin një mbështetëse nën dorën e djathtë. Ai e ka ndaluar mbështetjen tek diçka gjatë të ngrënit për arsye se praktikohej shumë para Islamit. Ai ka thënë: *"Unë asnjëherë nuk ha duke u mbështetur."*[72] *"Nuk do të ha duke u mbështetur diku. Nuk do të ha duke u mbështetur."*[73] Arsyeja e thënies së këtyre këshillave është kjo:

Një ditë, pranë Profetit të nderuar, erdhi një sahabe i quajtur Abdullah ibn Jusr. Me vete kishte sjellë një dash të pjekur si dhuratë për të. Profeti ynë u ul mbi dy gjunjët dhe filluan të hanin bashkë me sahaben që kishte pranë. Ndërkohë, vjen një bedevi nga jashtë:

"O i Dërguari i Zotit! Ç'je ulur kështu?" - e pyet, që nënkuptonte: pse një njeri si ju të ulet si të varfrit?

*"Zoti më bëri një rob të nderuar, nuk jam një tiran"*[74], - i përgjigjet ai.

Profeti ynë na ka tërhequr vërejtjen me të tilla paralajmërime.

Sahabet e shpjegojnë kështu mënyrën e të ulurit të Profetit tonë, zotërisë së gjithësisë:

"Një ditë, Profeti i nderuar u sëmur. Doli nga dhomat dhe erdhi në xhami. Ndërkohë ishte mbështetur tek Usame ibn Zejdi. Kishte veshur rroba të trasha. Ishte mbështjellë me ato rroba sikur mbështillej kur hynte në ihram. Pavarësisht veshjes, na priu për namaz. Në disa transmetime thuhet se kjo gjendje është sëmundja e frikës nga vdekja."[75]

## MËNYRA E FJETJES SË PROFETIT

Profeti paqja qoftë mbi të! falte namazin e jacisë me sahabet dhe nëse nuk kishte ndonjë gjë të rëndësishme për të bërë, pa folur me askënd, shkonte të pushonte.[76] Gjithashtu lutej para se të flinte.

Profeti ynë e ka cilësuar gjumin si vëllai i vogël i vdekjes.[77] Me fjalët "syri im fle, por zemra jo[78]", i Dërguari i Zotit ka shfaqur sjellje të cilat janë shembull për umetin e tij rreth mënyrës së fjetjes.

Kur përgatitej për të fjetur, Profeti ynë sillej në krahun e djathtë, shputën e dorës së djathtë e vendoste nën faqen e djathtë dhe lutej kështu: *"O Zoti im! Më largo nga dënimi yt ditën kur do të ringjallësh dhe mbledhësh robërit e tu!"*[79]

Kur zgjohej lutej kështu: *"Lavdi Zotit i cili na vuri në gjumë, vëllain e vogël të vdekjes dhe na ktheu përsëri në jetë. Padyshim kthimi ynë tek Ai do të jetë."*[80]

I Dërguari i Zotit këndonte këto sure para se të shtrihej në shtrat:

Pjesën e parë të sures Bekare dhe dy ajetet e fundit (Amene resulu),[81]

Ajetul Kursi,[82]

Suren Jasin,[83]

Suren Sexhde,[84] dhe suren Mulk.[85]

Pas tyre lexonte nga tri herë suret Ihlas dhe *Muavidhetejn* (Felek-Nas) dhe një herë suren Kafirun[86], duke i bashkuar duart i frynte shputave dhe pastaj prekte çdo pjesë të trupit deri ku arrinin duart.[87]

Pasi shtrihej në shtrat lexonte 33 herë "Subhanallah", 33 herë "Elhamdulil'lah" dhe 33 herë (sipas një transmetimi 34) "Allahu Ekber" dhe pastaj lexonte shumë lutje.[88]

Sipas Abdullah b.Abasit Profeti gërhiste kur flinte. Kur vinte Bilali për ta zgjuar për namaz ngrihej dhe falej.[89]

Hz. Aishja (r.a.) na ka transmetuar se lënda e shtratit që përdorte Profeti përbëhej nga një lëkurë e mbushur me fije hurmash.

Kur e pyetën Hz. Hafsën si ishte shtrati që kishte përdorur Profeti, ajo u përgjigj: "Vendi ku flinte Profeti ishte një qilim i palosur më dysh nga ne. Një natë menduam ta palosnim katër herë në mënyrë që të ishte më e butë dhe më e rehatshme për Profetin dhe ashtu bëmë. Në mëngjes Profeti na pyeti: "Ç'ishte ai dyshek që më kishit përgatitur mbrëmë?" Ne i thamë se ishte e njëjta gjë, vetëm se kësaj here e kishim palosur katër herë. Pas kësaj Profeti na tha: "Tani e mbrapa përgatiteni siç e keni përgatitur gjithmonë. Sepse mbrëmë, për shkak të butësisë së shtratit, nuk munda të ngrihem për namazin e natës."

## FJETJA E PROFETIT MBI RROGOZ

Një ditë, Hz. Omeri (r.a.) shkoi tek i Dërguari i Zotit. Profeti po qëndronte mbi rrogozin mbi të cilin kishte fjetur dhe në një anë të fytyrës kishte ende shenjat e rrogozit. Në një anë të dhomës kishte një lëkurë të punuar, ndërsa në një qoshe tjetër, një torbë me ca grushte grurë. Ja, këto ishin gjërat që gjendeshin në dhomën e të Dërguarit të Zotit. Hz. Omeri (r.a.) u prek dhe qau. Kur i Dërguari i Zotit e pyeti përse po qante, Omeri (r.a.) iu përgjigj: O, i Dërguari i Zotit! Ndërkohë që mbretërit flenë në shtretër me pupla, Ti (gjithësia u krijua për hir të tij) fle vetëm mbi një rrogoz që të lë shenjë në fytyrë. U preka nga çka

pashë. Pas kësaj, i Dërguari i Zotit iu drejtua Omerit(r.a.): *"A nuk dëshiron, o Omer, që ahireti të jetë i yni dhe kjo botë të jetë e tyre."*[90]

Në një transmetim tjetër, Profeti ynë ka thënë: *"Ç'lidhje kam unë me jetën e kësaj bote. Unë jam si një udhëtar. Një udhëtar që prehet nën hijen e një peme, pastaj largohet prej aty dhe vazhdon udhëtimin."*[91]

Ai kishte ardhur me një mision në jetë. U kishte sjellë njerëzve frymën ringjallëse në ndjenja dhe në mendime. Kur të kryente misionin, do të largohej nga kjo botë. Të hamendësosh në ndryshimin e disa gjërave, në emër të botës nga një njeri kaq i painteresuar ndaj botës, duket se është pak absurde. Ai kurrë nuk u përkul përpara botës dhe Ai asnjëherë nuk hapi velat për të ndryshuar kahe.

## QËNDRIMI ME DITË TË TËRA PA NGRËNË DHE PA PIRË

Ishin të shumta rastet kur Profeti nuk vinte as edhe një kafshatë në gojë. Gjatë jetës së tij nuk ka ndodhur që të jetë ngopur qoftë dhe një herë me bukën prej elbi. Muajt kalonin dhe në shtëpinë e tij nuk ndizej soba as për të bërë një supë.[92]

Një ditë po falej ulur. Po falte namaz nafile. Ebu Hurejre (r.a.) e pyeti pas namazit:

- O i Dërguari i Zotit! Mos jeni i sëmurë? Po faleni ulur.

Përgjigja e dhënë do të drithëronte gjithësinë.

- O Ebu Hurejre! Kam ditë të tëra që nuk kam gjetur diçka për të ngrënë. Uria m'i preu fuqitë, nuk munda të qëndroj më në këmbë, ndaj dhe po falem ulur.

Ebu Hurejre thotë: "Menjëherë zura të qaj. I Dërguari i Zotit kishte harruar gjendjen e tij dhe po më ngushëllonte.

- Mos qaj, o Ebu Hurejre! Uria e hequr këtu, e shpëton njeriun nga dënimi i ahiretit.[93]

Ai ishte një lider. Kishte dhe të tjerë të uritur në mes të grupit të tij. Ja, pra, i Dërguari i Zotit e kishte caktuar standardin e jetës së tij sipas më të varfërve.

Nga aspekti i jetës materiale, ai bënte jetën më të varfër brenda komunitetit. Dhe këtë e bënte me dëshirën e tij. Po të dëshironte, mund të bënte një jetesë të rehatshme. Kjo nuk ishte aspak e vështirë për të. Sepse po të mos i kishte shpërndarë dhe po t'i kishte mbajtur dhuratat që i ishin bërë, mund t'i mjaftonin për të bërë jetën më të lumtur. Por Ai nuk mendoi asnjëherë të bënte një gjë të tillë.

Kjo, në mënyrë të prerë, nuk duhet të kuptohet si një ndarje e Tij dhe e bashkësisë së tij nga kjo botë, apo si braktisje e saj. Çështja nuk qëndron tek tallja e disa ogurzinjve me kriterin e moralit të të Dërguarit të Zotit duke thënë 'një kafshatë', 'një triko'. Ai që dëshiron, fiton, bëhet i pasur dhe jep zekatin në masën e përcaktuar nga Zoti, dhuron diçka, dhe askush nuk është kundër një fitimi të tillë. Madje fitimi i përfituar në rrugë të lejuara është stimuluar në Islam. Megjithatë, një pjesë e shokëve të Dërguarit të Zotit duhet t'i qëndrojnë besnikë kuptimit dhe perceptimit të shembujve të dhënë më sipër. Përkundrazi, kjo bashkësi që rritej dita ditës me shpejtësi të madhe, që po kalonte kufijtë e Mekës dhe Medinës, nuk mund ta mbante më pastërtinë dhe qëndrueshmërinë e ditës së

parë. Ky komunitet nuk është komuniteti i materiales, i lidhur me trupin apo materien. Ky komunitet ishte njëherësh komuniteti i shpirtit, i zemrës, i mendimit dhe i ndërgjegjes. Dhe ja, i Dërguari i Zotit përpiqej ta mbante në këmbë bashkësinë e tij me këto dinamika. Çdo sakrificë të kërkuar nga ata, pikësëpari e tregonte vetë dhe, pastaj, si në çdo çështje tjetër, i bëhej shembull nxënësve të tij. Ja një tablo nga shembujt më të shquar:

Ishte mesnatë. Uria ia kishte fikur gjithë shpresën të Dërguarit të Zotit dhe tani nuk mund të flinte. Ndoshta po të kishte fjetur paksa, do të shpëtonte sadopak nga ajo vuajtje e tmerrshme e urisë. Por dukej që uria nuk do ta braktiste. Doli nga shtëpia dhe nisi të ecë në një drejtim. Pas pak iu errësua pamja. Po vinte dikush. U drejtua andej dhe e kishte njohur. Ishte njeriu i cili nuk ishte ndarë prej tij në asnjë çast të jetës. Kishte qenë bashkë me të, në mendime dhe veprime. Tani, në mes të natës, në këtë cep të qetë të Medinës, dukeshin sikur kishin lënë takim. Ai që po vinte ishte Ebu Bekri (r.a.) dhe i Dërguari i Zotit e përshëndeti. Pastaj e pyeti: *"O Ebu Bekir! Ç'të ka nxjerrë jashtë në këtë orë të natës?"* Ebu Bekri e kishte harruar problemin e tij kur kishte parë të Dërguarin e Zotit paqja qoftë mbi të!. Ashtu bënte gjithmonë. Nëse ju kujtohet, sa rëndë ka qenë pas grindjes për të shpëtuar të Dërguarin e Zotit në Mekë. Një ditë i kishte rënë të fikët dhe kur kishte hapur sytë, gjëja e parë që kishte pyetur, ishte: "Çfarë i ka ndodhur të Dërguarit të Zotit?" Nëna e tij, Umu Uzare, ishte nevrikosur dhe i kishte thënë: "Ti po vdes, por akoma e ke mendjen tek Ai." Ajo nuk e dinte se Ebu Bekri vdiste kur nuk mendonte për të. Sepse i Dërguari i Zotit ishte burimi i jetës. Dhe ja, tani, nuk kishte qëndruar i ndarë nga Ai dhe një ndjenjë e panjohur e kishte sjellë deri aty. E kishte sjellë deri aty dhe pyetjes së Profetit i ishte përgjigjur: "uria". "Nuk gjeta asgjë për të ngrënë në shtëpi, nuk mund të flija dhe dola."

E njëjta botë!

Menjëherë më pas tha:

- Nëna dhe babai im, të qofshin falë, o i Dërguari i Zotit, ti përse ke dalë?

Përgjigja ishte e njëjtë. Edhe i Dërguari i Zotit kishte dalë nga uria.

Ndërkohë u duk dhe dikush tjetër. Dukej që ishte Omeri, i gjatë dhe madhështor. Në të vërtetë, duhej të plotësohej tabloja. I Dërguari i Zotit kishte marrë Ebu Bekrin në krahun e djathtë, por nuk ishte i ftuari i anës së majtë. Sikur ai po vraponte që të mos linte përgjysmë tablonë. Vërtet, ai që po vinte ishte Hz. Omeri (r.a.). Edhe ai u habit kur pa para vetes dy miqtë e tij. I përshëndeti dhe e përshëndetën. Dhe mbreti i fjalës e pyeti dhe Omerin për arsyen e daljes në këtë orë të vonë. Edhe ai dha të njëjtën përgjigje: "Uria, o i Dërguari i Zotit, uria më nxori jashtë."

Profetit tonë i erdhi në mendje Ebu Hejthemi (r.a.). Kishte shtëpinë andej. E kishte parë dhe ditën në vreshtin e tij. Të paktën do t'i jepte ndonjë hurmë për të shuar urinë.

*"Le të shkojmë te Ebu Hejthemi"*, tha Profeti.

Arritën te shtëpia e Ebu Hejthemit. Ebu Hejthemi (r.a.) dhe bashkëshortja e tij po flinin. Në shtëpi kishin dhe një fëmijë të vogël. Ishte pesë ose gjashtë vjeç. Në fillim trokiti Hz. Omeri (r.a.). Thirri me zërin e tij të trashë: "O Ebu Hejthem!" As Ebu Hejthemi e as e shoqja nuk e dëgjuan. Por vogëlushi i cili po flinte i qetë në shtratin e tij, u ngrit menjëherë. "Babi! Zgjohu, ka ardhur Omeri", i tha të atit. Ebu Hejthemi duke menduar se djali kishte

parë ndonjë ëndërr, i tha: "Fli bir, është mesnatë, ç'punë ka Omeri këtu!" Djali u shtri. Kur dera nuk u hap, atëherë thirri Ebu Bekri (r.a.) me zërin e tij të butë: "O Ebu Hejthem!" Djali përsëri u ngrit dhe i tha të atit: "Babi! Ka ardhur Ebu Bekri". I ati e shtriu edhe një herë. Por zëri tjetër ishte zë që ngjallte dhe të vdekurit, ishte zëri i të Dërguarit të Zotit. Kur Profeti thirri: *"O Ebu Hejthem!"*, djali u ngrit si një shigjetë nga shtrati. Vraponte drejt derës duke thërritur të atin: "Babi, zgjohu! Ka ardhur Profeti!" Ebu Hejthemi (r.a.) e kishte humbur krejt. Vrapoi menjëherë te dera. Nuk u besonte syve. Në mes të natës, në shtëpinë e tij, kishte ardhur mbreti i mbretërve. Menjëherë i ftoi brenda. Ky nder mund të vinte një herë në jetën e njeriut. Po jetonte çastin më të lumtur të jetës së tij. Edhe shpirti i tij do të qe pak po të vihej në tryezë. Solli hurma, qumësht, mish dhe ia serviri përpara këtyre mysafirëve të nderuar.

Hëngrën sa të shuanin urinë. Më pas, sytë e Profetit ishin të përlotur. Nga çdo ngjarje nxirrte një dimension dhe thellësi të veçantë dhe nga buzët e tij rrodhën këto fjalë:

*"Betohem në Zot, nesër do të jepni llogari për gjitha këto mirësi."*[95]

Ja, ai ishte një njeri i veçantë që e kalonte jetën brenda disa kritereve të thella dhe të ndjeshme. Të përpiqesh të ndryshosh drejtimin e jetës të një njeriu të tillë, është injorancë ose armiqësi.

Omeri (r.a.) ishte një nga njerëzit më të afërt dhe anën askete të Profetit e shpjegon kështu: "Ju betohem për Zotin se unë e kam parë Profetin të dridhej nga mëngjesi deri në mbrëmje, pasi nuk mund të gjente as hurmën më të keqe për të shuar urinë."[96]

Megjithatë, po të dëshironte Ai, po të kërkonte prej dikujt, kushedi çfarë sofrash të mrekullueshme do të shtroheshin. S'kishte nevojë për këtë. Dhuratat që i kishin ardhur, i mjaftonin që ai dhe familja e tij të bënin një jetë luksoze. Vetëm se Ai shpërndante çfarë i jepej dhe nuk linte asgjë për të nesërmen.

Kur është pyetur përse nuk përfitonte nga mirësitë e dhuruara të botës, përgjigjej kështu: *"Si mund të mendoj për përfitimin nga mirësitë e botës, ndërkohë që Israfili ka marrë në dorë surin dhe pret urdhrin e Zotit. Si mund të përfitojë nga mirësitë kalimtare të botës një njeri i ndodhur në këtë situatë?"*[97]

## MËNYRA E JETESËS E PROFETIT

Profeti ynë paqja qoftë mbi të! i dërguar si udhëheqës dhe prijës për njerëzimin, ishte njëherazi dhe kryefamiljar. Ishte njeri si të tjerët. Edhe ai mbante përgjegjësi për mënyrën e jetesës, për plotësimin e nevojave të ndryshme. Pikësëpari ishte përgjegjës për ushqimin dhe mbajtjen e familjes së tij. Atë kohë, nuk kishte një sistem ekonomik si tani, por kishte praktika të ndryshme si ruajtja e ushqimit për një vit, përgatitja, etj. Edhe i Dërguari i Zotit e ndante nafakën në një vjeçare.[98]

I Dërguari i Zotit e siguronte jetesën e tij dhe të familjes nga këto burime:

**a**. Shiste hurmat që i përkisnin si plaçkë lufte nga fisi Benu Nadir dhe siguronte të ardhurat vjetore të familjes së tij.[99]

**b**. Në këmbim të gjysmës së hurmave ose të drithërave, Profeti dha Hajberin. Grave të tij u jepte çdo vit nga 80 *vesk* hurma, 20 *vesk* elb që bënin 100 *vesk*.[100]

Ajo që kuptohet nga hadithet, është se Profeti i ruante në një vend ushqimet, apo nevojat ushqimore për një vit. Por kjo pjesë e ndarë, harxhohej shpejt, brenda një kohe të shkurtër, nëpërmjet sadakasë. Për sa kohë Profeti ka parapëlqyer jetën askete, e ka shpërndarë pasurinë që ka pasur si sadaka. Edhe familja e tij, e edukuar me një moral të tillë, ka dhënë dhe nuk ka kërkuar gjëra në emër të kësaj bote. Ndërkohë nuk duhet të harrojmë se brenda vitit kishte dhe të ardhura të tjera nga rrethana të ndryshme.

## VLERËSIMI I JETËS TREGTARE NGA PROFETI

Profeti ynë paqja qoftë mbi të! është gjendur brenda jetës tregtare që në fëmijëri. Ai ka shkuar në vende si Siria dhe Jemeni kur ka qenë i vogël bashkë me karvanët e xhaxhallarëve të tij dhe ka qenë në qendër të jetës tregtare. Siç kishte ndodhur edhe në fusha të tjera, edhe në tregti, Ai ishte pranuar si një njeri "i besueshëm dhe i respektuar" dhe u kishte frymëzuar siguri njerëzve përreth.

Edhe para se të martohej me Hz. Hatixhen kishte drejtuar karvanët e kësaj gruaje të pasur dhe të ve dhe kishte marrë pjesë në aktivitete të ndryshme tregtare. Profeti i fundit, krenaria e njerëzimit, ishte person i njohur dhe i shquar në tregti.

Si një njeri që e kishte kuptuar domosdoshmërinë e jetës tregtare që në fëmijëri, Profeti Muhamed paqja qoftë mbi të!, pas hixhretit, kishte menduar një projekt për vendosjen dhe themelimin e një tregu të myslimanëve në Medinë dhe e kishte realizuar atë. Në këtë mënyrë ishte thyer dhe autoriteti i çifutëve që mbizotëronte jetën tregtare të Medinës kohë më parë. Përveç kësaj, besimtarët mësuan të qëndrojnë mbi këmbët e tyre.

Ata të cilët përshkruajnë moralin tregtar të Profetit, shpreheshin kështu: "Ashtu siç ai vetë nuk cenonte të drejtën e tjetrit, ashtu nuk lejonte t'i cenohej edhe e drejta e tij."

## "NUK ËSHTË PREJ NESH AI QË MASHTRON"

Ebu Hurejre (r.a.) transmeton: "Një ditë, kur Profeti paqja qoftë mbi të! kishte dalë në treg, iu afrua një shitësi dhe futi dorën brenda mallit që shiste, pastaj e nxori. Gishtat i ishin lagur pak. "Ç'është kjo?", iu drejtua shitësit. "Është lagur nga shiu", ia ktheu shitësi. Atëherë Profeti i tha: "A nuk munde ta nxjerrësh përsipër pjesën e lagur që ta shihnin të gjithë? Nuk është prej nesh ai i cili mashtron."[101] Me anë të këtyre fjalëve, ai kishte vendosur një princip shumë të rëndësishëm në jetën tregtare dhe e kishte praktikuar vetë i pari.

Në fakt, klienti duhet të dijë gjithçka rreth mallit, sido që të jetë dhe pastaj duhet të marrë vendimin e tij. Të mashtrosh njerëzit me dredhi të ndryshme është në kundërshtim me moralin e Muhamedit dhe ata që veprojnë ashtu, veprojnë kundër Profetit tonë. Profeti ynë paqja qoftë mbi të! i ka përforcuar këto fjalë me një hadith tjetër ku thotë: *"Një tregtar mysliman e ka të ndaluar t'i shesë me vetëdije një klienti një mall me defekt."*[102]

## KËSHILLONTE NË LEHTËSIMIN E SHITBLERJES

Sipas transmetimit të Hz. Xhabirit (r.a.), Profeti Muhamed paqja qoftë mbi të! ka thënë: "Zoti e shtoftë mëshirën e Tij për njerëzit që lehtësojnë dhe janë bujarë në shitje, blerje dhe në

shlyerjen e borxhit."[103] Ndërsa sipas transmetimit të Tirmidhiut: "Zoti e ka mëshiruar një njeri që jetoi para jush. Sepse ky njeri lehtësonte në shitje, lehtësonte në blerje dhe kur dëshironte të merrte diçka, tregohej i sjellshëm dhe lehtësonte."

Ebu Hurejre (r.a.) thotë se Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: "Zoti e do tolerancën në shitje, tolerancën në blerje dhe tolerancën në pagesë."[104]

## KËSHILLA E PROFETIT PËR ATA QË PUNËSOJNË NJERËZ

Zotëria i gjithësisë, urdhëron ekuilibrimin e sjelljeve ndaj njerëzve që punojnë afër tyre. Nga Suvejd bin Mukarrin el Muzeni transmetohet një episod: "Ne ishim shtatë vëllezër. Nuk kishim asnjë ndihmës, vetëm një robëreshë. Njëri nga vëllezërit e mi një ditë i kishte rënë me shuplakë asaj. Pas kësaj, i Dërguari i Zotit, na urdhëroi ta lironim robëreshën."[105]

Madje rreth virtytit të lirimit të robërve, transmetohet: *"Nëse një mysliman liron një rob mysliman, atëherë ai bëhet shkak për shpëtimin e tij nga zjarri. Çdo organ i robit shpëton një organ të trupit të tij nga zjarri. Nëse një mysliman liron një robëreshë myslimane, atëherë ajo bëhet shkak për shpëtimin e tij nga zjarri. Çdo organ i saj shpëton një organ të tij nga zjarri. Nëse një grua liron një robëreshë myslimane, atëherë ajo bëhet shkak për shpëtimin e saj nga zjarri. Çdo pjesë e trupit të robëreshës shpëton një organ të trupit të saj."*[106]

## TË FOLURIT, MËNYRA E TË FOLURIT, BUZËQESHJA DHE E QESHURA E PROFETIT

Të folurit e Profetit tonë, më i miri i folësve dhe zotëria i horizontit *Levlake Levlake*[*], ka qenë jashtëzakonisht e ëmbël dhe ledhatuese. Fliste qetë dhe i ndante fjalët nga njëra-tjetra me qëllim që çdo fjalë të kuptohej mirë nga ata që e dëgjonin. Kishte zakon të përsëriste tri herë një fjalë të cilën dëshironte ta theksonte. Në shumicën e rasteve, kur fliste, sytë i drejtonte lart nga qielli. Zërin e kishte të lartë. Në një transmetim të Umu Hanit, (r.a.) thuhet kështu: "Profeti paqja qoftë mbi të! lexonte Kuran në Qabe dhe ne e dëgjonim të ulur, në divanet tona në shtëpi."[107]

Ndërsa Aishe (r.a.) kur përshkruan mënyrën e të folurit të Profetit, shprehet kështu: "Kur fliste, nuk fliste si ju. Kushdo qoftë ai që e dëgjonte, mund t'i mësonte përmendësh fjalët e Tij."[108] Madje kur fliste Profeti ynë, mund të numëroje dhe shkronjat e nxjerra nga goja e tij. Jo ngaqë fliste ngadalë. Sepse të folurit e ngadaltë mund ta mërzisë dëgjuesin. Por të folurit shkoqur e qartë nga Profeti, nuk vjen në kuptimin e një të foluri të rëndë, të ngadaltë. Madje kur ai dëshironte të theksonte diçka, e përsëriste tri herë.[109]

Në një hadith të gjatë, një ditë Hz. Hasani e pyet Hind ibn Hale: "Si fliste Profeti paqja qoftë mbi të!?Ai ishte përgjigjur kështu: "Në shumicën e rasteve qëndronte i heshtur, sikur të ishin në prezencën e Krijuesit Hyjnor. Ai nuk pushonte si njerëzit e botës, koha e heshtjes ishte më e gjatë se ajo e të folurit, nuk kish zakon të fliste kur nuk ishte e nevojshme. Kur niste të fliste dhe kur mbaronte fjalën, thoshte "bismil'lah". Qëllimet e tij i shprehte me fjalë të shkurtra dhe të sakta, ishte lakonik. Kur duhej të shprehte synimet e tij, nuk fliste as pak, as shumë. Gjithmonë respektonte mirësinë edhe nëse ishte e pakët nuk përdorte

[*] *"leulake leulake lema halaktul eflake - Po të mos ishe Ti, nuk do të krijoja universin." Hadith kudsi.*

asnjë shprehje qortuese për të. Falënderonte për çdo mirësi. Nuk shqetësohej për pasurinë e botës, domethënë nuk e zemëronte asnjëherë ndonjë çështje e kësaj bote. Por përballë prekjes dhe cenimit të një të drejte, askush nuk mund t'i dilte para zemërimit të tij. Nuk mërzitej apo zemërohej për ndonjë çështje që kishte lidhje me të. Prandaj nuk ushqente asnjëherë urrejtje dhe armiqësi. Kur do të tregonte diçka, nuk tregonte me gisht, por me duart e tij të bekuara. Kur i pëlqente diçka, nëse pëllëmbën e dorës e kishte të drejtuar drejt tokës, e ngrinte lart, nëse e kishte të drejtuar lart, e drejtonte poshtë. Kur dëshironte të fliste, me gishtin e dorës së majtë godiste pëllëmbën e dorës së djathtë. Nëse zemërohej me dikë, nuk fliste me zë të lartë, që të bërtiste, e pranonte me një të falur. Kur qeshte, mbyllte me përulësi kapakët e syve, në këtë mënyrë nuk e shfaqte të qeshurën. Qeshja e Profetit tonë, më i epërmi i profetëve, ishte gjithnjë buzëqeshje. Kur buzëqeshte, i dilnin dhëmbët e pastër e të bekuar si margaritarë."[110]

Ndërsa Xhabir ibn Semure na jep këtë transmetim: "Profeti paqja qoftë mbi të! e kishte kërcirin të hollë. Kur qeshte, shfaqte një buzëqeshje. Në pamje të parë mendoje se Ai mund të kishte përdorur *syrme* për të lyer sytë, por në të vërtetë, sytë e tij ishin si të lyer me *syrme*."[111] Profeti ynë ishte një njeri i buzëqeshur. Haris ibn Xhuz thotë: "Nuk kam parë njeri më të buzëqeshur se i Dërguari i Zotit."[112]

Ndonjëherë, i Dërguari i Zotit ka buzëqeshur në lidhje me konkluzionin e ndonjë çështjeje. Hadithi që transmeton Ebu Dheri (r.a.) është: Profeti ynë thotë: *"Unë e njoh njeriun e parë që do hyjë në xhenet pasi të ketë shpëtuar nga xhehenemi dhe njeriun e fundit që do të shpëtojë nga xhehenemi për të hyrë në xhenet. Në ditën e kiametit, kur njeriu çohet për të dhënë llogari, melekët urdhërohen:*

*- Tregoni këtij njeriu gjithë mëkatet e vogla që ka bërë. Ndërsa mëkatet e mëdha fshijani. Atij i thuhet ke bërë këtë, këtë, këtë. Ai i pranon të gjitha dhe nuk mund të kundërshtojë asgjë nga ato që thuhet. Ndërkohë frikësohet nga mendimi i mëkateve të mëdha. Në atë çast, Zoti u drejtohet melekëve:*

*- Jepini atij të mira përballë këtij mëkati të vogël. Kur e dëgjon vendimin, ky njeri mëkatar dhe i pashpresë, me një ambicie të rilindur, thotë:*

*- Unë kam bërë mëkate edhe më të mëdha. Nuk po arrij t'i shoh në librin e veprave.*

Ebu Dheri thotë: "Kur e tha këtë Profeti, pashë nga Ai. Nga e qeshura i dukeshin dhëmballët."[113]

Abdullah ibn Mesudi transmeton se Profeti ynë ka thënë: *"Zoti më tregoi për njeriun e xhehenemit që do të dalë i fundit nga xhehenemi dhe do të hyjë i fundit në xhenet. Ky njeri do të dalë duke ecur këmbadoras nga xhehenemi. Zoti i Madhëruar do t'i thotë:*

*"Shko, hyr në xhenet!"*

*Ai njeri shkon në xhenet, por xheneti është aq i mbushur, saqë çdo njeri ka vendin e tij dhe duket se nuk ka mbetur asnjë vend.*

*"O Zoti im! Unë e gjeta xhenetin të mbushur plot", thotë.*

*Zoti i Madhëruar i thotë sërish:*

*"Shko, hyr në xhenet!"*

*Ai hyn në xhenet. Përsëri e gjen të mbushur plot e përplot.*

*"O Zoti im! E gjeta xhenetin të mbushur plot", i thotë përsëri Zotit.*

*Zoti i përgjigjet:*

*"Shko, hyr në xhenet, vendi yt është sa e gjithë bota dhe dhjetë herë më e madhe se bota.*

*Ai drejtohet kështu:*

*Ti po tallesh me mua duke qenë se je Sunduesi i vetëm!"*

Abdullah ibn Mesudi thotë: "Për Zotin, Profeti paqja qoftë mbi të! qeshi aq shumë, sa iu dukën dhe dhëmbët e fundit."[114]

Në këtë hadith tregohet se si e ka bërë të qeshë Profetin paqja qoftë mbi të! një tablo e lidhur me ditën e fundit.

Një ngjarje tjetër që e ka bërë të qeshë të Dërguarin e Zotit, është:

Ebu Hurejre (r.a.) tregon kështu: "Erdhi njëri te Profeti dhe i tha:

"U shkatërrova, o i Dërguari i Zotit."

*"Çfarë të ka shkatërruar?"*, e pyeti i Dërguari i Zotit.

"Kam kryer marrëdhënie seksuale me gruan gjatë Ramazanit."

Pas kësaj Profeti i thotë:

*"A mund të lirosh një rob?"*

"Jo, nuk mundem", iu përgjigj ai.

*"Atëherë a ke fuqi të agjërosh dy muaj pa ndërprerje?"* e pyeti Profeti.

"Jo, nuk mundem", iu përgjigj. Profeti i tha:

*"A mund të ushqesh gjashtëdhjetë të varfër?"*

Pastaj ai u ul afër Profetit. Të Dërguarit të Zotit i sollën një kanistër me hurma. Profeti iu drejtua:

*"Merre këtë dhe jepe si sadaka!"*

Ai iu përgjigj:

- T'ia jap një njeriu më të varfër se unë? Ndërmjet banesave nga të dy krahët e Medinës, nuk ka familje më në nevojë për këtë se familja ime.

Pas kësaj përgjigjeje, Profeti qeshi sa iu dukën dhëmballët. Pastaj iu drejtua:

*"Atëherë jepja familjes tënde nëse është kështu."*[115]

## TË QARIT E PROFETIT

Sahabet e nderuar e kanë parë Profetin tonë, Profetin e mëshirës, duke qarë herë pas here. E qara e tij nuk ishte për shkak të humbjes së ndonjë gjëje materiale të kësaj bote. Ndonjëherë ka derdhur lot për vdekjen e një të ndjeri, ndonjëherë për hir të dashurisë për

umetin e tij, ndonjëherë ka derdhur lot për frikën dhe respektin ndaj Zotit, ndonjëherë duke dëgjuar leximin e Kuranit.

Nuk e ka konsideruar të shëmtuar të qarin, që është një instinkt natyror dhe i lindur, por nuk e ka pranuar vajtimin apo të qarin që kundërshton caktimin e Zotit dhe kaderin e Tij.

## QANTE ME DËNESË, PËRVËLOHEJ SI TAVË DHEU

Abdullah ibn Auf thotë: "Iu afrova të Dërguarit të Zotit ndërsa po falte namazin. Zëri i të qarit ishte sikur zëri që nxjerr një tavë dheu e valuar mbi zjarr." Shkaku i të qarit, padyshim që vinte nga frika prej Zotit. Ajo vinte si rezultat i pasqyrimit të cilësive madhështore dhe të bukura të Zotit. Sepse ai vetë ka thënë: *"Unë jam i pari në kryerjen e punëve të mira dhe jam Ai që frikësohet më shumë nga Zoti. Po të dinit ato që di unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë."*

Një herë, në Epokën e Lumturisë, ndodhi dukuria e eklipsit. Përballë kësaj vepre të mrekullueshme të Zotit, i Dërguari i Zotit u ngrit menjëherë dhe fali namaz. Aq shumë ndenji në këmbë (*kijam*) saqë dëshmitari, Abdullah b. Amr, filloi të mendonte se nuk do shkonte në sexhde. Pastaj ra në ruku. Por edhe në ruku ndenji aq gjatë saqë ai mendoi se nuk do të drejtohej. Pas një farë kohe e ngriti kokën nga rukuja dhe priti për një kohë të gjatë në këmbë. Pastaj ra në sexhde. E zgjati aq shumë saqë menduan se nuk do ta ngrinte kokën. E ngriti kokën nga sexhdja dhe priti për një kohë të gjatë mes dy sexhdeve. Përsëri ra në sexhde. Dhe në sexhden e dytë qëndroi gjatë dhe filloi të qante me dënesë. Ndërkohë i lutej Zotit duke derdhur thellësinë e zemrës: *"Zoti im! A nuk më premtove që nuk do t'i dënosh ata sa të jem unë mes tyre? A nuk më premtove se nuk do t'i ndëshkosh për sa kohë të kërkojnë të falur? Ja, shiko, ne po të kërkojmë të falur."*

Pas faljes së këtij namazi dy rekatësh kaq të gjatë, ngjau eklipsi i diellit. U ngrit dhe e falënderoi Zotin (xh.sh). Pastaj tha këto fjalë: *"Dielli dhe hëna janë dy nga argumentet e shumta të Zotit. Ato nuk mbulohen për shkak të vdekjes apo të lindjes së një personi. Nëse shihni mbulimin e këtyre dy argumenteve të mëdha, kujtoni menjëherë Zotin dhe vraponi për ta adhuruar."* Me këto fjalë, Profeti na kujton se eklipsi i hënës dhe i diellit, të cilat shihen ditët tona si veprimtari turistike, në të vërtetë janë kohë lutje dhe adhurimi ndaj Zotit.

## QANTE KUR DËGJONTE KURAN

I Dërguari i Zotit paqja qoftë mbi të! kërkon nga Abdullah b. Mesud (r.a.) t'i lexojë Kuran. Abdullah b. Mesud (r.a.) çuditet përballë një kërkese të tillë dhe i thotë: "Si mund të të lexoj Kuran, o i Dërguari i Zotit, ndërkohë që ai të ka zbritur Ty dhe i shkon më shumë gojës tënde? Profeti ynë i përgjigjet: *"Më pëlqen të dëgjoj leximin e Kuranit nga dikush tjetër"*. Abdullah b. Mesudi (r.a.) filloi të lexonte suren Nisa. Kur arrin te ajeti *"Si do shkojë puna e*

*tyre o Muhamed kur të sjellim nga një Profet për çdo popull për të dëshmuar dhe ty si dëshmitar për të gjithë?"*, pa sytë e të Dërguarit të Zotit të mbushur me lot.

## PAFAJSHMËRIA E LOTËVE QË NUK KUNDËRSHTONIN CAKTIMIN E ZOTIT

Sipas Hz. Aishes (r.a.), kur Profetit i ka vdekur vëllai prej qumështi, Osman b. Maz'un ka qarë dhe e ka puthur.

Profeti ynë paqja qoftë mbi të! kishte një djalë me egjiptianen Marije. E donte shumë dhe e përkëdhelte me dhembshuri. Ky vogëlush i pafajshëm u sëmur rëndë kur ishte dy vjeç dhe sëmundja iu përhap shumë shpejt. Në çastin e fundit, Profeti ynë paqja qoftë mbi të! e përqafoi dhe e puthi për herë të fundit duke e shtrënguar në gji. Ndërkohë nuk mund t'i përmbante lotët dhe ndjenjat e tij i shprehu me këto fjalë: *"Nuk kemi ç'të themi përballë kaderit të Zotit, o Ibrahim!"* Pasi vogëlushi ndërroi jetë, Profeti paqja qoftë mbi të! me sy të përlotur tha: *"Syri loton dhe zemra hidhërohet. Nuk na takon të themi ndonjë fjalë të papërshtatshme me kënaqësinë e Zotit. Vdekja jote na hidhëroi shumë o Ibrahim. Nëse vdekja nuk do ishte caktim nga Zoti, nëse nuk do të vinte exheli dhe ata që do vinin më pas nuk do të takoheshin me të parët, vdekja jote do të na hidhëronte edhe më shumë."*

Sahabet kur panë lotët e të Dërguarit të Zotit, edhe pse Profeti ynë paqja qoftë mbi të! ua kishte ndaluar të qarin, e pyetën për shkakun. Profeti i tha: *"Unë nuk kam ndaluar hidhërimin, por kam ndaluar vajtimin me të bërtitura dhe të çjerra, duke hedhur gurë e rrahur veten kundër kaderit. Lotët që shihni janë pasqyrim i dashurisë dhe vuajtjes që kam në zemër..."*[116]

Ibn Abasi (r.a.) transmeton: "Profeti paqja qoftë mbi të! mori në prehër një vajzë të vogël. Fëmija qëndroi pak në prehrin e tij dhe pastaj vdiq. Pas kësaj, Umu Ejmen filloi të qajë me zë të lartë. Profeti ynë u përpoq ta ndalonte vajtimin e saj me zë të lartë. Ajo iu drejtua Profetit: "A nuk të kam parë dhe ty duke qarë, o i Dërguari i Zotit? A nuk qani ndonjëherë ju?" Profeti iu përgjigj kështu: *"E qara ime nuk rrjedh nga padurimi dhe nuk është një thirrje kundërshtuese e kaderit. Shkaku i të qarit tim është mëshira ime. Padyshim që besimtari dëshiron të mirën, kudoqoftë. Vuajtja e shpirtit është një e mirë për të, për këtë arsye falënderon Zotin."*

## RAPORTET E PROFETIT ME PJESËTARËT E FAMILJES

Profeti paqja qoftë mbi të! bisedonte shpesh me pjesëtarët e familjes. Ashtu siç fliste me secilin prej tyre vetëm, kokë më kokë, ashtu fliste edhe në grup me ta. Bisedat e zhvilluara me gratë mbështeteshin në parime thelbësore. Çdo mëngjes pasi dilte nga xhamia dhe pasi falte namazin e ikindisë, vizitonte një nga një gratë e tij dhe bisedonte për pak kohë me to. Çdo mbrëmje zhvillonte biseda me to me qëllimin e bashkimit të pjesëtarëve të familjes. Transmetohet se në këto mbledhje, Profeti u tregonte grave histori të quajtura *'hurafe'* dhe gjëra gazmore që i bënin të qeshnin të gjithë.

Hz. Aishja (r.a.) tregon se kishte disa kukulla dhe luante me shoqet e saj kur vinin ta vizitonin dhe Profeti nuk e ndalonte, përkundrazi e ndihmonte[117], ndonjëherë bënte shaka nëpërmjet kukullave.[118] E kishte lejuar Aishen (r.a.) të shikonte festat e organizuara nga etiopianët për Bajram, madje duke e mbajtur mbi shpinë.[119] I ka bërë shaka të ndryshme grave të tij.[120] Madje në udhëtime të ndryshme, garonte me Aishen.[121]

Sipas transmetimit të Hz. Aishes (r.a.), një ditë ajo kishte përgatitur përshesh. Afër tyre gjendej dhe Sevdeja (r.a.). Aishja (r.a.) e fton edhe atë të hajë. Kur ajo nuk pranon, Aishja i përgjigjet: "Nëse nuk e ha, do të ta përplas surratit". Sevdeja këmbëngul në të vetën dhe Aishja merr pak nga përsheshi dhe ia lyen fytyrën. I gjendur përballë kësaj skene, Profeti qesh dhe duke i vendosur dorën Sevdes, i thotë: *"Çfarë pret, lyeja dhe ti fytyrën."* Sevde ja lyen fytyrën Aishes. Profeti qeshi edhe me të.'[122]

Profeti Muhamed paqja qoftë mbi të! ka bërë shaka edhe me fjalë. Hz. Aishja (r.a.) tregon: "Një natë po kërkoja të Dërguarin e Zotit, e nxitur nga mendimi se mos kishte shkuar tek gratë e tjera, kur dora më preku flokët e tij. Profeti duke e kuptuar situatën, më thotë: 'Ty duhet të të ketë vizituar përsëri shejtani.'[123]

Përsëri ka një transmetim tjetër rreth një shakaje me shërbëtoren Umu Ejmen, që mund të konsiderohet pjesë e familjes së Profetit:

Një ditë, Umu Ejmen shkon tek Profeti dhe i thotë:

"Më hip diku."

*"Po të hipi tek i vogli i devesë"*, i përgjigjet Profeti.

"O i Dërguari i Zotit! I vogli i devesë nuk mund të më mbajë", i drejtohet Umu Ejmen.

*"Nuk mund të të hip në ndonjë vend tjetër, përveçse te i vogli i devesë"*, i thotë Profeti, duke nënkuptuar se 'çdo deve quhet i vogli i një deveje tjetër'. Transmetuesi i hadithit na thekson se Profeti edhe në shakatë e bëra nuk është ndarë kurrë nga e vërteta.[124]

Fjalë dhe veprime të ndryshme të Profetit tregojnë për interesimin dhe vlerësimin e pjesëtarëve të familjes dhe tregojnë që Ai i ka dhënë rëndësi edhe kënaqësisë së tyre përsa i përket aspektit shpirtëror. Shumë veprime të Profetit paqja qoftë mbi të! janë të lidhura me gëzimin e grave, si: shprehja e virtyteve grave të tij,[125]shprehja e dashurisë ndaj tyre,[126] marrja në kalë,[127] larja bashkërisht me ujin e një ene,[128] ndihmesa që u jepte për t'i hipur në kalë,[129] përgjigja e ftesës për drekë me kusht që *"të ishte edhe gruaja bashkë me të"*[130], ngushëllimi dhe fshirja e lotëve kur ato ishin të mërzitura[131].

Safija tregon se njëherë kishin qenë të hipur të dy mbi një deve, i kishte rrëshqitur këmba devesë dhe ishin rrëzuar të dy. Ebu Talhas (r.a.) që vrapoi për të na ndihmuar, Profeti i thotë: *"Kujdesuni për gruan, merruni me të."*[132]

Edhe pse jo në të njëjtën masë, Profeti paqja qoftë mbi të! ka shfaqur respekt jo vetëm ndaj grave të tij, por ndaj çdo personi që e konsideronte të familjes. Ndërmjet grave, Hz. Aishja (r.a.) arriti një dashuri dhe një respekt të veçantë. Edhe xhaxhai i tij, Abasi, është trajtuar me një respekt ndryshe. I Dërguari i Zotit e ka dashur atë si babanë e Tij, është këshilluar me të për çështje të ndryshme dhe ka pranuar gjithnjë ndërmjetësimin e Tij.[133]

Dashuria e Profetit tonë ndaj Zejdit dhe djalit të tij Usame (r.a.) ishte e veçantë dhe domethënëse. I njohur ndryshe si *"Hibbu Resulullah"*- i dashuri i Profetit, Usame ka arritur lartësinë e dashurisë profetike, të njëjtë me dashurinë ndaj nipërve Hasan dhe Hysen[134], duke zënë vend mes atyre të cilëve nuk do t'u refuzohet shefaati.[135] I nderuar, i vlerësuar nga Profeti duke hipur në pjesën e pasme të devesë së Profetit, në ditët e Çlirimit të Mekës dhe në ditën e haxhit, megjithëse tetëmbëdhjetë vjeç, Usame u caktua si komandant nga

Profeti në ushtrinë ku merrnin pjesë edhe të mëdhenjtë e muhaxhirëve si Ebu Bekri, Omeri, Ebu Ubejde ibn Xherrah, etj.[136]

Profeti nuk i ka nënvlerësuar lidhjet dhe komunikimin jo vetëm ndaj pjesëtarëve të familjes, por edhe ndaj të afërmve të tyre. Kështu që, kur Aishja (r.a.) pa Profetin duke i bërë kompliment një gruaje të moshuar, pasi ajo iku, e pyeti për shkakun e komplimentit. Ai iu përgjigj: *"O Aishe, kjo grua është mike e Hatixhes. Na vizitonte kur ajo ishte gjallë. Respekti ndaj miqve rrjedh prej besimit."*[137] Hz. Aishja (r.a.) thekson se për shkak të lidhjes së Profetit paqja qoftë mbi të! me të afërmit, çdo herë kur prisnin ndonjë qengj, u dërgonte atyre nga një pjesë.[138]

I emocionuar tejmase kur sheh varësen e dhënë si dëmshpërblim për dhëndrin e tij mes robërve të Bedrit, Profeti kërkon t'i kthehet mbrapsht dhe i pranohet kërkesa. Këtë varëse, Hatixhja ia kishte dhuruar Zejnebit, vajzës së saj kur ishte martuar.[139]

Hz. Enesi (r.a.) tregon: "I Dërguari i Zotit ndodhej pranë njërës prej bashkëshorteve. Njëra prej tyre i kishte dërguar ushqim në një pjatë. Zonja e dhomës e thyen pjatën duke i rënë dorës së Profetit. Profeti mblodhi gjellën e derdhur në dy pjesët e ndara të pjatës dhe iu drejtua: *"U bëtë xheloze për nënën tuaj, po ejani, urdhëroni, hani tani!"* Në një transmetim që vjen më pas, theksohet se si Hz. Aishja thyen pjatën e sjellë nga Hz. Hafsa me një gur. Ndërsa në një transmetim të tretë, Hz. Aishe pasi thekson se nuk kishte parë njeri tjetër të gatuante si Safija, pranon se e kishte thyer pjatën e nevrikosur. Përballë këtyre sjelljeve tregohet se përveç mbledhjes së ushqimit krejt i qetë dhe fjalëve: *"U bëtë xheloze për nënën tuaj, urdhëroni hani!"*, nuk ka pasur ndonjë reagim tjetër nga ana e Profetit.[140]

Nga transmetimet e dhëna shohim se si Profeti ka ndihmuar gratë e tij në disa punë të shtëpisë. Kur e pyetën Hz. Aishen (r.a.) se çfarë bënte Profeti në shtëpi, i përgjigjet kështu: "I shërbente familjes dhe dilte kur vinte koha e namazit." Kur pyetën se me çfarë punësh merrej, përsëri në një transmetim të saj, ajo thotë: "Rregullonte këpucët, arnonte rrobat, qepte, pastronte rrobat, milte delen, rregullonte kovën, kryente punët e veta dhe çdo lloj pune tjetër që mund të bëni ju burrat në shtëpi."[141] Në disa transmetime thuhet se edhe ka gatuar.[142]

Përveç kësaj, Profeti nuk i ka lënë pas dore edhe komplimentet ndaj grave të tij. Theksojmë edhe kujdesin që tregonte i Dërguari i Zotit për argëtimin e pjesëtarëve të familjes. Profeti ka lejuar argëtimin, dëfrimin në disa ceremoni, si në dasma dhe në ditët e Bajramit. Profeti ynë ka qenë gjithashtu i duruar me gratë e tij.

Përsëri, zotëria i dy botëve, Profeti ynë, ka dhënë një shembull tjetër të bukur, konsultimin me gratë. Ai ishte frikësuar nga ato që kishte parë kur i kishte ardhur shpallja për herë të parë dhe atë frikën e brendshme ia kishte treguar Hz. Hatixhes. Ajo e qetësoi dhe e ngushëlloi Profetin.[143] Dihet që edhe martesa mes vajzës së tyre, Zejnebit dhe Ebul Asit, është bërë me propozimin e saj. Madje transmetuesi pasi thekson propozimin për martesë të Hz. Hatixhes për vajzën e tyre me Ebul Asin dhe pranimin e propozimit nga Profeti, kumton një fjali shumë të rëndësishme në lidhje me temën tonë: "I Dërguari i Zotit nuk e kundërshtonte Hz. Hatixhen."[143] Bashkangjitur me këtë, në ngjarjen e shpifjes ndaj Hz. Aishes, e quajtur ndryshe si ngjarja *Ifk,* Ai ka pyetur rreth Aishes (r.a.), robëreshën e saj, Beriren, dhe Zejneb Bintu Xhahsh.[145] Edhe shembulli i Umu Selemes është domethënës.

Pasi bëhet marrëveshja e Hudejbijes dhe pranohet pika për të mos bërë umre atë vit, sahabet nuk kishin mbetur të kënaqur dhe nuk deshën të dëgjonin urdhrin e Profetit për të dalë nga *ihrami*. Pasi kishte marrë vesh shqetësimin e Profetit, Umu Seleme i drejtohet me këto fjalë: "O, I Dërguari i Zotit! Ngrihu dhe prit kurbanin tënd, ata do të bëjnë si ti dhe do t'i presin kurbanet." Profeti veproi ashtu dhe sahabet me të vërtetë e ndoqën.[146]

## RAPORTET E PROFETIT ME NJERËZIT

Shembulli më i bukur për njerëzimin, Profeti ynë, ashtu si në çdo fushë të jetës, edhe në jetën sociale, në marrëdhëniet me njerëzit, ishte një shembull i përkryer. Profeti Muhamed paqja qoftë mbi të! kur propozonte diçka, e praktikonte vetë më parë dhe në të njëjtën kohë nuk linte pas dore edukimin e komunitetit për arritjen e tipit të jetës me të cilën Zoti është i kënaqur.

Profeti ynë i vlerësonte njerëzit, jetonte mes tyre dhe bënte një jetë të ngjashme me ta. Përshëndeste (jepte selam) i pari kur takohej me njerëz, u jepte dorën dhe i pyeste rreth shëndetit dhe gjendjes së tyre. Dëgjonte me kujdes fjalët që i thuheshin dhe nuk e kthente kokën në drejtim tjetër derisa folësi të largohej. Enes ibn Maliku (r.a.) na e tregon kështu këtë veçori të Profetit: "Kur Profeti takohej dhe fillonte të fliste me dikë, Ai nuk e kthente kokën derisa personi përballë tij ta kthente i pari. Kur takohej me dikë dhe i jepte dorën, nuk e tërhiqte dorën derisa ta lëshonte tjetri. Kur ulej me shokët e tij nuk i shtrinte kurrë këmbët."[147]

Profeti ynë e vlerësonte individin pikësëpari nga të qenit njeri. Një nga shembujt më të bukur dhe tepër të qartë, është ky: Një ditë, kur Profeti qëndronte i ulur bashkë me sahabet, para tyre kaloi një xhenaze dhe Profeti paqja qoftë mbi të! me ta parë, u ngrit në këmbë. Ata që gjendeshin afër tij i thonë se nuk ishte xhenazja e ndonjë myslimani, por e një çifuti dhe për këtë arsye nuk ishte e nevojshme të ngrihej në këmbë. Pas fjalëve të tyre, Profeti u përgjigjet kështu: *"Mysliman nuk qenka, po a nuk është njeri?"*[148]

Një dëshmi e vlerësimit të njeriut është edhe ndalimi i të folurit keq për një njeri pas vdekjes[149] si dhe i qëndrimit mbi varre.[150]

Profeti interesohej për problemet e sahabeve dhe u qëndronte shumë afër. Përkrah çështjeve të përgjithshme, ai nuk ka lënë pas dore detajet dhe është interesuar edhe për problemet më të vogla.

Ashtu siç interesohej për problemet e myslimanëve, Profeti gjithashtu i këshillonte ata të bënin të njëjtën gjë. Rreth kësaj teme ka thënë: *"Kush i heq një myslimani njërin prej shqetësimeve të kësaj bote, Zoti do t'i heqë atij ditën e kiametit një prej shqetësimeve të tij. Kush e ndihmon dikë që është në gjendje të vështirë, Zoti do ta ndihmojë atë në këtë botë dhe botën tjetër. Kush i fsheh një të metë një myslimani, Zoti do t'ia fshehë të metat e tij ditën e kiametit. Zoti do ta ndihmojë robin e tij për aq kohë sa robi do të ndihmojë vëllanë e tij."*[151]

Profeti ynë vazhdimisht buzëqeshte, një buzëqeshje që shoqëronte gjithnjë fytyrën e tij. Ai asnjëherë nuk ka qeshur me zë të lartë. E qeshura e Tij ishte në formën e buzëqeshjes.[152] Sahabet e tregojnë gjithnjë të buzëqeshur.[153] Xherir b. Abdullah ka thënë: "I Dërguari i

Zotit nuk më ka penguar t'i qëndroj pranë që kur jam bërë mysliman. Nuk ka ndodhur asnjëherë që të mos më buzëqeshë sa herë që më shihte."[154]

Profeti paqja qoftë mbi të! ishte fytyrëqeshur dhe i nxiste sahabet të ishin të tillë: *"Një buzëqeshje e dhuruar është një sadaka për ty."*[155] *"Mos nënvlerëso asnjë lloj të mirësisë, qoftë kjo dhe një buzëqeshje dhuruar vëllait tënd."*[156] Profeti ka kaluar shumë momente të dhimbshme gjatë jetës. Madje mund të thuhet se nuk kishte mbetur vuajtje dhe mundim pa hequr. Ndaj dhe themi që kishte përjetuar të gjitha llojet e mërzisë. Megjithatë, ai bashkë me hidhërimin, gjithnjë kishte një buzëqeshje në fytyrë. Kjo ishte një meritë që i përket vetëm Profetit tonë.[157]

Një çështje të cilën Profeti e ka vlerësuar shumë dhe e ka pasur si princip në jetën e tij, është shkëmbimi i selamit (përshëndetja islame). *"Njeriu më i pranuar te Zoti është ai i cili jep selam i pari në një takim."*[158] Profeti gjithnjë jepte i pari selam kur takohej me dikë.[159] U ka dhënë selam fëmijëve[160] dhe grave[161], ndërsa selameve të dhëna nga hebrenjtë dhe të krishterët (*ehli kitab*) u përgjigjej vetëm me fjalët *"ve alejkum"*[162]. Me fjalët: *"Selam është një nga emrat e Zotit. E ka vendosur në tokë. Atëherë përhapeni atë mes jush"*[163,] tregon rëndësinë e selamit. Në një hadith tjetër, thotë: *"Nuk mund të hyni në xhenet pa besuar dhe nuk do mund të jeni besimtarë të mirëfilltë pa dashur njëri-tjetrin. A t'ju tregoj për diçka të cilën nëse e bëni, do ta shtojë dashurinë mes jush? Përhapeni selamin!"*[164] Me këto fjalë thekson se përhapja e selamit forcon lidhjet mes individëve dhe zhvillon ndjenjat e dashurisë, të mëshirës dhe dhembshurisë ndaj njëri-tjetrit. Ai ka kërkuar të jepet selam kur hyn dhe kur del nga një tubim apo mbledhje.[165] Pyetjes së një sahabe se cila veçori në fenë islame shihet si më e mira, ai i përgjigjet: *"Të ushqesh dikë dhe t'i japësh selam të gjithë atyre që njeh dhe atyre që nuk njeh."*[166] Duke theksuar gjithashtu se është e përshtatshme që t'i japë selam ai që ndodhet i hipur mbi kalë atij që është në këmbë, ai që është në këmbë atij që është ulur, një grup i vogël njerëzish një grupi më të madh,[167] Profeti ynë ka shpjeguar shumë detaje në lidhje me selamin dhe është munduar për përfshirjen e selamit në moralin e komunitetit.

Një veçori tjetër specifike e Profetit tonë në marrëdhëniet me njerëzit është mosdallimi mes të pasurve dhe të varfërve. Në këndvështrimin e tij, të gjithë ishin të barabartë, i pasuri, i varfri, fëmija, zotëria, robi. Për këtë arsye, Profeti nuk bënte dallime mes njerëzve.[168] Epërsia në Islam nuk lidhet me pasurinë, por me devotshmërinë (*takva*), siç theksohet në Kuran, të jetosh në përshtatje me pëlqimin e Zotit.[169] Shohim se Profeti ka treguar interes të veçantë për të varfrit. Në një hadith thotë: *"Kërkojini të varfrit dhe kujdesuni për ta. Sepse ju ndihmoheni dhe furnizoheni me të mira vetëm me ndihmesën ndaj tyre."*[170] Një nga këshillat që Profeti i ka dhënë Ebu Dherrit, është: *"Duaji të varfrit dhe gjindu pranë."*[171] Profeti nuk ka dashur që robërit apo robëreshat të thirreshin me emrat "robi im, robëresha ime", por të thirreshin me emra si "djalosh, i ri, bir, bijë".[172] Nëpërmjet hadithit: *"Ka një njeri me flokë të pakrehur, të përzënë derë më derë dhe të pavlerësuar ndonjëherë, i cili nëse do të betohej, Zoti nuk do ta nxirrte gënjeshtar në betimin e tij (në lidhje me çfarëdo çështje)"*[173], na bën të ditur se nën një pamje të jashtme, të varfër, mund të fshihet një zemër e vyer për Zotin dhe na fton të tregohemi të kujdesshëm.[174] Kryesorja tek hadithi: *"Njerëzit janë bijtë e Ademit. Dhe Zoti e krijoi Ademin nga dheu"*[175], është theksimi i barazisë mes njerëzve.

Profeti ynë ishte njeri i brishtësisë, i delikatesës dhe i mirësjelljes. Ai nuk bënte asnjë veprim apo sjellje që të dëmtonte mjedisin përreth. Nga natyra ishte i butë.[176] Hynte në zemrat e njerëzve dhe nuk urrehej nga ta. Përballë njerëzve ishte gjithnjë fytyrëqeshur dhe sillej mirë me ta. Nuk ishte njeri me vese të këqija, zemërgur dhe fjalërëndë. Nuk grindej me askënd, nuk përdorte fjalë të pahijshme dhe nuk turpëronte asnjeri. Distancohej gjithmonë nga koprracia. Nuk merrej me punë që nuk i pëlqenin.[177]

Ishte shumë i sjellshëm sepse kishte arritur caqet e edukatës hyjnore. Këtë arritje e shpjegon vetë me këto fjalë: *"Mua më edukoi Zoti im. Prandaj jam edukuar kaq mirë."*[178] Ai ishte shembulli më i përkryer për njerëzimin. Ky ishte dhe qëllimi i dërgimit të tij. Sepse ai vetë thotë: *"Unë jam dërguar për të përsosur moralin e bukur."*[179] Kurani e përforcon këtë me ajetin: *"Padyshim që Ti (Muhamed) je me moral të lartë."*[180] Ndërsa Abdullah b. Amr transmeton një pasazh nga Teurati në lidhje me Profetin tonë: "Ai nuk është i ashpër dhe i vrazhdë. Në treg nuk bërtet dhe nuk flet me zë të lartë. Të keqes nuk i përgjigjet me të keqe."[181]. Edhe nga kjo kuptojmë se brishtësia dhe mirësjellja e Profetit tonë ka zënë vend dhe në librat e vjetër hyjnorë.[182] Hz. Aishja (r.a.) thotë: Një ditë, i Dërguari i Zotit hyri në dhomën time, u kthye nga kibla dhe ngriti duart për t'u lutur: *"Zoti im! Unë jam njeri, nëse kam mërzitur apo fyer ndonjë nga robërit e tu, mos më dëno për këtë."*[183]

Enes b. Malik që i ka qëndruar pranë Profetit për shumë vjet, tregon: "I kam shërbyer për dhjetë vjet Profetit, nuk më ka thënë asnjëherë *of*. Kur bëja diçka, nuk më ka thënë "pse e bëre?", kur nuk e bëja "pse nuk e bëre?"[184] Sepse Ai, sipas një shprehjeje të Enes b. Malikut, ishte njeriu me moralin më të bukur ndër njerëz.[185]

Besnikëria është një nga cilësitë më të dukshme të Profetit në marrëdhënie me të tjerët. Kjo cilësi kristalizohet edhe tek bashkëshortja e parë dhe bashkëvuajtësja e tij, Hz. Hatixhja. Sepse të gjithë dyshuan te Profeti kur u tha të tjerëve se i kishte ardhur engjëlli. Por Hz. Hatixhja, e cila e njihte mirë Profetin e nderuar, e besoi pa asnjë dyshim. Ia besoi atij gjithë pasurinë. E mbështeti të Dërguarin e Zotit me gjithë qenien e saj.[186] Sigurisht që një bashkëshorte të tillë që kishte kaluar njëzetekatër vjet bashkë me të, nuk mund ta harronte njeriu besnik. Nuk mund të harroheshin vështirësitë e përjetuara në ditët e para të Islamit dhe përballimi i tyre së bashku. Ndaj dhe Profeti ynë i nderuar e kujtonte në çdo çast dhe respektonte kujtimin e saj.[187] Një herë do t'i dërgonte një dhuratë dikujt. Sahabes i drejtohet me këto fjalë: *"Këtë dhuratë çojeni në shtëpinë e filan gruaje sepse ajo ishte shoqja e Hatixhes. E donte shumë atë."*[188]

Profeti ynë ka pasur një respekt të thellë ndaj mëndeshës së Tij. Kur nëna e qumështit, Halimja, e viziton atë pas shumë vitesh, pas çlirimit të Mekës, i shtron pelerinën e tij për t'u ulur dhe e respekton.[189] Kur i ka ardhur vëllai prej qumështi, është ngritur në këmbë dhe e ka ulur mbi veshjen e tij.[190] Edhe motrën prej qumështi, Shejmën, të sjellë mes robërve të Hevazinit, e ka gostitur, është interesuar për të dhe e ka përcjellë me dhurata të ndryshme kur u kthye tek fisi i saj.[191] Ai kujtonte në çdo rast bujarinë e ensarëve të cilët kishin hapur dyert e shtëpive dhe i kishin mirëpritur dhe lutej gjithnjë për ta.[192] Frikës që patën ensarët kur u çlirua Meka, mos Profeti nuk kthehej më në Medinë, i përgjigjet: *"Jeta dhe vdekja ime do jetë pranë jush."*[193]

Këto fjalë të cilat tregojnë besnikërinë e Profetit tonë, kishin hequr shqetësimin e myslimanëve ensarë dhe kishte qetësuar shpirtrat e tyre.

Gostitja e mysafirit,[194] një nga cilësitë e Ibrahimit (a.s.) e përmendur në Kuran, zë vend mes të cilësive më të larta të Profetit. Mund të themi që mysafirët nuk mungonin asnjëherë në sofrën e tij. Sipas një transmetimi të Ibn Sa'dit, kur Ebu Hurejre thotë se Profeti qëndronte i uritur, A'rexhi e pyet se si qëndronte. Ebu Hurejre tregon se kjo ndodhte për shkak të vizitave të shumta që i bëheshin dhe se me të qëndronte një grup njerëzish të pandarë. Përveç kësaj Ebu Hurejre thotë se Profeti nuk hante asnjëherë pa sahabet apo banorët e Sufes.[195] Profeti ynë kujdesej vazhdimisht për banorët e Sufes. Ata nuk kishin ku të rrinin, nuk kishin pasuri dhe kush që t'i mbështeste. Çdo sadaka, dhuruar Profetit, shkonte për ta; Ai nuk mbante gjë për vete. Nëse ishte dhuratë, ia dërgonte përsëri atyre, por këtë herë merrte dhe vetë një pjesë; në këtë mënyrë e ndante dhuratën me ta. Përveç kësaj, Profeti i ftonte për drekë dhe u siguronte ushqimet.[196]

Profeti ynë në çdo rast gostiste sahabet që ishin të varfër dhe që kishin probleme materiale. Atë e vizitonin vizitues dhe delegatë nga çdo anë e Arabisë. Mysafirët e shumtë në numër qëndronin për një farë kohe në Medinë. Profeti interesohej gjithnjë për mysafirët, qofshin këta delegatë diplomatikë apo njerëz të thjeshtë, siguronte gostitjen e tyre me sa kishte mundësi. P.sh., kur tregojnë për pritjen e delegacionit *Beni Hanife,* në shtëpinë e Remle b. Haris, thonë se janë pritur një herë me bukë dhe mish në mëngjes e darkë, një herë me bukë e qumësht dhe njëherë me bukë e gjalpë.[197]

Profeti kishte ngarkuar disa sahabe të merreshin me gostitjen e delegacioneve që vizitonin Medinen[198], përgatisnin ushqimet për rrugë[199] dhe u jepnin dhurata.[200] Profeti ynë, ai i cili i gostiste në mënyrën më të mirë mysafirët, na nxit ta gostitim mysafirin[201] dhe thotë që nuk do ketë mirësi ai i cili nuk e gostit atë.[202] Në hadithin: *"Në shtëpinë ku ka mysafirë, mirësia arrin më shpejt nga sa arrin thika gungën e devesë"*[203], tregon se në shtëpinë ku gjenden mysafirë ka mirësi dhe begati.

Profeti ynë i puthte fëmijët dhe nipat e tij, i përkëdhelte dhe i donte shumë.[204] Ai sillej me dhembshuri dhe mëshirë ndaj fëmijëve. Që ky mesazh të kuptohet dhe përftohet nga të gjithë myslimanët, në një hadith Ai shprehet: *"Nuk është prej nesh ai që nuk ka dhembshuri për të vegjlit dhe respekt për të mëdhenjtë."*[205] Në periudhën e injorancës, arabët nuk i përkëdhelnin dhe nuk i donin fëmijët e tyre. Një herë, erdhi tek Profeti një nomad që jetonte në shkretëtirë dhe e pyeti: "A i puthni ju fëmijët?" Profeti iu përgjigj: "Po". Ata iu drejtuan: "Ndërsa ne, për Zotin nuk i puthim." Profeti u tha: *"Ç'mund të bëj unë nëse Zoti ka nxjerrë nga zemrat tuaja ndjenjën e mëshirës e të dhembshurisë!"*[206] Përsëri, një herë tjetër, Akra b. Habis, kur sheh Profetin duke puthur Hasanin, i thotë se ai kishte dhjetë fëmijë dhe nuk kishte puthur kurrë, asnjërin prej tyre. Profeti i është përgjigjur kështu: *"Nuk mëshirohet ai i cili nuk mëshiron."*[207]

Profeti ka thënë se gratë më të mira ndër gratë arabe janë gratë e Kurejshëve. Ai është shprehur kështu: *"Ato janë të dhembshura, i duan fëmijët e tyre dhe mbrojnë në mënyrën më të mirë gjërat që i përkasin burrave të tyre."*[208]

Në aspektin e marrëdhënieve me njerëzit, vlen të përmendim rëndësinë që i ka dhënë Profeti vizitës së të sëmurit. Kujdesej për të gjithë sahabet, të mëdhenj apo të vegjël qofshin, pyeste për ta dhe vizitonte të sëmurët. Në vizitat e tij nuk bënte dallime, grua, burrë apo fëmijë. Umul A'la nga ensarët tregon se Profeti e kishte vizituar kur kishte qenë

i sëmurë dhe i kishte thënë: *"O Umul Ala! Përgëzime, ashtu siç zjarri zhduk papastërtinë e arit dhe të argjendit, ashtu dhe sëmundja e një myslimani ia zhduk mëkatet atij."*[209]

Profeti Muhamed paqja qoftë mbi të! kishte vizituar nipin e tij, Umamen, kur ishte sëmurë dhe i kishin rrjedhur lot. Një sahabe që kishte kritikuar të qarën e tij, i ishte përgjigjur: *"Kjo është mëshirë, Zoti e vendos në zemrën e atij që do. Zoti mëshiron vetëm ata robër që mëshirojnë."*[210]

Sad b. Ebi Vakas ishte sëmurë rëndë gjatë haxhit të Lamtumirës. I ishin venitur shpresat për t'u kthyer në Medinë. Profeti e kishte vizituar dhe ishte lutur për shërimin e tij.[211]

Krahas myslimanëve, Profeti ka vizituar edhe të sëmurë jomyslimanë. Ka vizituar fëmijën e një hebreu që i shërbente, i ka kërkuar të bëhej mysliman dhe fëmija është bërë mysliman.[212] Profeti ynë ka vizituar dhe kreun e hipokritëve, Abdullah b. Selulin kur ishte sëmurë.[213] Ka praktikuar vetë vizitën e të sëmurit dhe ka këshilluar dhe sahabet ta bëjnë.[214] Kur i vizitonte të sëmurët, lutej për ta[215] dhe u jepte kurajë. Ka këshilluar dhe umetin e tij që t'i përkrahin dhe t'i japin kurajë të sëmurëve.[216] Ai gjithashtu u ka kërkuar të sëmurëve që të kuroheshin.[217]

Profeti ynë ka këmbëngulur gjithmonë që t'i bëhen dhurata të tjerëve. Duke thënë: *"Bëni dhurata që t'ju shtohet dashuria mes njëri-tjetrit"*[218], pranonte dhe jepte dhurata.[219] Për të dëshmuar se si dhurata afron dhe shton dashurinë mes njerëzve, ai thotë: *"Bëjini dhurata njëri-tjetrit sepse dhurata zhduk zilinë dhe urrejtjen e zemrës."*[220] Ka kërkuar që dhurata e marrë të pranohet dhe të mos nënvlerësohet.[221] Profeti ka këshilluar që dhurata duhet të kthehet me diçka tjetër: *"Kujt i bëhet dhuratë diçka, le t'i përgjigjet me dhuratë. Nëse nuk ka ç'ka të japë, le ta lavdërojë. Kush lavdëron, falënderon. Kush nuk falënderon, është mosmirënjohës."*[222]

Profeti nuk harronte asnjëherë t'u jepte dhurata delegacioneve. Për shkak të rëndësisë së këtyre dhuratave, edhe në shtratin e vdekjes, ka dhënë këto këshilla: *"Delegacioneve që do vijnë jepuni dhurata siç kam bërë unë."*[223] Sepse me anë të dhuratës ai ka fituar shumë zemra dhe e ka konsideruar atë një mjet të rëndësishëm për të treguar dhe për të dashur Islamin.[224]

Profeti nuk shikonte te shokët e tij të afërt kritere si pasuria, posti, derë a fismë etj. Ai vlerësonte devotshmërinë. Respektonte shumë njerëzit e besuar, të ndershëm dhe të dhënë pas adhurimit dhe bindjes.

Si përfundim, më poshtë po japim disa fragmente nga një përkthim shemaili:

Nipat e Profetit Muhamed paqja qoftë mbi të!, transmetojnë nga babai i tyre Hz. Aliu (r.a.): "... Profeti paqja qoftë mbi të! e ndante kohën ditore në tri pjesë. Një pjesë e ndante për adhurime ndaj Zotit, si: të falurit namaz dhe të lexuarit e Kuran. Pjesën e dytë e ndante për kujdesje ndaj familjes: kryente punët e përditshme në shtëpi, plotësonte detyrat që i takonin rreth nevojave të shtëpisë. Ndërsa pjesën e tretë e ndante për pushim. Vetëm se pjesën e pushimit e ndante në dy pjesë të tjera: në njërën prej të cilave pranonte vizitat e sahabeve dhe u mësonte njohuritë e nevojshme. Shokët, pasi ndaheshin nga Profeti, u mësonin të tjerëve ç'ka kishin mësuar."

Njerëzit e varfër paraqisnin para Profetit, një, dy ose më shumë kërkesa. Profeti i dëgjonte ata pa u mërzitur, kujdesej për ta dhe interesohej për plotësimin e nevojave. Kur e pyesnin rreth botës apo ahiretit, përgjigjej në mënyrën më të përshtatshme të nivelit të

pyetësit dhe në të mirën e tij. Me përgjigjen e dhënë, e drejtonte pyetësin drejt së mirës. Gjithnjë i ka këshilluar të pranishmit: *"Mësojani njohuritë e marra atyre që nuk ndodhen këtu. Më përcillni dëshirat, nevojat e atyre njerëzve që për arsye të ndryshme nuk kanë mundur t'i shprehin në praninë time, qoftë burrë, grua, rob apo robëreshë. Padyshim, Zoti i Madhëruar ditën e kiametit do ta ndihmojë në urën e siratit personin që ndihmon njerëzit që nuk kanë fuqi t'ia shprehin kërkesat e tyre kryetarit të shtetit."*

Nuk lejonte që në praninë e tij të përdoreshin fjalë të pahijshme apo të panevojshme. Edhe kur dilte jashtë, nuk linte mënjanë modestinë. Me fytyrën e tij të qeshur shëtiste kudo, në treg, në rrugë, apo në vende të tjera, i pyeste për shëndetin, u drejtohej me fjalë të ëmbla dhe u hynte njerëzve në zemër. Menjëherë pyeste për gjendjet e sahabeve që nuk i shikonte në xhami, mbledhje apo ditën e xhuma, përpiqej të mësonte mos u kishte ndodhur gjë. Ndërsa atyre që takonte u përforconte njohuritë bazë të fesë dhe u tregonte gjëra që i afronin tek e mira, e bukura dhe që i largonin nga të këqijat.

Kur Profeti paqja qoftë mbi të! hynte te një grup njerëzish të ulur, nuk bezdiste njeri për të dalë në krye të vendit, por ulej menjëherë ku kishte vend bosh, në fund të grupit. Kështu dëshironte që të vepronin edhe të tjerët. Ata që ndodheshin në mbledhje, i përmendte me mirësi dhe i respektonte në një mënyrë të tillë, saqë çdokush afër tij ndihej si më i vlerësuari. Kur dikush qëndronte gjatë pranë tij, saqë i tejkalonte kufijtë, duronte duke mos krijuar probleme dhe krejt i qetë përpiqej t'ia plotësonte tjetrit kërkesat. Nëse i kërkohej diçka që e kishte, e jepte menjëherë, përndryshe, duke i hyrë në zemër, ia premtonte me fjalë të ëmbla. Mëshira, dhembshuria, bujaria dhe modestia e Profetit paqja qoftë mbi të! njihej nga të gjithë. I gjithë populli ishte i sigurt për përkujdesjen dhe lidhjen e fortë mes tyre dhe Profetit paqja qoftë mbi të! Gjithkujt i jepte atë që i takonte dhe në aspektin e të drejtës nuk përzgjidhte askënd para të tjerëve.

Tubimi i Profetit paqja qoftë mbi të! ishte tubim diturie, durimi, amaneti dhe sedre. Të gjithë silleshin me mirësjellje dhe edukatë. Respektonin njëri-tjetrin. Nuk flisnin me zë të lartë dhe jashtë etikës. Çështjet për të cilat flitej aty dhe nuk duhej të merreshin vesh jashtë, nuk i transmetonin jashtë dhe nuk merreshin me thashetheme. Aty nuk flitej kundër tjetrit dhe nuk akuzohej askush. Nëse dilnin në shesh të metat e ndonjë sahabi, njerëz jemi, ato mbeteshin aty dhe nuk përhapeshin. Njerëzit e takimit ishin njerëz të një gjuhe dhe goje të vetme. Të bashkuar në çështjen e zemrës, të mirëkuptuar në fjalët e thëna, ishin njerëz që kishin arritur harmoninë e bashkimit. Në komunitetin e Tij mbizotëronte modestia dhe si rrjedhojë, nxitej respekti për të moshuarit dhe dhembshuria ndaj të vegjëlve. Të gjithë së bashku përpiqeshin pikësëpari të plotësonin kërkesat e njerëzve në nevojë. Për të ndihmuar njerëzit në nevojë, zgjidheshin njerëz që nuk kishin mungesa dhe nevoja.[225]

## TRASHËGIMIA E PROFETIT

Sipas transmetimit të Amr b. Harisit, Profeti Muhamed paqja qoftë mbi të! pas vdekjes ka lënë shtizën, shpatën, mburojën, helmetën, mushkën e quajtur '*dyldyl*' dhe tokat e lëna si sadaka.

Në transmetimin e Ebu Hurejres (r.a.), vajza e Tij, Fatime (r.a.) shkon te Ebu Bekri (r.a.) dhe e pyet: "Cilët janë trashëgimtarët e tu?" Ebu Bekri (r.a.) i përgjigjet: "Familja ime dhe

fëmijët e mi”. Fatimja e pyet përsëri: “Po me mua ç'do bëhet. Nuk jam trashëgimtare as e babait tim.” Ebu Bekri iu përgjigj kështu: “Kam dëgjuar Profetin e nderuar duke thënë se ne nuk mund të lëmë trashëgimtarë pas nesh. Por unë do të marr përsipër të plotësoj nevojat e njerëzve që më parë i plotësonte Profeti.” Me këto fjalë ai e ngushëlloi Hz. Fatimen.

Sipas një transmetimi të Hz. Aishes (r.a.), Profeti ka thënë: *“Ne profetët nuk lëmë trashëgimi. Gjithçka që lëmë prapa, vlerësohet si sadaka.”* Përsëri Hz. Aishe (r.a.) thotë: “I Dërguari i Zotit (s,a,s) nuk ka lënë as dinarë, as dirhem, as dele e as deve.”

# PJESA E TRETË

# MORALI I BUKUR I PROFETIT TONË

MORALI I BUKUR I PROFETIT

KURAJA DHE GUXIMI I PROFETIT

Personalitetet liderë që do të udhëheqin njerëzit, duhet të përfshijnë në natyrën e tyre të krijimit kurajën dhe guximin. Nuk mund të bëhet udhëheqës një njeri që nuk është guximtar. Udhëheqësi duhet të ketë sy të mprehtë dhe zemër të madhe. Mund të vijë një kohë kur ai të mbesë vetëm. Guximi i trashëguar do ta shpëtojë nga poshtërsia në të cilën ndodhet për momentin. I detyruar, të përballet i vetëm për idealin dhe çështjen e tij, lideri duhet të veprojë sikur ka me mijëra ndjekës pas tij që të mund t'ia arrijë qëllimit. Udhëheqësi nuk duhet të frikësohet kurrë nga vdekja. Edhe nëse fshehtazi frikësohet nga gjithçka, atëherë nuk mund të jetë një drejtues e udhëheqës.

Para së gjithash, Profeti ynë paqja qoftë mbi të! ishte një monument i kurajës dhe i guximit. Hz. Aliu (r.a.), heroi i fushëbetejave, e tregon këtë anë të Profetit me këto fjalë: “Kur e shihnim veten ngushtë gjatë luftës, të gjithë strehoheshim tek Profeti.[226] Kjo shpreje dëshmon më së mirë guximin e tij duke treguar se në këtë fushë askush s'mund të krahasohej me Të.

Ngjarja e ndodhur mes Profetit dhe një qafiri me emrin Gavres, na mjafton si shembull i përcaktimit të madhështisë së kurajës dhe guximit të Tij. Kur Profeti paqja qoftë mbi të! po pushonte nën hijen e një peme, Gavresi, duke përfituar nga fakti se ai po flinte, ia merr shpatën dhe i drejtohet me një ton tallës: "Kush do të të shpëtojë ty tani nga duart e mia?" Si përgjigje, Profeti Muhamed paqja qoftë mbi të!, pa treguar asnjë shenjë paniku dhe i sigurt në vetvete, i thotë: "Allahu". Një përgjigje e tillë, pasqyruese e dorëzimit, e sigurisë dhe e besimit tek Zoti, e tronditi Gavresin që qëndronte para Tij me shpatë në dorë dhe atë çast shpata i bie poshtë. Tabloja e krenarisë njerëzore merr shpatën e rënë në tokë dhe e pyet: "Po tani, kush do të të shpëtojë ty tani?" Ai nis të dridhet si një i sëmurë me malarie dhe ndërkohë, drejt Profetit vrapojnë ata që kishin dëgjuar zërin e tij dhe çuditen me situatën që u përballën. I shtohet dhe një herë më shumë besimi dhe përkushtimi ndaj Zotit. Gavresi, me gjithë gjërat që kishte parë e dëgjuar, i jep fjalën e besës 'Besnikut' dhe largohet që andej me ndjenja mbresëlënëse për guximin dhe trimërinë e të Dërguarit të Zotit.[227]

Një nga shembujt e pashoq të guximit të Dërguarit të Zotit, është ngjarja në shpellën Theur, gjatë hixhretit. Theuri është një shpellë në lartësi ku edhe të rinjtë mund të ngjiten me vështirësi. Por Ai, pavarësisht moshës 53 vjeçare, ngjitet deri në majë duke e nderuar shpellën dhe duke i dhënë asaj një rëndësi të veçantë. Ndërkohë që mushrikët sillen rreth shpellës, Hz. Ebu Bekri është i shqetësuar për Profetin dhe ishte zverdhur krejt në fytyrë. Ndërkohë që te buzëqeshja e lehtë e Profetit, i cili ndante të njëjtën atmosferë me të, nuk kishte asnjë ndryshim. Ai iu drejtua kështu shokut të shqetësuar: *"Mos u shqetëso! Zoti është me ne"*, "Ç'mendon ti për ata të dy, i treti i tyre është Zoti".[228]

Enes b. Malik transmeton: "Profeti ynë ishte njeriu më trim dhe më bujar ndër njerëz. Pasha Zotin, një natë kur populli i Medinës ishte frikësuar nga armiku, Profeti kishte marrë shpatën, hipur mbi kalë dhe ishte nisur në atë drejtim nga vinin zëra. Njerëzit e Medinës kishin mbetur të gjithë mbrapa. Pas njëfarë kohe, kthehet dhe u thotë njerëzve se nuk kanë përse të shqetësoheshin.[229]

Po zhvillohej lufta e Hunejnit. Në radhët e ushtrisë myslimane pati ca zmbrapsje. Profeti Muhamed paqja qoftë mbi të! i hipur mbi një kalë të bardhë, u thotë: *"Unë jam Profet, nuk po ju gënjej."* Pas kësaj sahabet ishin ribashkuar dhe kishin fituar.[230]

I shquari Bernard Show, duke treguar guximin dhe dorëzimin e Profetit Muhamed paqja qoftë mbi të! ndaj Zotit, i shpreh ndjenjat e tij me këto fjalë lavdëruese: "Muhamedi, me aspektet e Tij të shumta është një person me virtyte që të habisin. Këtë person të fshehtë është e pamundur ta kuptosh krejtësisht. Pikërisht Ai ka një anë të pakuptueshme ndër virtytet e tij dhe ajo është besimi dhe mbështetja tek Zoti."

## BUJARIA E PROFETIT

*'Kerem'* do të thotë bujari, bamirësi dhe gostitje. Në arabisht *kerem* është një virtyt i pëlqyer. Madje kur analizojmë poezitë e periudhës para Islamit, mund të shihni se arabët e asaj periudhe janë lavdëruar në këto pika: *Ne premë kaq dele, kaq lopë dhe kaq deve / dhe ia servirëm mysafirëve*. Gostitja me bujari e mysafirit ishte shkak për t'u lavdëruar dhe në këtë pikë fiset bënin gara me njëri-tjetrin. Sigurisht që ata e bënin çdo gjë në emër të egoizmit të

tyre. Në një kohë kur mes tyre vlerësohej bujaria dhe bamirësia, u shfaq një njeri, më bujari mes bujarëve. Të gjithë shtangën kur panë bujarinë e tij. Ky njeri bujar, gjithçka e bënte për hir të Zotit dhe nëse i dhuronte dikujt botën, nuk fliste as dhe një fjalë për të. Madje dhe poezitë e poetëve që tregonin për bujarinë e Tij, nuk i pranonte në asnjë mënyrë dhe fjalët e tyre ia dedikonte Zotit, *"Ekremul Ekremin"*- Më Bujari i Bujarëve.

Ai ishte një pasqyrë e ndritshme në të cilën pasqyrohej dhe dëshmonte veten emri i Zotit *'Kerim'*. Ashtu si në çdo fushë tjetër, edhe në këtë fushë, Profeti Muhamed paqja qoftë mbi të! ishte përfaqësuesi më i lartë Zotit të Madhëruar. Dhe nuk mund të kishte njeri më bujar se Ai mbi tokë.

Nëse bujaria merret si një normë morale që të afron me Zotin, si të mos ishte bujar i Dërguari i Zotit? Ai kishte lënë mbrapa dhe Xhebrailin, madje në udhën drejt tek Zoti. Dhe pikërisht Ai shprehet me këto fjalë: *"Bujari është afër njerëzve, afër xhenetit dhe larg xhehenemit. Ndërsa koprraci është larg njerëzve, larg xhenetit dhe afër xhehenemit."*[231]

Në jetën e tij personale Ai kishte zgjedhur varfërinë. Kjo nuk do të thotë se ai dëshironte që të gjithë të ishin të varfër. Por në të njëjtën kohë nuk i pëlqente njerëzit e fryrë dhe përherë me mendjen tek stomaku. Me mësimet e Tij, myslimanët u bënë populli më i pasur në botë për një kohë të shkurtër. Nuk gjenin njerëz mes tyre të cilëve t'u jepnin sadakanë dhe zekatin. Aq të larta ishin të ardhurat personale të një personi! Por mes tyre kishte dhe aq njerëz modestë, saqë në shtëpi mbanin ushqimet ditore dhe nuk pranonin diçka tjetër që mund t'u jepej. Ky është një altruizëm dhe çështje e lartësimit shpirtëror. Është dashuria për të dhuruar jetë. Ideali i braktisjes së dëshirës për të jetuar. Nuk është i mundur kuptimi i këtyre gjërave nga njerëz të cilët s'janë mbushur me këto ndjenja.

Në një hadith të transmetuar nga Ibn Abasi (r.a.), ai tregon për bujarinë e Profetit: "I Dërguari i Zotit ishte njeriu më bujar ndër njerëz. Kur vinte muaji i Ramazanit dhe takohej me Xhebrailin, bëhej edhe më bujar. Xhebraili vinte çdo natë dhe përsëriste Kuranin bashkë me të. I Dërguari i Zotit ishte dhe më bujar se era që fryn."[232]

Profeti ynë, me urdhrin e Zotit, mbante një të pestën e të gjithë pasurive. Domethënë një e pesta e pasurive mbaheshin nën administrimin personal të Profetit. Autorizimin për ta përdorur pasurinë sipas dëshirës ia kishte dhënë drejtpërdrejtë Zoti i Madhëruar. Megjithatë, Omeri (r.a.) do të hynte një ditë në dhomën e tij të lumturisë dhe do të qante me dënesë. Kur Profeti e kishte pyetur se çfarë kishte, Omeri i madh ishte përgjigjur kështu:

"O i Dërguari i Zotit! Mbretërit e botës po notojnë në mes të pasurisë. Ndërsa Ti nuk ke as dhe një shtrojë për t'u ulur... shtratin e ke prej rrogozi dhe në fytyrë shenjat e tij. Megjithëse gjithësia u krijua për ty.

I Dërguari i Zotit i përgjigjet kështu:

*"A nuk dëshiron, o Omer, që ahireti të jetë i yni dhe kjo bota e tyre?"*[233]

Kur Profeti fliste kështu, nuk fliste me fjalët e një të varfri i cili nuk ka mundësi të jetojë ndryshe, apo me fjalë që pasqyrojnë dëshpërim, vuajtje të një njeriu. Siç e theksuam më sipër, po të dëshironte, mund të ishte njeriu më i pasur. Për ta kuptuar dhe më mirë, le të

shohim një të pestën e pasurisë së Tij të mbledhur në luftën e Hunejnit: 40.000 dele, 24.000 deve, 6.000 robër, 4.000 oka me argjend, ku një okë është 4 kg."[234]

Butësia dhe çelësat e ndjenjave të tjera hyjnore të Profetit paqja qoftë mbi të! kanë hapur shumë zemra të mbyllura dhe Safvan bin Umeje është një nga ato. Hz. Enesi (r.a.) tregon: "Kur i Dërguari i Zotit po shkonte në Hunejn, kishte marrë borxh armën nga një person. Safvan e sheh i habitur pasuritë e përfituara në Hunejn. Mirëpo kjo gjë kishte tërhequr vëmendjen e Profetit. Ai iu drejtua me këto fjalë: *"Le të jenë të tuat ato deve të cilat po i sheh me ëndje."* Pas kësaj i dha shumë gjëra. Safvani u çudit përballë bujarisë së Tij. Ky njeri që e kishte zemrën të mbushur me urrejtje dhe zili për Profetin, papritmas ndryshoi. Bujaria e Profetit e kishte larguar nga zilia e urrejtja dhe për të, Profeti i nderuar ishte bërë më i dashuri ndër njerëz. Fitimi i Safvanit ishte më i rëndësishëm se mijëra deve dhe dhen. Safvani kishte shkuar shpejt tek fisi i tij dhe i kishte thënë: "O fisi im! Vraponi dhe hyni në Islam. Sepse Muhamedi dhuron jashtëzakonisht shumë dhe këtë mund ta bëjë një njeri që nuk frikësohet nga varfëria dhe beson verbërisht Zotin."[235]

Pavarësisht nevojave të tij, ai jepte gjithçka që i kërkohej. Sehl bin Sa'd transmeton: Një ditë, një grua i solli Profetit një triko të punuar vetë.

- O i Dërguari i Zotit! Këtë triko e kam punuar me duart e mia dhe desha t'jua dhuroj, - iu drejtua gruaja. Profeti kishte nevojë për një triko. Dhe e ka veshur trikon në vend të këmishës.

Njëri mes të pranishmëve i thotë:

- O i Dërguari i Zotit! A po ma dhuron mua atë triko?

- Po, sigurisht, - i përgjigjet Profeti.

Vazhdoi edhe pak bisedën. Pastaj u kthye në dhomën e Tij. Palosi trikon. Më vonë ia dërgoi atij që ia kishte kërkuar. Ata që ndodheshin aty thanë:

- Sa me fat je! Profetit i duhej ajo triko. Pastaj ia kërkove ti. Ti e di që ai nuk kthen mbrapsht dëshirën e dikujt.

Dhe ai person u përgjigj kështu:

- Ju betohem për Zotin që unë nuk e mora për ta veshur. E mora ta kem qefin për vete.

Sehli thotë që ajo triko u bë vërtet qefini i tij.[236]

Në një rast tjetër, kishte ardhur një nomad dhe kishte kërkuar diçka nga ai. Dhe Profeti ia kishte dhënë çfarë kishte dashur. Personi në fjalë kishte kërkuar përsëri diçka dhe ai ia kishte dhënë përsëri. Në kërkesën e tretë, Profeti, duke mos pasur ç't'i jepte, i kishte premtuar për më vonë. Pra, do t'ia jepte sapo të kishte diçka në dorë. Kjo gjë e kishte mërzitur pa masë Hz. Omerin dhe ishte mërzitur për shqetësimin e Profetit në mënyrë të tillë. U ngrit mbi gjunjë dhe tha: "Kërkuan, ti, ia dhe. Përsëri kërkuan, përsëri ia dhe. Përsëri kërkuan, ia premtove. Mos e lodh veten kaq shumë, o i Dërguari i Zotit!"

Por këto fjalë nuk i kishin pëlqyer fare Profetit. Abdullah b. Hudhafetu Sehmi, pasi kishte parë ngrysjen e vetullave të Tij, u ngrit në këmbë dhe tha: "Dhuro, o i Dërguari i Zotit, mos mendo asnjëherë se Zoti do të lërë të varfër dhe të ndërpresë mirësitë e Tij."

I vetmi i botëve, qëndroi pak i heshtur dhe pastaj foli: *"Ja, unë për këtë jam urdhëruar."*[237]

Sa bukur thotë *Ferazdaku*:

*Përveç shehadetit, ai kurrë nuk ka thënë jo.*

*Po të mos ishte shehadeti, 'Jo'-ja e tij do të ishte 'Po'.*

Ai ishte plotësuar aq shumë me po-në. Brenda rrethit të së lejuarës ai i përgjigjej menjëherë dëshirës së një personi dhe i jepte çfarë të donte.

Mbreti i Profetëve ishte i vetëm në bujari dhe me Të nuk kishte të ngjashëm. Një bujari e përmasave të tilla mund të vërehet vetëm tek profetët.

## DHEMBSHURIA DHE MËSHIRA E PROFETIT

Mëshira dhe dhembshuria e të Dërguarit të Zotit përbën një dimension të virtytit të tij. Në mëshirën dhe dhembshurinë e Tij njëherazi, fshihej një thellësi e veçantë e një mendimi perfekt. Profeti ynë paqja qoftë mbi të!, si përfaqësuesi i vetëmth në tokë i mëshirës dhe bamirësisë së Zotit të Madhëruar, ka përdorur ndikimin e këtyre dy cilësive të bekuara si një ilaç dhe ka zënë vend në të gjithë zemrat. Nuk ekziston një arsye e dytë për pranimin e një njeriu në shoqëri më shumë sesa dhembshuria, mëshira, butësia dhe sinqeriteti. Ja, pra, i Dërguari i Zotit, me finesën e brendshme, kapacitetin e mrekullueshëm dhe virtytin e tij, ka vlerësuar mëshirën dhe dhembshurinë në një dimension tjetër të virtytit dhe kjo përbën një argument tjetër të profetësisë së Tij.

Zoti i Madhëruar e ka dërguar Atë si mëshirë për botët. Kur i drejtohet atij, Zoti (xh.sh.) thotë: *"TaHa. (O i Dërguari im) Ne nuk e zbritëm këtë Kuran të të sjellë vështirësi."*[238] Në fakt, Ai transmeton Mëshirën e shndritshme të Zotit. Ai është si një burim uji në mes të shkretëtirës, si *hauzi keuther,* nga i cili kanë mbushur të gjithë gotën dhe kanë pirë sa kanë mundur. Ja, me dimensionin e tij të mëshirës, Ai është si një burim i hapur *keutheri* për të gjithë... Çdokush që dëshiron, mund të përfitojë.

Profeti Muhamed paqja qoftë mbi të! ka përqafur njerëzimin me një dashuri që përfshin si një mesazh gjithë njerëzimin dhe krijesat.

*"Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të padituritǃ"*[239] Në këtë ajet Zoti i Madhëruar thekson se Ai duhet të përdorë rrugën e faljes dhe të bashkëpunimit. Sipas transmetimit, kur ka zbritur ky ajet, erdhi Xhebraili (a.s) dhe i Dërguari e pyeti:

*"O Xhebrail cili është kuptimi, interpretimi i këtij ajeti?"*

"Po pyes dhe unë", tha ai dhe iku. Erdhi pas pak dhe iu përgjigj:

"O Muhamed. Zoti i Lartësuar të urdhëron të vizitosh ata që i kanë prerë lidhjet farefisnore, t'i japësh atij që të privon dhe të falësh atë që të bën padrejtësi."[240]

Vetëm se dhembshuria e madhe dhe mëshira e Tij e thellë nuk mbeti vetëm në mendjet apo në faqet e një libri si dashuria dhe mëshira e përfituesve, keqpërdoruesve, përkundrazi, u praktikua brenda një kohe të shkurtër dhe u pasqyrua me të gjitha hollësitë. Në të vërtetë, Profeti ynë nuk ka asnjë mendim të papraktikuar. Ai, me qenien e tij, është një njeri aksioni dhe veprimi.

Qëndrimi i Tij brenda umetit është një arsye e Zotit të Madhëruar për të mos e sprovuar me zhdukjen e përbashkët. Në Kuran thuhet: *"Në qoftë se Ti i ndëshkon ato, ata janë robtë e tu."*[241] Ky ajet është argument i mëshirës dhe i dhembshurisë së Profetit tonë universal. Ai thotë: *"Unë nuk jam dërguar si shkatërrues, por si mëshirë për ju."*[242]

Nëse shihte një fëmijë duke qarë, Ai ulej dhe qante me të. E ndjente vuajtjen e rënkimit të një nëne. Ja një hadith i transmetuar nga Ebu Hurejre i cili tregon mëshirën e jashtëzakonshme të Tij: *"Kur prij në namaz, dua ta zgjas faljen. Pastaj dëgjoj një të qarë fëmije. Duke e ditur shqetësimin që ndjen nëna e tij, e mbaroj sa më shpejt namazin."*[243]

Sidomos dhembshuria ndaj fëmijëve të Tij ishte krejt e veçantë. Shumë herë ka shkuar tek familja e mëndeshës së birit të tij, Ibrahimit, e ka marrë në prehër dhe e ka përkëdhelur për një kohë të gjatë. Pas vdekjes së Ibrahimit ka derdhur lot.[244]

Në një hadith thotë: *"Ju mëshironi krijesat në tokë që t'ju mëshirojnë ata të qiellit."*[245]

I Dërguari i Zotit shfaqte dashuri dhe dhembshuri jo vetëm ndaj familjes së Tij, por edhe ndaj miqve të afërt e të largët.

Dhembshuria e Tij nuk përfshinte vetëm njerëzit, por edhe kafshët. Kishte lajmëruar për hyrjen në xhehenem të një gruaje e cila nuk kishte ushqyer një mace,[246] nga ana tjetër kishte përgëzuar me xhenet një grua imorale e cila i kishte dhënë të pinte ujë një qeni të lodhur dhe të etur.[247]

Një herë po ktheheshin nga një luftë. Gjatë kohës së pushimit, disa nga sahabet kishin gjetur një fole zogu, kishin marrë të vegjlit dhe po i përkëdhelnin. Ndërkohë erdhi nëna e tyre dhe kur pa se të vegjlit e saj ndodheshin në duart e tyre, filloi të përpëlitej dhe të fluturonte hutueshëm. Kur i Dërguari i Zotit mori vesh ç'kishte ndodhur, u zemërua shumë dhe urdhëroi që t'i shpinin zogjtë në folenë e tyre.[248] Vërtet, mëshira e Tij përfshinte dhe kafshët. A nuk është qortuar nga Zoti një nga Profetët e kaluar për shkak të folesë së një milingone?

Ky profet, kishte djegur milingonat pa dashje. Pas kësaj ishte qortuar nga Zoti.[249] Tani, a është e mundur të sillet ndryshe Profeti i cili na transmeton këtë dhe raste të ngjashme? Pastaj, brenda umetit të Tij do të edukohen breza të tillë të cilët do kenë parimin: "milingona nuk shtypet zotëri". Sepse ata do të vendosnin zile në këmbë dhe ashtu do të vazhdonin të ecnin, në mënyrë të tillë që insektet të largoheshin nga zhurma e ziles dhe të mos shtypeshin. O Zot! Çfarë shembulli i lartë e universal i dhembshurisë dhe i mëshirës! Edhe milingonat nuk kanë mbetur jashtë rrethit të Tij mëshirues. A mund të shtypin të tjerët këta njerëz të cilët nuk mund të shtypin qoftë një milingonë. Jo, nuk është e mundur që ata të bëjnë padrejtësi me dijeni ose me qëllim.

Ibn Abasi tregon: "Po shkonim në një vend bashkë me të Dërguarin e Zotit. Njëri kishte lidhur dashin për ta prerë dhe po mprehte thikën para syve të tij. I Dërguari i Zotit i tha: *"Mos do ta therësh disa herë atë?"*[250] Ky ishte një qortim ndaj atij njeriu.

Abdullah ibn Xhaferi (r.a.) tregon: I Dërguari i Zotit hyri në një kopsht bashkë me disa sahabe. Në një qoshe të kopshtit ishte një deve shumë e dobët. Deveja filloi të qante sapo pa të Dërguarin e Zotit. Zotëria i dy botëve iu afrua menjëherë. Qëndroi për pak kohë afër saj, pastaj thirri të zotin e devesë dhe ia tërhoqi vëmendjen për ta trajtuar sa më mirë atë.[251]

Në të vërtetë, Profeti paqja qoftë mbi të! sfilitej shumë për hir të dashurisë ndaj njerëzve. Përpjekja e tij për të ndryshuar njerëzit shihet si argument dhe në Kuran: *"A mos vallë do të vrasësh veten nga pikëllimi, nëse ata nuk besojnë në këtë Fjalë (Kuran)?"*[252]

A nuk e kishte burgosur veten brenda një shpelle sapo atmosfera profetike kishte filluar ta mbështillte? Edhe shpallja i kishte ardhur aty për herë të parë. Domethënë, Ai i donte njerëzit dhe kishte dhënë shpirtin në këtë rrugë.

Kryesisht, kuptimi i xhihadit i të Dërguarit të Zotit rridhte nga ana mëshiruese. Njerëzit mund të kishin humbje të ndryshme në këtë botë për shkak të xhihadit, por në botën e përtejme, do të fitonin aq shumë, saqë humbjet e mëparshme do t'i dukeshin asgjë. I Dërguari i Zotit me majën e shpatës që mbante hapte rrugët që të çonin në xhenet. Ky ishte një dimension tjetër i dërgimit të tij si mëshirë për botët...

## MODESTIA E PROFETIT

Modesti do të thotë thjeshtësi, përulësi dhe është e kundërta e mendjemadhësisë. Kjo mund të interpretohet dhe si pranimi i njeriut, si një individ mes të tjerëve, dhe si një pjesë e krijimit, mendimi i të qenurit në prani të Zotit dhe veprimi sipas tij, vlerësimi i këtij mendimi në marrëdhëniet me të tjerët.

Modestia dhe thjeshtësia e Profetit paqja qoftë mbi të! shndrisin si një yll i dimensioneve të veçanta të virtytit. Sa herë që fama e Tij rritej dhe pranohej prej njerëzve, aq më shumë theksohej modestia tek Ai. Thjeshtësia dhe modestia sikur kishin lindur bashkë me të dhe do të vazhdonin të rriteshin me të deri në fund të jetës. Ai thotë: *"Kush tregohet modest, Zoti do ta lartësojë, kush tregohet mendjemadh dhe krenohet, Zoti do ta ulë më poshtë."*[253] Ai ka pasqyruar dhe praktikuar në mënyrën më të mirë fjalët e thëna.

Ai gjithmonë e ka parë veten si një njeri çfarëdo mes të njerëzve të tjerë dhe asnjëherë nuk është ndarë prej tyre. Është një fjalë e këndshme e Hz. Aliut që tregon se Ai ka ndjekur një vijë gjatë gjithë jetës dhe ka treguar kujdes që të jetë një njeri mes njerëzve të tjerë.

Ja disa fragmente shoqërore që tregojnë përsosmërinë e sistemit:

I Dërguari i Zotit ka qenë plot jetë dhe një njeri me temperament. Shumë herë ata që vinin për herë të parë në tubimet e tij nuk e njihnin Profetin, por e kuptonin se kush ishte Ai nga sjelljet e sahabeve, apo nga të folurit e Profetit. Gjatë hixhretit, shumë prej medinasve, të cilët deri atë ditë nuk e kishin parë asnjëherë të Dërguarin e Zotit, kishin vrapuar të puthnin dorën e Ebu Bekrit (r.a.). Kishin menduar se ai ishte i Dërguari i Zotit. Por kur ai kishte marrë një freskore në dorë dhe kishte filluar t'i bënte pak fresk të Dërguarit, e kishin kuptuar se cili ishte i Dërguari.[254] I Dërguari i Zotit nuk sillej apo të bënte ndonjë veprim ndryshe nga Ebu Bekri.

Është shumë e përfolur modestia me të cilën ka hyrë në Mekë ditën e çlirimit. I hipur mbi kalë, i mbledhur, dukej sikur koka i vinte deri tek shala e kalit. Ja, pra, ai Profet i nderuar kishte hyrë në atë zonë të shenjtë me këtë shpirt modest. Shenja e madhështisë tek të mëdhenjtë është thjeshtësia dhe modestia. Ndërsa mendjemadhësia është tipar i

vogëlsisë. I Dërguari i Zotit është njeriu më i madh ndër njerëz. Prandaj dhe modestia e Tij duhet të ishte e tillë...

Gjatë ndërtimit të xhamisë, ndërkohë që të tjerët mbanin nga një tullë, Ai mbante dy, kur të tjerët lidhnin një gur nga uria, ai lidhte dy[255]. Një burri që i kishte dalë përballë duke u dridhur nga dashuria për Të, i kishte thënë këto fjalë: *"Mos ki frikë, edhe unë jam si ti, një njeri i cili ha bukë të thatë."* Ai padyshim që ishte më modesti ndër njerëz.

Kadi Ijadi transmeton: Një ditë, erdhi një grua me probleme mendore. Duke e marrë të Dërguarin e Zotit për dore, i tha: "Hajde më rregullo diçka në shtëpi!" Gruaja e tërheq të Dërguarin prej krahu dhe Ai shkon pas saj. Ndërkohë dhe sahabet shkojnë pas tyre. I Dërguari i Zotit krejt i qetë rregullon në shtëpinë e saj atë ç'kishte për të rregulluar dhe kthehet.[256]

Të gjithë mund ta shohin Atë më të madh se të mëdhenjtë, por Ai shprehet kështu: *"Askush nuk mund të hyjë në xhenet me veprat e tij."* Atyre që e pyesin: "Edhe Ti?", i përgjigjet: *"Po, edhe unë, nëse Zoti nuk do të më mbështjellë me Mëshirën e Tij."*[257]

Pikërisht Zoti në Kuran urdhëron të qenurit modest nga ana e Profetit: *"Dhe bëhu i butë me besimtarët që të pasojnë ty."*[258]

Shoqja e jetës, Hz. Aishja, thotë: Nuk kam parë njeri me moral më të bukur se Profeti. Kushdo që e ka thirrur atë, nga shokët apo familja qoftë, Ai i është përgjigjur gjithnjë '*Lebbejk*- urdhëroni'.[259]

## BESNIKËRIA E PROFETIT

Pararojës së ushtrisë së shenjtë, të parit në të kaluarën dhe në të ardhmen, iu mundësua udhëtimi përtej hapësirave qiellore, i pamundësuar për të tjerët, për arsye të ndjenjës së besnikërisë në shpirtin e Tij. Me anë të besnikërisë së Tij, Ai arriti në hapësira të paarritura për melekët dhe shkeli në ato vende ku asnjeri nuk kishte mbërritur. Pastaj nga ndjenja e besnikërisë që ushqente ndaj umetit të Tij braktisi botën e lumturisë në të cilën verbohen sytë dhe kënaqen shpirtrat, për t'u kthyer afër miqve të Tij. Do të kacafytej me ngjarje, do të përballonte vështirësitë e dala përpara dhe do t'i ngrinte ato në hapësirat e shenjta. Ndjenja e besnikërisë ndaj miqve dhe shokëve të Tij e bënte të harronte xhenetin dhe bukuritë e tij. Ishte fjala e dhënë atyre, ajo e cila e ktheu përsëri në botën e vuajtjeve dhe të dhimbjes pranë shokëve, duke lënë gjithë nivelet shpirtërore mënjanë, në një kohë kur kishte arritur madhështinë qiellore.

Profeti ynë paqja qoftë mbi të! ishte një simboli i besnikërisë. Mbajtja e fjalës së dhënë, mbajtja e premtimit, mosharresa e atyre që e kishin ndihmuar atë apo të tjerët rreth tij, interesimi dhe përkujdesja për miqtë dhe gjendjen e tyre, respekti ndaj të vdekurve, sakrificat e mëdha, të bëra në emër të umetit, pasqyrojnë në kuptimin më të gjerë besnikërinë e Profetit dhe kjo cilësi mjaftonte për të treguar se Ai ishte Profet. Njeriu i besës i këshillonte vazhdimisht myslimanët të ishin besnikë.

Ai ishte njeri besnik. Në rrugën e hapur prej tij iu përkushtua me besnikëri, deri në frymën e fundit, njerëzve të zemrës. Aq shumë ishte lidhur me ta, saqë edhe kur mendoi se do të shkonte pranë Zotit - gjë që ishte në dëshirën e Tij - mendimi se do të ndahej prej

tyre e kishte bërë të qante me dënesë dhe ishte mjaftuar me fjalët: "Së afërmi do të më pyesin për ju."

Një herë Herakliu e kishte pyetur Ebu Sufjanin rreth Profetit tonë. Njëra nga pyetjet ishte:

- Çfarë ju urdhëron të bëni?

- Na urdhëron të falim namaz, të jemi të drejtë, të jemi të sjellshëm, të mbajmë fjalën dhe premtimin e dhënë dhe të respektojmë amanetin, - ishte përgjigjur Ebu Sufjani.

- Ja, këto janë cilësitë e një Profeti! - kishte thënë Herakliu.[260]

Kur tregon për gjendjen e njeriut të pabesë, ditën e kiametit, Ai shprehet: *"Në ditën e kiametit, do të ngrihet një flamur për atë njeri i cili e ka nëpërkëmbur, shtypur, fjalën dhe betimin. Ja, kjo është gjëja të cilën nëpërkëmbe"*, do t'i thuhet.[261]

## NDJESIA E TURPIT TE PROFETI

Turp mbart njëkohësisht dhe kuptimin e druajtjes, ndërsa në tasavuf mbart kuptimin e frikës, druajtjes dhe respektit ndaj Zotit nga gjërat të cilat nuk i dëshiron Ai. Fuqizimi i e një ndjenje të tillë të natyrës njerëzore tek ndjenja e turpit ndihmon që ai person të jetë më i përmbajtur dhe më i pjekur përsa i përket respektit dhe etikës. Ata njerëz të cilët nuk përmbajnë një ndjenjë të tillë apo u cenohet në varësi të rrethanave të mjedisit, e kanë shumë të vështirë të rigjejnë ndjesinë e turpit.

Profeti ynë është i pafajshmi i të pafajshmëve. Prandaj dhe virtyti i tij qëndron mbi të gjithë virtytet. Edhe armiqtë më të betuar nuk kanë mundur të thonë një fjalë cenuese për virtytin dhe ndershmërinë e tij, nuk kanë mundur ta turpërojnë nga ky aspekt dhe nuk do të mundin ta bëjnë asnjëherë. Sepse Ai ishte një monument virtyti dhe një simbol dëlirësie. Si është e mundur të mendosh që të hedhësh pluhur dhe baltë në personalitetin e tij, ndërkohë që Ai ishte krijuar si një simbol i pastërtisë, si një '*Mustafa*' - i zgjedhur.

Armiqtë shpifën gjëra të ndryshme për të. P.sh., e quajtën të marrë. Në të vërtetë, Ai ishte i marrosuri i Zotit dhe kishte vënë gjithë jetën e tij në këtë rrugë. Kush dëshironte, mund ta kërkonte. Ndërsa përfundimi i kësaj pune do ishte arritja e xhenetit. Përsëri e quajtën magjistar... edhe njerëzit më kokëfortë zbuteshin pranë Tij dhe brenda tyre tronditej nga themelet çdo gjë e lidhur me ateizmin. Ishte i pafund numri i atyre që magjepseshin prej Tij dhe ndiqnin rrugën e Tij. Kur vinte puna tek ateistët që kishin zemrat dhe sytë të mbuluar nuk kishin ç'të thoshin. Kërkonin ngushëllim me fjalët: "Të gjithë këto krahë sillen nga zjarri i magjisë." Edhe ajo që i bënte të fluturonte ishte forca e besimit, shfaqja e përsosmërisë dhe tërheqja e bukurisë.

Ja disa fjalë të të Dërguarit të Zotit për ndjesinë e turpit, të Atij që e kaloi jetën sipas kësaj vije dhe që është një monument i virtytit dhe i ndjenjës së turpit:

*"Besimi ka gjashtëdhjetë e ca degë. Turpi është një nga degët e besimit."*[262]

*"Ndjesia e turpi i sjell të mira njeriut."*[263]

*"Ka katër veti të cilat janë traditë e të gjithë profetëve. Turpi, përdorimi i erës së mirë, misvaku (larja e dhëmbëve) dhe martesa."*[264]

*"Çdo fe ka një moral. Morali i Islamit është turpi."*[265]

*"Ka një parim të lartë të arritur nga njerëzit dhe me të cilin janë të një mendje profetët e të gjitha kohërave: "Nëse nuk ke turp, bëj ç'të duash!"*[266]

*"Kini turp para Zotit! Ai i cili turpërohet para Tij në masën e duhur, le të kontrollojë mendjen dhe ato që ka në mendje, stomakun dhe ato brenda stomakut. Mos të largojë nga mendja vdekjen dhe kalbjen. Ai i cili dëshiron ahiretin, lëshon bukuritë e botës. Ja, kush sillet kështu, do jetë i turpëruar si duhet para Zotit."*[267]

Megjithëse Profeti jetonte brenda një shoqërie që kishte arritur majat e imoralitetit dhe të poshtërsisë, gjatë gjithë jetës nuk ka dalë nga kufijtë e etikës dhe të turpit. Në kohën e tij, njerëzit shëtisnin të zhveshur në vendet më të shenjta të Zotit dhe përsëri pa pasur fare turp laheshin po të zhveshur para njerëzve. Ndërkohë që niveli moral i shoqërisë ishte në këtë gjendje, në kohën kur Profeti punonte si bari në Mekë, kishte dashur të merrte pjesë në një dasmë dy ditë rresht. Por të dy herët e kishte zënë gjumi dhe kishte qëndruar larg nga ai mjedis amoral.[268]

Në Kuran, kur flitet për turpin e Tij, thuhet: *"Kjo me të vërtetë e shqetësonte të Dërguarin dhe ai turpërohej (që t'jua thoshte këtë) Ndërsa Allahu nuk turpërohet që t'ju thotë të vërtetën."*[269]

Sipas transmetimit të Ebu Said el Hudriut i cili tregon për monumentin e virtytit, Profetin tonë, thotë se i Dërguari i Zotit ishte më i turpshëm se një vajzë e re pas perdes. Nëse nuk i pëlqente diçka, mund ta kuptonim nga fytyra e Tij.[270] Lajmërohej për ndonjë sjellje të shoqërisë dhe nëse nuk mbetej i kënaqur, nuk shprehej: "Çfarë po i ndodh atij populli." Ndoshta thoshte: *"Çfarë po i ndodh këtyre njerëzve?"*[271]

Madje nga pikëpamja e marrëdhënieve familjare, fjala e Aishes (r.a.) është shumë e rëndësishme: "Nuk e kam parë asnjëherë auretin (pjesët e turpshme) e të Dërguarit të Zotit."[272]

## HUMORI I PROFETIT

Humori është po aq i vjetër sa edhe historia e njerëzimit. Për nga natyra, njeriu nuk shfaq përherë të njëjtat vepra. Ndonjëherë, kur është shumë i zënë, shfaq disa sjellje çlodhëse. Humori është një nga këto sjellje. Dallimi i humorit nga ironia, apo tallja, është te shakaja e cila nuk i nëpërkëmb të tjerët dhe as nuk ua thyen zemrat. Vetë Profeti paqja qoftë mbi të! duke bërë shaka, ka dëshmuar se humori është i nevojshëm. Nëse Ai do të ishte turivarur dhe të sillej gjithmonë serioz, atëherë njerëzit nuk do kishin mundur t'i afroheshin.

Aishja (r.a.) pasi thekson se Profeti vetë bënte shaka, transmeton se Ai ka thënë: *"Pa dyshim që Zoti i Madhëruar nuk qorton askënd për arsye të një shakaje në të cilën nuk ka gënjeshtra."*[273]

Madje Handhale ibn Rebisë, i cili u pendua për një shaka që kishte bërë, i thotë: *"O Handhale! Njeriu nganjëherë është ashtu, e nganjëherë kështu."* [274]

Një ditë Ebu Hurejre duke mos e kuptuar atë që kishte bërë Profeti, i drejtohet:

"O i Dërguari i Zotit! Mos është ndonjë shaka?"

*"Po, unë bëj shaka, por them vetëm të vërtetën"*, i ishte përgjigjur Profeti. '[275]

Madje Ai ka bërë shaka edhe me nipërit e tij, Hasanin dhe Hysenin, i ka hipur në shpinë dhe u ka thënë: *"Sa deve të mirë paskeni dhe sa kalorës të mirë jeni ju."*[276] Profeti ndonjëherë vizitonte edhe familjen e Enesit. Në një nga këto vizita, vëllai i Enesit mbante një zog. Quhej Nugajr. Duke pyetur: *"Ebu Umejr! Ç'thotë Nugajri?"*, kishte fituar zemrën e djaloshit.[277] Në këto dy raste mësojmë shembujt e shakave të Profetit me fëmijët. Madje Enesit i ka thënë: *"O ti me dy veshë."*[278]

Qëllimi i humorit të Profetit ishte të paralajmëronte diçka, për të fituar pëlqimin e Zotit, për të forcuar lidhjet me njëri-tjetrin ose për të larguar hidhërimin, mërzinë dhe pikëllimin. Një ditë i ishte drejtuar një sahabe që nuk dëshironte të hipte mbi deve:

*"A të të hipi tek i vogli i devesë?"* Sahabi ishte çuditur nga pyetja. Më pas i kishte thënë:

*"A nuk janë të gjitha devetë vogëlushë të një deveje."* Me këtë përgjigje i kujton se po bënte shaka[279]. Në kthimin nga haxhi i lamtumirës, Profeti i është drejtuar një sahabe të quajtur Enxheshe, i cili duke bërtitur i hovte devetë të cilat mbanin gratë e Profetit:

*"O Enxheshe! Ngite ngadalë se mos na thyhen kristalet."*[280]

Kur një grua e moshuar nga ensarët kërkoi nga Profeti që t'i lutej për të hyrë në xhenet, Ai i tha:

*"Të moshuarit nuk mund të hyjnë në xhenet."* Gruaja u mërzit shumë nga këto fjalë dhe Ai vazhdoi:

*"A nuk e di ti se në xhenet nuk do të hysh e moshuar."*[281]

Dhahiri ishte një njeri që vinte nga provinca. Ndonjëherë vizitonte Profetin dhe i sillte dhurata nga vendi i tij. Dhe Profeti i nderuar, në fund të vizitës, e përshëndeste Dhahirin dhe pranonte dhuratat. Bënte shaka me të duke i thënë: *"Dhahiri është provinca jonë ndërsa ne jemi qendra e tij."* Profeti e donte Dhahirin. Nga pamja e jashtme, Dhahiri ishte i shëmtuar, por ishte njeri i mirë. Një ditë, Profeti ia afrua kur ai po shiste në treg. E përqafoi nga mbrapa. Dhahiri nuk mund ta shihte Profetin. "Kush je ti, më lër të qetë!" tha Dhahiri. Ndërkohë përpiqej të kthehej mbrapa dhe të shihte se kush ishte. U kthye pak dhe arriti të shihte se njeriu mbrapa tij ishte i Dërguari i Zotit. Kur u kuptoi se ishte Ai, nuk bëri më rezistencë. Ndërkohë i Dërguari i Zotit tha: *"Kush do ta blejë këtë skllav?"* Dhahiri ia ktheu: *"O i Dërguari i Zotit! Nëse do më shesësh, më shit lirë, sepse askush nuk dëshiron të më blejë."*

Pas këtyre fjalëve, Profeti i tha: *"Veçse para Zotit nuk je i pavlerë, je shumë i shtrenjtë."*

Ai donte të theksonte se tek njerëzit nuk është e rëndësishme pamja e jashtme, por morali dhe bukuria e qëllimit.

Ndonjëherë Profeti luante me nipërit. I merrte mbi shpinë, ndonjëherë mbi shpatulla dhe i shëtiste. Ndonjëherë i përkundte në këmbë, ndonjëherë i bënte për të qeshur me mimikën e fytyrës. [282]

DINJITETI DHE QETËSIA E PROFETIT

Të jesh dinjitoz, do të thotë të veprosh me maturi, kujdes, seriozitet dhe ndjeshmëri, dhe kjo përbën një nga cilësitë e dukshme të karakterit të Profetit.

Dinjiteti është serioziteti dhe maturia e lindur nga besimi. Nuk duhet të ngatërrojmë dinjitetin me krenarinë dhe mendjemadhësinë. Sjellja serioze e një drejtuesi pranohet si dinjitoze, por nëse ky seriozitet pasqyrohet edhe në familje, atëherë nuk vlerësohet si një sjellje dinjitoze. Përkundrazi, ndaj pjesëtarëve të familjes duhet të sillet me dhembshuri dhe mëshirë.

Nëse tek një njeri dinjiteti kurorëzohet me modestinë, atëherë kthehet në një virtyt të shumëkërkuar. Këto cilësi kanë qenë të bashkuara në një tek Profeti ynë. Ai vazhdimisht pasqyronte një dinjitet të shoqëruar me ndjenjat e respektit dhe në të njëjtën kohë dhuronte dashuri me modesti. Ai, paqja qoftë mbi të! ishte njeri dinjitoz, serioz dhe i nderuar. Ata që e shihnin për herë të parë, dridheshin përballë dinjitetit dhe nderimit të Tij, por kur hynin në klimën mëshiruese, arrinin qetësinë dhe rehatinë.

Njeriu i cili merr përsipër detyrën më serioze dhe të rëndësishme, profetësinë, padyshim që është dinjitoz dhe i fisnik. I Dërguari i Zotit mendonte vazhdimisht për Zotin pa reshtur as edhe një çast, ishte një monument dinjiteti. Kur Abdullah b. Selam, një hebre i ditur e pa për herë të parë, tha: "Nuk kam parë asnjë shenjë gënjeshtre tek ai person" dhe u befasua nga respekti dhe serioziteti i Tij. Pas kësaj vendosi të bëhej mysliman.

Profeti ynë ka qëndruar gjithmonë larg sjelljeve që mund të cilësohen si të shthurura. Gjatë jetës së Tij asnjeri nuk ka dëgjuar ndonjë fjalë, apo të ketë parë ndonjë sjellje të turpshme. Nuk përgojonte njeri, urrente thashethemet dhe përpiqej të kishte një mendim të mirë për të gjithë. I Dërguari i Zotit krahas fjalëve: *"Braktisja e punëve që s'kanë lidhje me të, është tregues se sa mysliman i mirë është ai person"*, është sjellë brenda kufirit të etikës dhe dinjitetit.

Shakatë e Tij karakterizoheshin nga mençuria dhe mësimi. Nuk fliste sa për të kaluar radhën. Me fjalët: *"Ai që beson Zotin dhe ditën e fundit, të flasë drejtë ose të heshtë!"*, i nderuari i të nderuarve thekson se nuk duhet harxhuar kot dhuntia e të folurit.

Ai ishte një drejtues, një lider. Duke e ditur se një e çarë e vogël në qendër mund të bëhej shkas për shkatërrime dhe rrënime të mëtejshme, Ai me karakterin dhe moralin e Tij nuk u bë asnjëherë një shembull i keq për ta. Edhe armiqtë më të betuar nuk mundën të hedhin pluhur mbi personalitetin e Tij të veçantë. Nuk mundën të gjenin tek Ai ndonjë të metë që mund të cilësohet si një dobësi morale e Tij. Kur donin të njollosnin Atë dhe çështjen e Tij, kapeshin pas gjërave të pabaza dhe imagjinare.

Ai fliste pak dhe saktë. Fjalët i ndante një nga një. Kur fliste Ai, të gjithë e dëgjonin. Ai që e dëgjonte, mësonte përmendësh fjalët e Tij. Nuk ka qeshur asnjëherë me zë të lartë, as të qeshur në përgjithësi, ka buzëqeshur. Kur qeshte, i qeshnin edhe sytë dhe pasqyronte ngrohtësi. Njerëzve përreth u ka dhuruar siguri. Zakonisht ulej këmbëkryq ose mbi gjunjë. Nuk i shtrinte këmbët në drejtim të kibles dhe nuk ulej duke u mbështetur majtas apo djathtas.

Kishte ecje dinjitoze. Nuk shihte djathtas, apo majtas, por përpara dhe ecte me hapa të shpejtë. Nganjëherë sahabet përballë dinjitetit dhe respektit të Tij nuk kishin guxim ta pyesnin për ndonjë gjë, shpresonin të vinte ndonjë mysafir nga jashtë që të bënte pyetje.

Ebu Malik tregon nga babai i tij rreth të folurit dhe të heshturit e Profetit:

"Kur isha fëmijë, kam marrë pjesë në tubimet e të Dërguarit të Zotit paqja qoftë mbi të!. Unë nuk kam parë njeri më fjalëpakë se Ai. Ai buzëqeshte kur disa sahabe e zgjasnin fjalën."

Nipi i Tij, Hasani, e tregon kështu gjyshin: "I Dërguari i Zotit paqja qoftë mbi të! ishte gjithmonë i menduar. Në shumicën e rasteve heshtte dhe asnjëherë nuk fliste kur nuk duhej."

Vehb bin Munebih, një dijetar i shquar, shprehet kështu për personalitetin e Profetit: "Kam lexuar 71 libra rreth Profetit. Në të gjithë librat e pashë Profetin paqja qoftë mbi të! si më të lartësuarin nga mendja dhe më të vlerësuarin nga pikëpamja e mendimit. '[283]

## PJESA E KATËRT

## USHQIMET DHE PIJET

USHQIMET

SI ISHTE TRYEZA DHE KULTURA E USHQIMIT E PROFETIT?

Me tryezën e Profetit paqja qoftë mbi të! nuk duhet të kuptohet një tryezë tradicionale me njerëz që vijnë e shkojnë. Në jetën e Tij, paqja qoftë mbi të! nuk ka pasur asnjëherë një tryezë/sofër të mirëfilltë. Shërbëtori i Tij, Enesi, që i është gjendur gjithnjë pranë, tregon për tryezën e Profetit: "I Dërguari i Zotit nuk ka ngrënë bukë me pjata të veçuara apo mbi tryeza me këmbë të bëra prej druri. Nuk ka ngrënë bukë prej mielli të pastruar nga krundet ose bukë me petë brumi. Pas kësaj e pyeta Kataden se mbi çfarë hanin bukë? Katade u përgjigj: "Mbi këto sofra të rrumbullta të bëra prej lëkure."[284]

Në shtëpinë e Profetit paqja qoftë mbi të! nuk ka pasur asnjëherë tryeza të ngarkuara. Ai jetën e kësaj bote e shihte si kapital për botën tjetër dhe ky parim ka qenë në qendër të jetës së Tij. Në të vërtetë këtu ka një udhëzim dhe këshillë për umetin e Tij. Ka një paralajmërim për ata që janë kërkues ndaj botës dhe pasurisë. Sipas asaj që tregohet në pjesën '*Kitabul Et'ime*' të Sahihut të Buhariut, Profeti paqja qoftë mbi të! gjatë jetës së Tij, jo vetëm që nuk ka ngrënë ndonjëherë bukë prej gruri, por as nuk e ka parë.

Pëlqente shumë disa lloje gjellësh. Parapëlqente uthullën, ëmbëlsirën me mjaltë, vajin e ullirit dhe disa gjellë me zarzavate. Një herë kishte shkuar në shtëpinë e Umu Hanit:

"A ka ndonjë gjë për të ngrënë?", e kishte pyetur.

"Uthull."

*"Në atë shtëpi ku ka uthull nuk mund të thuhet se nuk ka asgjë"*, - i ishte përgjigjur. Në vendet arabe gatuhet një lloj gjelle që e quajnë '*his*'. Përgatitet duke përzjerë gjalpin me djathë dhe hurma. Profeti e pëlqente shumë këtë gjellë.

Një ditë, Hasani dhe Abdullah ibn Abasi kishin shkuar te Umu Seleme dhe i kishin thënë:

- Sot na gatuaj gjellën më të preferuar të Profetit.

- Mirë, po a do ta pëlqeni? - i pyeti ajo. Meqë ata këmbëngulën, Umu Seleme siti miellin e elbit, e vendosi në kusi dhe kusinë në oxhak. Pasi u bë, ua serviri duke u thënë:

- Ja, kjo është gjella më e preferuar e Profetit. Nga llojet e mishit Profeti ka ngrënë mish dashi, dhie, pule, deveje, lepuri dhe peshk.

Kur Profeti paqja qoftë mbi të! u martua me Safijen (r.a.), në dasmë gostia përbëhej vetëm nga hurma dhe supë me miell të skuqur. Shalqirin e hante me hurma. I pëlqente kastraveci. Një ditë, Muavidh ibn Afra i kishte sjellë hurma dhe kastravecë. Ndonjëherë hurmën e ka ngrënë edhe me bukë.

Pëlqente shumë ujin e ftohtë. Ndonjëherë pinte qumësht të papërzier dhe ndonjëherë e pinte mbasi i hidhte pak ujë. Ndonjëherë i ziente bërthamat e hurmës, të kajsisë dhe të rrushit, pastaj pinte lëngun e tyre. Mes enëve të ushqimit kishte edhe një pjatë druri të lidhur me tela. Kështu transmetohet, por mund të ketë qenë e lidhur sepse ka qenë e thyer.

Nëse nuk e pëlqente gjellën në tryezë, nuk e zgjaste dorën. Por asnjëherë nuk thoshte që është e keqe. Nuk luante me gjellën para tij. I ndalonte dhe të tjerët të bënin diçka të tillë. Asnjëherë nuk ka ngrënë duke u mbështetur diku apo duke u shtrirë dhe nuk e ka pëlqyer. Nuk ka ngrënë në tryezë apo në një tepsi. Sofra e tij ishte një tepsi e madhe, pak e ngritur nga toka. Iranianët e përdornin për të vendosur gjellët dhe për të ngrënë. Kjo ishte një shenjë e qartë lavdërimi dhe mburrjeje dhe i përkiste njerëzve të pasur apo atyre që kërkonin të dukeshin. Për këtë arsye Profeti nuk preferonte të hante bukë mbi të. Hante vetëm me tre gishta.[285] Mishin ndonjëherë e ka ngrënë duke e ndarë me thikë.[286]

## AI QË HA QEPË DHE HUDHRA DUHET TË QËNDROJË LARG XHAMIVE

Sipas një transmetimi të Xhabirit (r.a.), Profeti ka thënë: *"Ai i cili ha qepë, hudhra apo presh, të mos u afrohet xhamive tona. Sepse melekët shqetësohen nga gjërat që i bezdisin njerëzit."*[287]

Xhabir ibn Semure (r.a.) në transmetimin e tij thotë: Kur i Dërguari i Zotit emigroi në Medinë, qëndroi si mysafir në shtëpinë e Ebu Ejubit. Mbasi hante, pjesën që i tepronte ia dërgonte Ebu Ejubit. Një ditë, Profeti ia kishte kthyer gjithë gjellën, pa e prekur fare. Kur Ebu Ejubi erdhi për të mësuar arsyen, Profeti i tha se *"në atë gjellë kishte hudhra"*. Ebu Ejubi e pyeti: "A është e ndaluar hudhra, o i Dërguari i Zotit?" Profeti iu përgjigj: *"Jo, por mua nuk më pëlqen për arsye të erës së rëndë."*[288]

Sipas një transmetimi të Aliut (r.a.), Profeti ka thënë: *"Përdorimi i hudhrës u ndalua për shkak të shqetësimit të njerëzve nga era e saj. Por ajo mund të hahet nëse është e zier, sepse nuk të shqetëson."*[289]

Përsëri në një transmetim të Aliut (r.a.), Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Ngrënia e hudhrës nuk është e këshillueshme, por mund ta konsumoni të zier."* [290]

Në një transmetim të babait të Ubejdullah ibn Ebi Jezidit, Umu Ejub tregon: "Kur Profeti emigroi në Medinë, shkoi për vizitë në shtëpinë e tyre. Dhe ata përgatitën një gjellë

të rëndë me zarzavate që përmbante qepë e hudhra. Profetit nuk i pëlqeu gjella dhe u tha shokëve të tij: *"Hani nga kjo gjellë. Unë nuk jam si ju, kam frikë se mos e bezdis shokun tim, melekun afër meje me atë erë."*[291]

Sipas transmetimit të Ebu Alijes, ka thënë: *"Hudhra është nga begatitë e lejuara."*[292]

Paralajmërimi i Profetit tonë paqja qoftë mbi të! për shmangien e ushqimeve me erë të rëndë, qepë, apo hudhër, është për arsye të largimit të melekëve nga era e rëndë si dhe të bezdisjes së njerëzve përreth. Përkundrazi, qepa, hudhra, apo preshi, janë ushqime të lejuara nga Zoti (xh.sh).

## GJATË NATËS DUHET TË MBULOHEN ENËT DHE TË FIKEN DRITAT

Xhabiri (r.a.) transmeton se Profeti ka thënë: *"Mbuloni enët, lidhini bucelat, mbuloni enët me kapak, fikini kandilat sepse shejtani nuk mund të hapë diçka të mbuluar, nuk mund të zgjidhë lidhjen e enëve prej lëkure, nuk mund të ngrejë kapakët e enëve. Sepse miu mund të hajë vajin dhe fitilin brenda kandilit duke shkaktuar djegien e shtëpisë."*[293]

Në transmetimin e babait të Salimit, thuhet se Profeti ka thënë: *"Kur të flini, fikni zjarret në shtëpinë tuaj dhe merrini masat e nevojshme."*[294]

## MOSNGRËNIA E HURMAVE APO FRUTAVE TË NGJASHME ME TO, DY NGA DY

Sipas një transmetimi të Ibn Omerit, thuhet se Profeti ndaloi ngrënien dy e nga dy të hurmave pa lejen e të zotit të shtëpisë.[295]

## NEVOJSHMËRIA E USHQIMEVE MË ELEMENTARE NË SHTËPI

Sipas transmetimit të Aishes (r.a.), Profeti është shprehur kështu: *"Nëse në shtëpi nuk gjenden ushqimore më elementare, si hurma, atëherë njerëzit e asaj shtëpie mund të quhen të uritur."*[296]

## GJELLA PËR DY VETË MJAFTON DHE PËR TRE

Në transmetimin e Ebu Hurejres (r.a.), i Dërguari i Zotit ka thënë: *"Gjella e përgatitur për dy vetë mjafton edhe për tre, gjella e përgatitur për tre mjafton edhe për katër."*[297] Xhabiri dhe Ibn Omeri kanë transmetuar nga Profeti paqja qoftë mbi të!: *"Ushqimi i një personi mjafton dhe për dy, ushqimi i dy njerëzve për katër dhe ushqimi i katër personave për tetë persona."*

## A KA NGRËNË PROFETI MISH PULE?

Në transmetimin e Zehdem el Xhermiut thuhet se: "Shkova tek Ebu Musai, po hante mish pule. M'u drejtua: "Afrohu, ha dhe ti, sepse kam parë Profetin duke ngrënë mish pule."[298]

Ndërsa Ebu Musai ( r.a) në transmetimin e tij thotë: "Kam parë Profetin duke ngrënë mish pule."[299]

A KA NGRËNË PROFETI MISH SHPENDËSH SHTEGTARË?

Sipas një transmetimi të babait dhe gjyshit të Sefines (r.a.), ajo thotë: "Kam ngrënë mish shpendi bashkë me Profetin."[300]

Ky ishte një shpend i egër i cili kapet me anë të gjahut.

A KA NGRËNË PROFETI MISH TË PJEKUR?

Nga Umu Seleme transmetohet se ajo i kishte skuqur Profetit paqja qoftë mbi të! një copë mishi dhe i Dërguari i Zotit pasi kishte ngrënë prej saj, kishte falur namazin pa marrë abdest.[301]

A I PËLQENIN PROFETIT MJALTI DHE HALLVA?

Në një transmetim, Aishja (r.a.) është shprehur: "Të Dërguarit të Zotit i pëlqente mjalti dhe hallva."[302]

A ËSHTË I NJËJTË MISHI ME LËNGUN E MISHIT SI USHQIM?

Ebu Dherri (r.a.) transmeton se ka dëgjuar Profetin paqja qoftë mbi të! duke thënë: *"Secili nga ju të mos e nënvlerësojë të mirën, qoftë kjo e vogël. Nëse nuk gjen asgjë për të kryer një vepër të mirë, prite vëllanë me buzëqeshje, nëse do të blesh mish dhe ta gatuash, atëherë për të bërë një të mirë, jepi komshiut nga lëngu i mishit të blerë."*[303]

EPËRSIA E PËRSHESHIT MES GJELLËVE TË TJERA

Sipas transmetimit të Ebu Musait (r.a.), Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Shumë prej burrave arritën përsosmërinë, ndërsa nga gratë, Merjemja e bija e Imranit dhe Asija, gruaja e Faraonit kanë arritur përsosmërinë. Epërsia e Aishes ndaj grave të tjera është si epërsia e përsheshit ndaj gjellëve të tjera."*[304]

SI DUHET TË HAHET MISHI?

Safvan b. Umeje (r.a.) transmeton se Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Mishin hajeni duke e kafshuar me dhëmbë, sepse kjo mënyrë është mënyra më e shijshme dhe më e mirë."*[305]

A MUND TË HAHET MISHI DUKE U PRERË ME THIKË?

Amr b. Umejete ed Damri (r.a.) transmeton se ka parë Profetin paqja qoftë mbi të! duke ngrënë kofshën e qengjit duke e prerë me thikë dhe se më vonë është ngritur për t'u falur pa marrë abdest.[306]

Ç"PJESË TË MISHIT PËLQENTE PROFETI?

Ebu Hurejre (r.a.) transmeton se Profetit paqja qoftë mbi të! i sollën mish të pjekur dhe pjesën e kofshës ia dhanë atij. Atij i pëlqente kofsha dhe e hëngri duke e kafshuar me dhëmbë.[307]

Ndërsa Aishja (r.a.) transmeton: "Nga pjesët e mishit, Profeti paqja qoftë mbi të! parapëlqente pjesën e kofshës. Por ishin të rralla rastet kur gjente mish apo gjellë me mish për të ngrënë. Për arsye të zierjes së shpejtë, pëlqente pjesën e krahëve të mishit."[308]

A MUND TË JETË UTHULLA USHQIM DHE INGREDIENT USHQIMI?

Xhabiri (r.a.) transmeton se Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Sa* ingredient *i mirë është uthulla."*[309] Ndërsa Aishja (r.a.) transmeton se Profeti ka thënë: *"Sa ushqim i mirë është uthulla."*[310]

Umu Hani (r.a.), vajza e Ebu Talibit thotë: "Në ditën e çlirimit të Mekës, Profeti paqja qoftë mbi të! erdhi në shtëpinë tonë dhe pyeti: *"A ka ndonjë gjë për të ngrënë në shtëpi?"* Unë iu përgjigja: "Jo, nuk ka asgjë. Vetëm ca copa buke të thara dhe uthull." Pas kësaj, Profeti paqja qoftë mbi të! tha: *"Nuk mund të quhet pa ushqim një shtëpi që mban uthull."*[311] Xhabiri (r.a.) në transmetimin e tij thotë se Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Sa e mirë është uthulla si ingredient në ushqim."*[312] ingredient

A HAHET SHALQIRI ME HURMA TË NJOMA?

Aishe (r.a.) transmeton: "Profeti paqja qoftë mbi të! hante shalqirin me hurma të njoma."[313]

A HAHET KASTRAVECI ME HURMA TË NJOMA?

Abdullah b. Xhafer (r.a.) transmeton: "Profeti paqja qoftë mbi të! hante kastravecin me hurma të njoma."[314]

A E PËLQENTE PROFETI KUNGULLIN?

Ebu Taluti (r.a.) ka transmetuar në një hadith: Shkova te Enes b. Maliku, po hante kungull dhe tha: "Sa produkt i mirë je ti. Preferenca që kishte Profeti për ty, të bën më të dashur edhe për mua."[315]

Enes b.Maliku (r.a.) transmeton: "Pashë të Dërguarin e Zotit duke kërkuar kungull brenda enës së gjellës, prandaj më pëlqen kungulli."[316]

Xhabiri transmeton nga babai i tij: "Pranë Profetit paqja qoftë mbi të! pashë një kungull dhe e pyeta: "Çfarë është ky?" Profeti ynë m'u përgjigj: *"Ky është kungull. Dhe ne e përdorim shpesh atë në gjellët tona."*[317]

## A PËRDORET VAJI I ULLIRIT PËR USHQIM DHE SHËRIM?

Omer ibn Hatabi transmeton: "I Dërguari i Zotit ka thënë: *"Konsumojeni vajin e ullirit dhe lyhuni me të sepse ai është fryt i një peme të begatshme."*[318] Në transmetimin e Ebu Esidit (r.a.) tregohet se Profeti ka thënë: *"Konsumojeni vajin e ullirit në ushqim dhe lyhuni me të sepse ai është nga një pemë e begatshme."*[319]

## TË NGRËNIT BASHKË ME ROBËRIT DHE SHËRBËTORËT

Ebu Hurejre (r.a.) në një transmetim të tijin na lajmëron se Profeti ka thënë: *"Nëse njëri nga shërbëtorët tuaj duron zjarrin dhe tymin e gjellëve të përgatitura, le ta marrë për dore atë shërbëtor dhe ta ulë në një tryezë me të; nëse nuk mund ta bëjë këtë, t'i japë nga ajo gjellë."*[320]

## VLERA E TË USHQYERIT TË DIKUJT

Ebu Hurejre (r.a.) transmeton se Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Përhapeni selamin, ushqeni të tjerët që të arrini Xhenetin."*[321]

Abdullah ibn Amr (r.a.) në transmetimin e tij thotë se Profeti paqja qoftë mbi të! është shprehur kështu: *"Adhurojeni Allahun, Mëshiruesin, ushqeni të tjerët dhe përhapeni selamin, në mënyrë që të hyni me mirësi në xhenet."*[322]

Në fakt, në këto këshilla të Profetit theksohen nevojat e një shoqërie që jeton në grup. Shoqëritë e përbëra nga njerëz që nuk përshëndesin, nuk gostitin mysafirin, qofshin në numër të madh, apo të vogël, nuk kanë qenë të qëndrueshme dhe të përhershme.

## SI DUHET TË HAMË?

Sipas transmetimit të Omer ibn Ebi Selemes (r.a.), djali i Ebu Selemes, Omeri, kishte shkuar tek Profeti paqja qoftë mbi të! dhe e gjen atë duke ngrënë. I Dërguari i Zotit paqja qoftë mbi të! iu drejtua djalit me këto fjalë: *"Afrohu, thuaj bismil'lah, dhe me dorën e djathtë ha pjesën para teje të gjellës në pjatë."* [323]

Hz. Aishe (r.a.) transmeton se i Dërguari i Zotit ka thënë: *"Nëse ndonjëri prej jush ha diçka, le të thotë bismil'lah. Nëse harron ta thotë në fillim, atëherë në fund le të thotë: Bismil'lahi fi evvelihi ve ahirihi (bismil'lah në fillim dhe në fund."*[324]

Profeti paqja qoftë mbi të! sillej shumë thjeshtë kur hante dhe asnjëherë nuk hynte në mundime. Nuk pëlqente të hante duke u mbështetur diku. *"Unë asnjëherë nuk ha duke u mbështetur diku"*, thoshte. Ndoshta ngrënia, duke u mbështetur diku, mund ta shtyjë njeriun të hajë më tepër dhe kjo do të ishte e dëmshme për të. Madje një mënyrë e tillë të uluri mund të jetë shenjë mendjemadhësie.

## LARJA E DUARVE PARA DHE PAS BUKE

Selmani (r.a.) transmeton: "Në Teurat lexova se bereqeti i ushqimit qëndron në larjen e duarve pas buke. Pastaj ia kujtova këtë temë Profetit paqja qoftë mbi të! dhe i thashë që e kisha lexuar në Teurat. Pastaj I Dërguari i Zotit paqja qoftë mbi të! tha: *"Bereqeti i ushqimit është në marrjen abdest*[325] *para dhe pas buke."*[326]

Ebu Hurejre (r.a.) në transmetimin e tij thotë se Profeti ka urdhëruar: *"Nëse ndonjëri prej jush fle me duar të pista me gjellë, apo me erën e saj, atëherë të mos fajësojë dikë tjetër nëse i ndodh gjë gjatë natës."*[327]

## NGRËNIA E PJESËS PARA TEJE TË USHQIMIT

Ikrash b. Zubejdi në transmetimin e tij thotë: "Djemtë e Murre b. Ubejd nëpërmjet meje i dërguan Profetit paqja qoftë mbi të! zekatin e mallrave të tyre. Mbërrita në Medinë afër Profetit paqja qoftë mbi të!, e gjeta të ulur mes ensarëve dhe muhaxhirëve. Pastaj Profeti duke më kapur për dore, më çoi në shtëpinë e Umu Selemes dhe e pyeti në kishte ndonjë gjë për të ngrënë. Më pas na solli një pjatë të mbushur me një copë të madhe mishi dhe përshesh. Filluam të hanim nga përsheshi. Unë fillova ta shëtis dorën në çdo cep të pjatës. I Dërguari i Zotit paqja qoftë mbi të! po hante pjesën para tij. Profeti më kapi dorën e djathtë me të majtën e tij dhe më tha: *"O Ikrash! Kjo është një gjellë e njëllojshme, prandaj haje te një vend."*

Pastaj na sollën disa gjëra të ndryshme bashkë me hurma të njoma. Unë fillova të ha pjesën para meje. Ndërsa i Dërguari i Zotit, paqja qoftë mbi të! po shëtiste dorën nëpër pjatë dhe u shpreh kështu: *"O Ikrash! Ha nga cila anë të duash, ky ushqim nuk është i njëllojshëm."* Pastaj na sollën ujë. I Dërguari lau duart, me lagështinë e pëllëmbëve fërkoi fytyrën, krahët dhe kokën dhe tha: *"O Ikrash! Ky është abdesi që duhet marrë për shkak të gjërave të prekura nga zjarri."*[328]

## LËPIRJA E GISHTAVE PAS BUKE

Sipas një transmetimi të Ebu Hurejres (r.a.) Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Kur ndonjëri prej jush ha ushqim, le t'i lëpijë gishtat, sepse nuk mund ta dijë ku është begatia e mirësia e ushqimit."*[329]

## ÇFARË DUHET TË BËJMË ME KAFSHATËN E RËNË PËRTOKË DHE ME PJESËT E USHQIMIT?

Xhabiri (r.a.) transmeton se Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Nëse ndonjërit prej jush i bie një pjesë ushqimi gjatë ngrënies, le ta marrë, ta pastrojë dhe ta hajë, mos t'ia lërë shejtanit!"*[330]

Enesi (r.a.) transmeton se Profeti paqja qoftë mbi të! pasi hante bukë lëpinte tre gishtërinjtë me të cilët kishte ngrënë dhe thoshte: *"Nëse ndonjërit prej jush gjatë ngrënies i bie një pjesë nga ushqimi le ta marrë, ta pastrojë nga pluhuri dhe ta hajë, mos t'ia lërë shejtanit."* Enesi (r.a.) thotë

se i Dërguari i Zotit na urdhëronte t'i pastronim pjatat mirë dhe shprehej kështu: *"Nuk mund ta dini se në cilën pjesë të ushqimit ndodhet bereqeti."*[331]

Këtu - Zoti e di - Profeti na këshillon të mbarojmë gjellën në pjatë, në mënyrë të tillë shmangim dhe harxhimin e kotë. Nëse mendojmë mirë për konsumin e tepërt të ushqimit në ditët e sotme dhe nivelin e harxhimeve të kota, do ta shihnim sa kuptimplotë është ky urdhër.

Ebu Jeman el Mual'la b. Rashid (r.a.) transmeton: Nga transmetimi i gjyshes sime, robëresha që ka lindur fëmijën e Sinan b. Selemit thuhet: "Nubejshetul Hajr erdhi tek ne. Ne po hanim bukë nga një pjatë. Pas kësaj na tregoi fjalët që kishte thënë i Dërguari i Zotit: *"Nëse ndonjëri prej jush ha nga një pjatë dhe e pastron atë, ajo pjatë do të lutet për të, do të kërkojë faljen e mëkateve të atij njeriu."*[332]

## KA NDALUAR NGRËNIEN DHE PIRJEN ME DORËN E MAJTË

Sipas transmetimit të Abdullah ibn Omerit (r.a.) Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Mos hani dhe pini me dorën e majtë, sepse shejtani ha dhe pi me dorën e majtë."*[333]

Sipas transmetimit të babait të Salimit(r.a.) Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Kur ndonjëri prej jush do të hajë, le të hajë me dorën e djathtë dhe le të pijë me të djathtën. Sepse shejtani ha dhe pi me dorën e majtë."*[334]

## NUK DUHET TË HAHET NGA MESI I PJATËS

Këtij urdhri duhet t'i përgjigjen ata njerëz të cilët hanë bashkë nga e njëjta pjatë apo në rastin kur ha vetëm në një pjatë. Ibn Abasi (r.a.) transmeton se Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Begatia zbret në mes të ushqimit, prandaj ju mos e hani ushqimin nga mesi, por anash."*[335]

## ZOTI ËSHTË I KËNAQUR ME ATË QË FALENDERON PAS BUKE

Enesi (r.a.) transmeton se Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Zoti është i kënaqur me atë njeri që falënderon pasi ka ngrënë apo ka pirë diçka."*[336]

## PIJET

## SIGURIMI I UJIT TË ËMBËL PËR PROFETIN

Hazreti Aishja (r.a.) ka thënë: "Për Profetin paqja qoftë mbi të! na sollën ujë të ëmbël nga Sukja (një vend mes Mekës dhe Medinës)" [337]

## A KA PIRË PROFETI NDONJË GJË NË KËMBË?

Sipas Ibn Abasit (r.a.) thuhet: "Profeti paqja qoftë mbi të! ka pirë ujin e zemzemit në këmbë."[338]

Sipas një transmetimi nga babai dhe gjyshi i Amr b. Shuajbit: "Profetin paqja qoftë mbi të! e kam parë duke pirë diçka ulur dhe në këmbë."[339]

Hz. Aishja (r.a.) ka thënë kështu: "Profeti ka pirë ujë i ulur dhe në këmbë. Ka falur namaz këmbëzbathur dhe me këpucë. Ai është kthyer nga e djathta dhe nga e majta."[340]

MOS FRYRJA BRENDA ENËS KU DO TË PIJMË

Ebu Said el Hudri (r.a.) transmeton: "Profeti paqja qoftë mbi të! ka ndaluar të fryrit në enën ku pijmë. Pas kësaj një burrë tha: "Po nëse shoh ndonjë papastërti brenda enës?" *"Hidhe atë!"*, iu përgjigj Profeti. Ai përsëri iu drejtua: "Unë nuk ngopem me një frymë." Profeti iu përgjigj: *"Atëherë largoje gojën tënde nga ena dhe merr frymë."*[341]

Në transmetimin e Ibn Abasit (r.a.) thotë: "I Dërguari i Zotit na e ka ndaluar të fryjmë të marrim frymë brenda enës ku pimë."[342]

SI I PINTE PROFETI LËNGJET?

Rabia ibn Eksen tregon kështu: "Profeti paqja qoftë mbi të! e përdorte misvakun herë majtas e herë djathtas, dhe kur pinte diçka, e thithte dhe shprehej kështu: "Kjo është më e mirë, më e shpejtë dhe më e shëndetshme."[343]

PIRJA E UJIT DHE E TË NGJASHMEVE ME TË PËR TRI HERË DHE MARRJA DY HERË FRYMË

Sipas transmetimit të Ibn Abasit(r.a.) Profeti kur pinte, merrte frymë dy herë.[344]

KUSH SHPËRNDAN UJË, PIN I FUNDIT

Nga një transmetim i Ebu Katades (r.a.) Profeti paqja qoftë mbi të! ka thënë: *"Një njeri që i shpërndan ujë një grupi, vetë pi i fundit."*[345] Ndërsa në një transmetim tjetër, shërbëtori i Profetit, Enesi (r.a.), tregon: Profeti paqja qoftë mbi të! po i jepte ujë shokëve të tij.

"O i Dërguari i Zotit! Pi vetë njëherë!", iu drejtuan shokët. Profeti iu përgjigj:

*"Ai i cili shpërndan ujë një grupi, pi i fundit."* [346]

PROFETI PËLQENTE GJËRAT E ËMBLA DHE TË FTOHTA

Sipas transmetimit të Aishes (r.a.), pijet më të preferuara të Profetit paqja qoftë mbi të! ishin ato të ëmblat dhe ftohtat.[347]

Zuhri (r.a.) transmeton se e pyetën Profetin paqja qoftë mbi të! se cila pija ishte më e shijshme. Ai i tha: *"E ëmbla dhe e ftohta."*[348]

Ubane Ibnul Velid transmeton këto fjalë të Xhabir ibn Abdullahut: "Njëri nga ensarët ftohte ujë për Profetin në një gajde të varur në një degë hurme."[349]

Aishja (r.a.) është shprehur kështu: "Profetit tonë paqja qoftë mbi të! i pëlqenin pijet e ftohta dhe të ëmbla."[350]

GOTA NGA E CILA KA PIRË UJË PROFETI

Isa ibn Tahman transmeton këtë fjalë të Sabitit: Enes Ibn Maliku na tregoi një enë të bërë prej druri me një rreth prej hekuri. Dhe më tha:

- Sabit! Kjo është gota e Profetit.[351]

Enesi tha: "Me këtë gotë i kam dhënë Profetit të gjitha pijet, ujin, *nebizin* (lëngun e rrushit të thatë), mjaltin dhe qumështin."[352]

Muhamed ibn Ismail tregon: Shkova te Enesi. Në shtëpinë e tij pashë një gotë prej druri. Ai më tha: "Profeti paqja qoftë mbi të! ka pirë ujë dhe ka marrë abdest me të."[353] Ndërsa në transmetimin e ibn Abasit thuhet se Mbreti i Aleksandrisë i kishte dërguar Profetit paqja qoftë mbi të! një gotë prej kristali. Profeti pinte ujë me të.

RADHA E TË PIRIT FILLON NGA E DJATHTA DHE VAZHDON

